



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 342 Akti

Nr. 533 Vendimi
Tiranë, më 18.5.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 15.11.2021, 19.1.2022 dhe 16.5.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 dhe salla ovale, hyrja nga ish-KQZ-ja Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore në lidhje me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Enkeleda Kapedani**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Enkeleda Kapedani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*¹, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 12.11.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Enkeleda Kapedani do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Brunilda Bekteshi dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 2.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Enkeleda Kapedani, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Alma Faskaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 4.12.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit, për të cilën subjekti i rivlerësimit deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit. Me vendimin nr. ***, datë 9.3.2020, të Komisionit, komisionere Alma Faskaj është zëvendësuar nga komisionere Genta Tafa (Bungo), e cila deklaroi se nuk ka konflikt interesi me subjektin. Më tej, subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë zëvendësim dhe, njëkohësisht, iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit për anëtarin e ri të trupit gjykues. Në datën 28.4.2020, subjekti deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarin zëvendësues të trupit gjykues.

6. Referuar pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Enkeleda Kapedani nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e

¹Gjyqtarja Enkeleda Kapedani ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 13.7.2009 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2014. Pas studimeve, në datën 25.9.2015, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. ILDKPKI-ja dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, për të identifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së znj. Enkeleda Kapedani.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriteret e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 18.10.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Në datën 19.10.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit të zhvilluar kryesisht nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD), si dhe më 3.11.2021 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit në tërësi të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues me vendimin nr. 3 datë 10.11.2021, vendosi të ftojë znj. Enkeleda Kapedani në seancë dëgjimore, në datën 15.11.2021, ora 10:00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në datën 14.11.2021, përpara seancës dëgjimore, me anë të postës elektronike, subjekti paraqiti

sqarime dhe dokumentacion shtesë, të cilat u administruan nga Komisioni në aktet e dosjes për këtë subjekt.

17. Në datën 17.11.2021, në rrugë elektronike dhe zyrtarisht në datën 18.11.2021, znj. Kapedani kërkoi zgjatjen e afatit për disponimin e dokumentit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke parashtruar se meqenëse Komisioni ka njoftuar se shpallja e vendimit ishte caktuar në datën 19.11.2021 dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk kishte marrë përgjigje, lidhur me marrjen informacionit zyrtar lidhur me datën e pagesës së tatimit nga ana e bashkëjetuesit, i nevojitej më tepër kohë.

18. Në datën 18 .11.2021, Komisioni për shkak të paraqitjes të denoncimeve të reja, me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 18.11.2021, vendosi riçeljen e hetimit administrativ për hetimin e denoncimeve të paraqitura pas seancës dëgjimore. Në të njëjtën datë, njoftoi subjektin e rivlerësimit lidhur me: (a) riçeljen e hetimit administrativ; (b) pranimin e kërkesës së subjektit për depozitimin e dokumentacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke specifikuar se dokumentacioni që do të merrej nga ky institucion të shoqërohej me mandatpagesën e kohës kur është kryer veprimi, formular DIVA, apo *print screen* të sistemit c@ts.

19. Me vendimin e ndërmjetëm nr. 5, datë 12.1.2022, trupi gjykues vendosi: (i) mbylljen e hetimit administrativ pas riçeljes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shtesë, të cilat iu njoftuan subjektit po në datën 12.1.2022. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes shtesë duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

20. Në datën 17.1.2022, subjekti ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit. Trupi gjykues, pas njohjes dhe administrimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura, konstatoi se subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur kërkesë, për thirrjen e dëshmitarëve, si dhe kryerjen e provës së ekspertimit teknik -kompjuterik të IP-së së kompjuterit nga ishte nisur *e-mail*-i i denoncimeve.

21. Trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm nr. 6, datë 17.1.2022, pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit, vendosi: të refuzojë kërkesën e subjektit për thirrjen e dëshmitarëve dhe kryerjen e provës së ekspertimit teknik-kompjuterik të IP-së së kompjuterit nga ishte nisur *e-mail*-i i denoncimeve, si të pabazuar dhe të panevojshëm, duke e njohur subjektin e rivlerësimit me vendimin e arsyetuar me anë të postës elektronike në datën 18.1.2022.

22. Me vendimin nr. 7, datë 17.1.2022, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 19.1.2022, ora 10:00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

23. Trupi gjykues, pas seancës dëgjimore të datës 19.1.2022, për shkak të gjetjes së adresuar nga vëzhguesi ndërkombëtar përgjatë zhvillimit të diskutimit për marrjen e vendimit përfundimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, formalizuar me rekomandimin nr. *** prot., datë 20.1.2022, me vendimin e ndërmjetëm nr. 8, datë 20.1.2022, pas konstatimit se kjo gjetje rezultonte në përputhje me parashikimet në pikat 10 dhe 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, e pranoi këtë gjetje duke vendosur riçeljen e hetimit administrativ .

24. Më tej, trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm nr. 9, datë 4.3.2022, vendosi: (i) mbylljen e hetimit administrativ pas riçeljes sipas pikës 23; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shtesë, të cilat iu njoftuan subjektit në datën 10.3.2022. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes shtesë duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

25. Pas ushtrimit nga subjekti të së drejtës mbi paraqitjen e parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit shtesë, trupi gjykues, pasi administroi parashtrimet e subjektit, konstatoi se subjekti kishte depozituar një kërkesë, ku shpjegonte lidhur me: (a) mosadministrimin nga ana e saj deri në atë kohë të përgjigjes së informacionit që i kishte kërkuar Ministrisë së Drejtësisë për shtetasin L.L.; (b) investimin e Komisionit për të proceduar, për marrjen e informacionit për gjendjen gjyqësore të shtetasit L.L nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit konstatoi se subjekti i ishte drejtuar Ministrisë së Drejtësisë në datën 15.3.2022, bazuar në ligjin për Drejtën e Informimit nr. 119/2014. Sipas nenit 15/1 të këtij ligji parashikohet trajtimi i saj/kërkesës, brenda dhjetë dite pune, që duke përjashtuar ditët pushim të festave², vërehej se ky afat përfundonte në datën 30.3.2022. Mbi këto përllogaritje, trupi gjykues konstatoi se kërkesa rezultonte ende në afat për t'u trajtuar nga institucioni i Ministrisë së Drejtësisë. Trupi gjykues, në vlerësim të rrethanave konstatuese të përmbajtjes së shkresës së Ministrisë së Drejtësisë³, e cila i kërkonte aktpërfaqësimi subjektit për shtetasin L.L, si dhe rrethanave ligjore mbi legjitimitetin e subjektit në kërkimin e saj, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, vendosi ta pranojë kërkimin e subjektit për investimin e Komisionit për marrjen e informacionit nga Ministria e Drejtësisë, mbi gjendjen gjyqësore të shtetasit L.L.

26. Trupi gjykues, pas administrimit të shkresës nr. *** pro., datë 29.4.2022, të Ministrisë së Drejtësisë, njohjen e subjektit të rivlerësimit me këtë dokument me anë të postës elektronike, po në të njëjtën datë, me vendimin nr. 10, datë 29.4.2022, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 5.5.2022, ora 10:00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, njoftoi Komisionin se për shkaqe objektive (arsye shëndetësore) ishte në pamundësi për t'u paraqitur në seancën dëgjimore, duke depozituar raportin mjekësor nr. *** regjistri, datë 4.5.2022, i cili vërtetonte paaftësinë e saj për punë.

27. Me vendimin nr. 11, datë 5.5.2022, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar, vendosi ta pranojë kërkesën e subjektit për shtyrje të afatit të seancës dëgjimore, si dhe zhvillimin e saj në datën 9.5.2022, ora 10:00, duke njoftuar edhe subjektin e rivlerësimit. Në datën 9.5.2022, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike, njoftoi se e ka objektivisht të pamundur për t'u paraqitur në seancë, për shkak të gjendjes së saj shëndetësore, duke kërkuar që seanca të shtyhet në një ditë të përshtatshme për trupin gjykues. Subjekti depozitoi raportin mjekësor nr. *** regjistri, datë 9.5.2022. Në kërkesën e saj, subjekti ka parashtruar se në rast se pamundësia e saj shëndetësore do të vijojë edhe pas përfundimit të raportit mjekësor do të marrë masa për t'u përfaqësuar në gjykim nga një mbrojtës i zgjedhur prej saj, me qëllim mospengimin e procesit.

28. Me vendimin nr. 12, datë 9.5.2022, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar, vendosi ta pranojë kërkesën e saj për shtyrje të afatit të seancës dëgjimore, si dhe zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 16.5.2022, ora 10:00, duke njoftuar edhe subjektin e rivlerësimit lidhur me këtë vendim dhe duke i komunikuar që të marrë masa për t'u përfaqësuar nga një mbrojtës ligjor me qëllim mospengimin e procesit, duke përfshirë edhe aksesin në dosje që mund t'i nevojitej përfaqësuesit ligjor.

II. SEANCAT DËGJIMORE

²Në zbatim të vendimit të miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, datë 18.3.2022, "Për caktimin e ditës së hënë, datë 21.3.2022, ditë pushimi", dita e hënë datë 21.3.2022 është pushim, si dhe datë 22.3.2022, festë zyrtare.

³Në datën 28.3.2022 subjekti i rivlerësimit i ka vendosur Komisionit në dispozicion nëpërmjet postës elektronike përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë.

29. Seancat dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u zhvilluan në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datat 15.11.2021, 19.1.2022 dhe më 16.5.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 dhe salla ovale, hyrja nga ish-KQZ-ja, në prani të subjektit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

30. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit në datën 16.5.2022, sipas kërkesës së trupit gjykues paraqiti me anë të postës elektronike materialin e mbrojtës së saj, shprehur në seancë dhe provat e reja shtesë⁴, të cilat u administruan në dosjen e hetimit të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të procesit të kryer ndaj saj, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

31. Znj. Enkeleda Kapedani ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve/kërkesave gjatë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

32. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

32.1 Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

33. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (c) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-

⁴Disa raste nga praktika gjyqësore e gjyqtareve të ndryshëm të Republikës së Shqipërisë lidhur me kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, e më konkretisht lidhur me pushimin e çështjes prej tij.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

ja; (e) denoncimet e publikut; si dhe (ë) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

34. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI, datë 29.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

35. Apartament banimi me sipërfaqe 91.34 m², me adresë: kompleksi “****” (përballë qendrës tregtare “****”, kthesa e ***), pallati ***, apartamenti 9, i paregjistruar në regjistrat publikë, i likuiduar, blerë në vitin 2010.

35.1 Burimi i krijimit, sipas deklaratës *Vetting*: kjo pasuri është blerë me kursimet e pjesëtareve të familjes së subjektit, të cilët kanë dhënë deklaratë në lidhje me këtë fakt (bashkëlidhur deklaratat e shtetasve I, N dhe K.K). Në blerjen e këtij apartamenti janë përdorur kursimet e pjesëtareve të familjes nga puna, si dhe të ardhurat nga shitja e disa pronave të pasqyruara në AMTP-në nr. *** Akti, datë 25.3.1992 (bashkëlidhur kopje AMTP-se dhe dy prej kontratave të shitjes në pamundësi për të gjetur të tjerat). Të gjithë pjesëtarët e familjes vendosën që këtë pronë ta blinin në emrin e subjektit, fakt ky i konfirmuar prej tyre, me anë të deklaratave noteriale. Vlera: 50.000 euro. Pjesa takuese: 100 %.

35.1.a Subjekti ka bashkëlidhur: kontratë porosie nr. *** (11 fletë); deklaratë noteriale, datë 20.10.2016, e shtetasit I.K (5 fletë); deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.1.2017 (1 fletë), e shtetasve N dhe K.K; si dhe kontratë shitje pasurive të paluajtshme (3 fletë). Gjithashtu, subjekti së bashku me deklaratën ka depozituar⁶ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me ardhurat e realizuara nga babai i subjektit në emigracion. Pjesa tjetër e të ardhurave deklarohet nga

⁶Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së. Kontratë porosie nr. ***, datë 15.11.2010, me palë shitëse R.A dhe palë blerëse Enkeleda Kapedani; kontratë porosie nr. ***, datë 23.3.2009, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse R.A; deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.1.2017, me palë deklaruese N.K dhe K.K; deklaratë noteriale I.K datë 20.10.2016, në gjuhën angleze; deklaratë datë 20.10.2016, drejtuar ILDKPKI-së, nga shtetasi I.K në lidhje me deklaratimet e motrës e tij Enkeleda Kapedani konkretisht: I.K konfirmon dërgesën e bërë prej tij të një vlerë *cash* 68.000 lekë, të dërguar me MoneyGram në datën 13.9.2014 për llogari të shtetasës Enkeleda Kapedani si dhuratë; I.K konfirmon dërgesën e bërë prej tij të një vlere *cash* 100.000 lekë, të dërguar me anë të një të njohuri në Shqipëri, në vitin 2014, për llogari të shtetasës Enkeleda Kapedani si dhuratë; I.K konfirmon dërgesën e bërë nga ai, të një vlere *cash* 1.585 euro, të dërguar me MoneyGram në datën 24.8.2015, për llogari të shtetasës Enkeleda Kapedani si dhuratë; I.K konfirmon se të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitjes datë 27.5.2011, të pronës arë, e përfituar nga ligji nr. 7501, me sip. 3800 m²; I.K ka konfirmuar se ai i ka dërguar vazhdimisht para familjes nga viti 1999 e në vazhdim. Kopje e pasaportës; formular dërgese nga MoneyGram, në emër të shtetasës Enkeleda Kapedani, në vlerën 68.094 lekë, datë 13.9.2014, të dërguar nga shtetasi I.K. Formular dërgese nga MoneyGram në emër të shtetasës Enkeleda Kapedani në vlerën *cash* 1.585 euro, datë 24.8.2015, të dërguar nga I.K; kontratë shitblerjeje nr. *** datë 28.5.2004, me palë shitëse N.K, K.K, I.K, Enkeleda Kapedani dhe palë blerëse K.B, të pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, arë me sip. 4.262 m², në vlerën 600.000 lekë; dokument i paplotë në lidhje me një shitje në vlerën 200.000 lekë, me palë shitëse N.K, I.K, Enkeleda Kapedani dhe K.K dhe palë blerëse A.S, dokument i noterizuar; kontratë punësimi në emër të shtetasit I.K me shoqërinë “****” në maj të vitit 2016, në gjuhën angleze; nxjerrje llogarie nga *** dega e Glasgow, në emër të shtetasit I.K, në të cilën i është kredituar llogaria në vlera të ndryshme në monedhën GBP; vërtetim nga Njësia Bashkiake Nr. ***, datë 15.2.2011, sipas të cilit Enkeleda Kapedani ka bërë ndërrimin e mbiemrit nga Kapedani në Kapedani në datën 20.10.2010.

kursime të të vëllait në Angli/Skoci dhe nga shitja e tokës së përfituar nga ligji nr. 7501 “Për tokën”. Subjekti ka paraqitur dokumentacion për punësimin dhe të ardhurat e vëllait në Angli/Skoci që nga viti 1999.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

35.2 Kjo pasuri nuk konfirmohet nga ASHK-ja, nga asnjë nga drejtoritë përkatëse.

35.3 Nga aktet e administruara në dosjen e hetimit administrativ, rezultoi se subjekti përveçse në deklaratën *Vetting* e ka deklaruar këtë pasuri edhe në DIP-në para fillimit të detyrës, në pjesë takuese 100%, por pa deklaruar burimin e krijimit të saj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

35.4 Nga hetimi i kryer, lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, Komisionit i rezultoi si vijon:

35.4.1 Me kontratën e porosisë nr. ***, datë 15.11.2010, shtetasi R.A ka shprehur vullnetin e tij që pasurinë/apartament, me emërtimin ***, me sipërfaqe 91.34 m² në katin e pestë, në bllokun nr.***, ndodhur në objektin “Kompleks banesash, ****”, në Tiranë, blerë në vlerën 56.000 euro, t’ia kalojë subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, kundrejt shumës 50.000 euro, duke u dakordësuar që këtë çmim përfituesja ta shlyejë, përkatësisht:

- a. kësti i parë në shumën 18.225 euro shlyhet në momentin e nënshkrimit të kontratës;
- b. kësti i dytë në shumën 15.887 euro shlyhet brenda dhjetorit 2010;
- c. kësti i tretë dhe i fundit në shumën 15.887 euro do të likuidohet në datën 3.3.2011.

35.4.2 Në kontratë është parashikuar se pagesat do të vërtetohen nëpërmjet mandatpagesave bankare ose me mandate dore. Gjithashtu, kontrata ka parashikuar se përfituesit do t’i dorëzohet apartamenti në momentin që ka shlyer të gjithë vlerën e cituar në të. Në kontratë, gjithashtu, thuhet se shtetasi R.A e ka shlyer më parë këtë pasuri, ndërsa sipas po kësaj kontrate pranon që blerësja/subjekti i rivlerësimit ta shlyejë atë në tri këste dhe në një vlerë më të ulët sesa ai vetë ka paguar.

a. Subjekti, pasi është pyetur⁷ lidhur me shlyerjen e kësaj pasurie, ka dhënë shpjegime të detajuara për mënyrën se si janë kryer pagesat (në këste) nga babai N.K, duke saktësuar edhe kohën e kryerjes së tyre. Njëkohësisht, subjekti ka depozituar dokumentacionin mbështetës.

b. Më konkretisht, për të mbështetur deklarinimin, subjekti ka depozituar 6 mandatarkëtime në emër të babait N.K, të dhënat e të cilave pasqyrohen në tabelën vijuese.

Tabela nr. 1

Nr. mandati	Datë	Shuma në euro
20	24.3.2011	6,887
2	3.3.2011	9,000
23	25.12.2010	5,887
7	10.12.2010	10,000
7	10.11.2010	10,000
14	15.10.2010	8,225
Totali në euro		49,999

Komisioni hetoi lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie⁸.

35.5 Në lidhje me kursimet e pjesëtarëve të familjes nga puna

⁷Me pyetësorin nr. 2, datë 26.3.2021.

⁸Megjithëse kjo pasuri është përfituar në vitin 2011 (pasi kësti i fundit është paguar në këtë vit), periudhë kjo përpara emërimit të subjektit në detyrë.

35.5.1 Sipas deklaratës noteriale⁹ nr. ***, datë 27.1.2017, prindërit e subjektit kanë deklaruar se këtë pasuri kanë vendosur ta blejnë në favor të subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, edhe vëllai i subjektit I.K, me deklaratën e datës 20.10.2016, ka deklaruar se apartamenti është blerë nga familja e tij me kontributet e kursimeve të babait nga puna e shumë viteve në emigracion në shtetin Grek, të ardhurat nga shitja e disa pasurive të paluajtshme në Lushnjë, si dhe dërgesat e parave që ka sjellë për llogari të familjes së tij që nga viti 1999, kur është larguar në drejtim të Anglisë dhe, më pas, në Skoci.

35.5.2 Komisioni¹⁰ i kërkoi subjektit të japë shpjegime të detajuara lidhur me të ardhurat e përfituara nga pjesëtarët e familjes, si dhe të depozitujë dokumentacionin justifikues.

35.5.3 Subjekti, në përgjigjen e dhënë: (a) ka deklaruar mbi punësimin e babait për vitet 1992 – 1999, në periudha të ndryshme sezonale në shtetin grek dhe, më tej, për vijimin e punësimit në transportin e *** në Shqipëri; (b) ka sqaruar se punësimi në Shqipëri konfirmohet nga vërtetimi i Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 2005 – 2007, ekstraktet e datave 22.4.2008 dhe 5.1.2009, të QKR-së, si dhe librezë kontributesh për vitin 2008, dokumente të cilat janë depozituar nga subjekti; (c) ka deklaruar se prindërit gjithnjë kanë pasur depozita bankare; (ç) ka depozituar dokumente bankare të NBG-së dhe “Credins Bank”, ku provohen depozita dhe tërheqje të tyre pak kohë para blerjes së apartamentit; si dhe (d) ka deklaruar edhe mbi të ardhurat e dërguara nga vëllai I.K nga Anglia, nëpërmjet shërbimit Western Union, i cili, gjithashtu (është shprehur subjekti), ka punuar gjatë gjithë kohës si i siguruar që prej vitit 1999 e deri më sot, në Bashkinë *** (Skoci), fillimisht si *** e në vijim si *** në sektorin e *** në Glasgow City Council.

35.6 Sipas AMTP-së nr. *** Akti¹¹, datë 25.3.1992, rezultoi se babai i subjektit të rivlerësimit, N.K, ka qenë pronar i pesë pasurive të llojit arë dhe i një pasurie ullishte, prej të cilave sipas shkresës së ZVRPP-së Lushnjë, pesë prej tyre janë shitur në favor të të tretëve. Subjektit i është kërkuar¹² të depozitujë dokumentacionin justifikues mbi tjetërsimin e pasurive, me qëllim identifikimin e të ardhurave të përfituara nga shitja e këtyre pasurive.

35.6.1 Subjekti ka depozituar shkresën kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 30.3.2021, të ASHK-së, Drejtoria Vendore Lushnje, së bashku me kartelat e pasurive dhe kontratat përkatëse. Përkatësisht, rezulton se pasuritë janë shitur me kontratat e cituara në vijim:

- kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 27.5.2011, në vlerën 1.634.000 lekë;
- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.5.2004, në vlerën 600.000 lekë;
- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.4.2001, në vlerën 600.000 lekë;
- kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 11.3.2005, në vlerën 200.000 lekë.

35.7 Komisioni, nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti gjatë hetimit, por edhe në deklaratën *Vetting* në ILDKPKI, konstatoi se:

- i. Babai i subjektit N.K ka pasur në vitin 2008 depozitë në ish-NBG, sot “ABI Bank”. Kjo depozitë është tërhequr në vitin 2009 në vlerën 2.807.180 lekë.
- ii. Prindërit e subjektit K dhe N.K kanë pasur në vitin 2010 depozitë në “Credins Bank”, në vlerën 1.503.950 lekë/secili. Këto depozita janë tërhequr të dyja në të njëjtën datë, më 21.9.2010.

⁹Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰Me pyetësorin nr. 3, datë 23.4.2021.

¹¹Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹²Me pyetësorin nr. 2, datë 26.3.2021.

iii. Subjekti rivlerësimi ka kryer depozitime dhe tërheqje në vlerat 2.000 GBP dhe 100.000 lekë gjatë muajit dhjetor të vitit 2010, në “Union Bank”, periudhë kur subjekti i rivlerësimit as nuk ishte e punësuar.

iv. Nga *statement*-i bankar i vëllait të subjektit, I.K, vihet re se paga e tij mujore është mbi 1.600 GBP.

Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të deklaramit për të ardhurat e përfituara nga punësimi i babait, ka depozituar¹³ provat në vijim:

- kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 2.4.2001, ku rezulton se babai i saj ka blerë mjetin furgon, në vlerën 600.000 lekë;
- lejen e qarkullimit në emër të babait N.K, për mjetin furgon;
- certifikata për transport mallrash brenda vendit, të cilat lëshoheshin vjetore, të cilat datojnë për vitet 2001 - 2002, 2004 - 2005, 2009 - 2010;
- kontratë pune nr. *** rep., datë 7.5.2004, me punëdhënës shtetasin A.K dhe punëmarrës shtetasin N.K, për pozicionin ***;
- mandatarkëtimi për pagesë sigurimesh, datë 7.6.2007;
- vërtetim nga ISSH-ja që vërteton se shtetasi N.K është i siguar si *** me NIPT ***, për periudhën 2005 – 31.12.2007;
- librezë kontributesh për sigurim shoqëror dhe shëndetësor në emër të shtetasit N.K për vitin 2008;
- ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “person fizik”, NIPT ***, në emër të shtetasit N.K me datë regjistrimi, më 28.1.2008, fusha e veprimtarisë, transport mallrash.

35.7.1 Komisioni vlerëson se subjekti ka mundur të provojë në mënyrë indirekte punësimin e babait. Meqenëse është e pamundur identifikimi i një shume të saktë, por nisur nga fakti se janë përfutuar të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme, janë paguar sigurime si i vetëpunësuar, ka pasur kontratë pune, si dhe figurojnë pagesa sigurimesh, Komisioni ka vlerësuar të marrë në konsideratë vetëm shumën 3.007.900 lekë e tërhequr nga depozitat në datën 21.9.2010 prej prindërve.

35.8 Lidhur me të ardhurat e përfituara nga i vëllai, subjekti ka sqaruar¹⁴ se ka dërguar në mënyrë të vazhdueshme deri në vitin 2010, kur është blerë apartamenti dhe në vijim me “Western Union” ose dorazi kur vinte në Shqipëri. Subjekti ka sqaruar edhe lidhur me dokumentin që ka depozituar së bashku me përgjigjen e pyetësorit.

35.8.1 Komisioni, në analizim të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, përllogariti të ardhurat *neto*, shpenzimet e jetesës dhe kursimin e mundshëm. Shpenzimet e jetesës janë përllogaritur sipas EUROSTAT-it. Meqenëse për vitin 2003 nuk kishte informacion, shpenzimet e jetesës janë marrë në të njëjtën vlerë me atë të vitit 2002. Në analizën e kryer nuk janë përfshirë vitet 2004 – 2007, ku vëllai i subjektit duket se ka pasur të ardhura të pakta, për faktin e cituar nga subjekti i rivlerësimit që ka qenë duke kryer një kurs kualifikimi dhe është trajtuar me bursë.

Tabela nr. 2

Viti	Fitimi (GBP)	Taksa (GBP)	Sigurime kombëtare (GBP)	<i>Neto</i> (GBP)	Shpenzime jetese ¹⁵ (GBP)	Kursime (GBP)	Kursimet konvertuar ¹⁶ në lekë
------	--------------	-------------	--------------------------	-------------------	--------------------------------------	---------------	---

¹³Me pyetësorin nr. 3, datë 23.4.2021.

¹⁴Me pyetësorin nr. 3, datë 23.4.2021.

¹⁵<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

¹⁶Sipas kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë, për secilin vit.

2002	15,464	1,542	1,039	12,883	10,861	2,022	433,508
2003	15,900	2,082	1,241	12,577	10,861	1,716	325,810
2004	7,412	580	418	6,414			
2005	5,344	196	134	5,014			
2006	3,279	606	32	2,641			
2007	4,740	715	389	3,636			
2008	25,907	3,973	2,271	19,662	11,354	8,308	1,060,661
2009	31,047	4,950	2,813	23,284	9,757	13,527	2,091,780
2010	27,919	4,338	2,442	21,140	10,263	10,877	1,756,125
	137,011	18,982	10,780	107,250	53,096	36,449	5,667,882

35.8.2 Nga tabela vihet re se vëllai i subjektit ka pasur mundësi të kursejë shumën 36.449 GBP ose 5.667.882 lekë. Meqenëse është e pamundur identifikimi i shumave të sjella në Shqipëri, për shkak të kohës së largët, Komisioni vlerësoi të përfshijë në analizën financiare këto të ardhura deri në shumën e plotësimit të vlerës totale të kësaj pasurie.

35.9 Nga korrespondenca e mbajtur me ZQRPP-në (aktualisht ASHK) nuk janë konfirmuar pasuri të paluajtshme në emër të prindërve¹⁷ dhe vëllait të subjektit të rivlerësimit.

35.10 Edhe nga aksesi në sistemin *online* multifunksional të ASHK-së nuk kanë rezultuar pasuri në emër të prindërve dhe vëllait të subjektit.

35.11 Në konkluzion, Komisioni, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, në vlerën 6.940.500 lekë¹⁸, duke marrë në konsideratë depozitat e prindërve të subjektit, të cilat janë tërhequr në datën 21.9.2010, në shumën 3.007.900 lekë, si dhe diferencën për blerjen e kësaj pasurie nga kursimet e vëllait të subjektit, të cilat kanë një vlerë të konsiderueshme, vërejtë se dukej se konfirmohet ligjshmëria e krijimit të kësaj pasurie.

35.12 Pavarësisht këtij konstatimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar¹⁹ në prapësimet e saj pretendime lidhur më të ardhurat e përfituara nga vëllai i saj në një shumë më të lartë se sa është përlllogaritur nga Komisioni.

Subjekti ka shpjeguar se sipas shkresës së depozituar me pyetësorin nr. 3, të ardhurat e vëllait të saj në Angli, për vitet 2002 – 2017, kanë qenë në shumën 292.063 GBP.

Subjekti ka pretenduar se nga Komisioni janë marrë në konsideratë dhe janë analizuar vetëm të ardhurat nga viti 2002 – 2010 (të cilat kapin vlerën 137.011 GBP, pa përfshirë vitet 2004 – 2007, pasi është trajtuar me bursë studimi), duke qenë se apartamenti, për të cilën ka kontribuar vëllai, është blerë në vitin 2010 dhe është shlyer tërësisht në vitin 2011.

Subjekti ka pretenduar që shumës së kursyer nga i vëllai t'i shtohen edhe shumat e zbritura në formën e taksave dhe sigurimeve kombëtare, duke saktësuar edhe vlerën konkrete të kursyer nga i vëllai deri në vitin 2010.

35.13. Komisioni, në analizim të shpjegimeve të subjektit dhe kërkimit të saj, vlerëson se edhe duke marrë të mirëqenë pretendimin e saj në çdo formë e mënyrë të përlllogaritjes apo rillogaritjes së kryer balanca për aftësinë paguese të kësaj pasurie, ku kontribuues ka qenë edhe vëllai i subjektit, mbetet pozitive.

36. Tokë bujqësore e llojit “arë”, me sipërfaqe 3.200 m², përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”

36.1 Pasuria me sipërfaqe 3.200 m² ndodhet në z. k. ***, me nr. pasurie ***, në zonën ***, Lushnjë. Kjo është e vetmja tokë bujqësore e mbetur nga ajo e përfituar me AMTP nr.*** Akti,

¹⁷Përveç asaj të deklaruar si pasuria nr. 2 në këto rezultate, me sip. 3200 m² (arë).

¹⁸Kursi mesatar i vitit 2010 sipas Bankës së Shqipërisë (1 euro = 138.81 lekë).

¹⁹Në prapësimet e saj në datën 3.11.2021.

datë 22.3.1992, nga e cila rezulton se familja e subjektit është pajisur me disa ngastra të tjera toke, të cilat sot nuk janë të gjitha në pronësinë e tyre, pasi ia kanë shitur të tretëve. Pasuria e mbetur është në bashkëpronësi me të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes, në kohën e ndarjes së tokës (gjithsej 4 pjesëtarë, sipas certifikatës së datës 1.8.1991), si rrjedhim, secili disponon ¼ ose 25% të saj. Vlera është 1.376.000 lekë, sipas aktit të rivlerësimit të pasurisë nga ZVRPP-ja Lushnjë, shënuar në kartelën e pasurisë te seksioni “përshkrimi i veçantë”. Pjesa takuese: 25 %.

36.2 Bashkëlidhur: AMTP-ja nr. *** akti, datë 22.3.1992; certifikata e pronësisë, datë 20.1.2012; harta dhe kartela e pasurisë; dhe certifikatë familjare e datës 1.8.1991 (gjithsej 6 fletë). Gjithashtu, subjekti së bashku me deklaratën ka depozituar²⁰ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

ILDKPKI-ja ka konstatuar se: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Lushnjë.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

36.3 Kjo pasuri konfirmohet nga ZVRPP-ja Lushnjë²¹.

36.4 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DIP-në para fillimit të detyrës/viti 2013, me përshkrimin “Tokë bujqësore (arë), me sip. 3200 m², përfituar nga ligji nr. 7501, në z. k. ***, nr. pasurisë ***, në zonën ***, Lushnjë. Vlera: 1.376.000 lekë. Pjesa takuese: 25%.

36.5 Sipas certifikatës së gjendjes familjare, datë 1.8.1991²², rezulton se subjekti ka qenë në përbërjen familjare në kohën e daljes së ligjit nr. 7501/1991 dhe, për pasojë, është përfituese në to.

Hetimi i kryer nga Komisioni

36.6 Sipas certifikatës për vërtetim pasurie, datë 25.5.2011, të ZVRPP-së Lushnjë, Komisionit i rezultoi se babai i subjektit N.K figuron pronar i pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 3.200 m².

36.6.1 Në kartelën e pasurisë te seksioni “Përshkrimi i veçantë” rezulton se sipas aktit të rivlerësimit të pasurisë, vlera e saj është 1.376.000 lekë.

36.7 Trupit gjykues, në tërësi nga dokumentacioni i administruar dhe verifikimi përkatës, nuk i rezultuan problematika lidhur me këtë pasuri.

37. Gjendje cash

37.1 Kjo gjendje *cash* ka ardhur nga shitja e pasurisë së paluajtshme (arë) me nr. *** pasurie, z. k. ***, në zonën ***, Lushnjë, shitur me kontratën nr. ***, datë 27.5.2011, me çmim shitjeje 1,634,000 lekë, në masën 100 %, pasi të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes vendosën t’ia dhuronin subjektit (fakt ky i konfirmuar edhe nga deklaratat e lëshuara nga pjesëtarët e tjerë të familjes). Në datën e dorëzimit të deklaratës më 29.1.2017, kjo pasuri, krahasuar me një vit më parë, është pakësuar duke mbetur në vlerën 600.000 lekë, për shkak se vlera prej 1.000.000

²⁰AMTP-ja nr. *** Akti, datë 25.3.1992, në emër të z. N.K i jepet tokë gjithsej 16.670 m² dhe në përdorim 610 m², nga e cila 900 m² janë ullishte dhe 250 m² janë truall. Përbërja familjare datë 1.8.1991. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 20.1.2012, në emër të z. N.K (F) me pas. nr. *** ZK ***, vol. ***, f. ***, Lushnjë, arë me sip. 3.200 m². Harta treguese. Kartela e pasurisë së paluajtshme për sip. 3.200 m², në seksionin përshkrimi i veçantë ref. *** sak. sipërfaqe, rivlerësim i pasurisë në vlerën 1.376.000 lekë, datë 23.3.2012. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë. 25.2.2019, konfirmon se z. N.K ka të regjistruar pasuri të paluajtshme me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë fshati ***, Lushnjë, e tipit arë me sip. 3.200 m², figuron në kartelën e pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetasit N.K, si përfaqësues i familjes bujqësore me AMTP ***, ***. Përshkrimi i veçantë ref. ***, saktësim sipërfaqe dhe ref *** në vlerën RVP në vlerën 1.367.000 lekë, datë 23.3.2012. (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

²²Lëshuar në datën 20.4.2011 nga Zyra e Gjendjes Civile, Komuna ***. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

lekësh ka shërbyer si burim për blerjen e një mjeti të llojit kamion në emër të bashkëjetuesit të subjektit L.Q dhe pjesa tjetër, së bashku me kursimet e tjera nga paga apo nga transfertat e vëllait I.K, është shpenzuar. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Bashkëlidhur dokumentacioni: kontratë shitjeje nr. ***, datë 27.5.2011 (5 fletë); deklaratë noteriale e shtetasit I.K (5 fletë); deklaratë noteriale e prindërve N dhe K.K (2 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën, ka depozituar²³ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2013” dhe ndryshimet e saj, ndër vite. ZVRPP-ja Lushnjë konfirmon shitjen e tokës me sip. 3.800 m². Me anë të deklaratave noteriale, prindërit dhe vëllai shprehin vullnetin e tyre për përfitimin e të ardhurave nga ana e subjektit.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

37.2 ZVRPP-ja Lushnjë²⁴ ka konfirmuar se shtetasi N.K ka pasur pasuri të paluajtshme në pronësi, të cilat kanë kaluar në pronësi të të tretëve²⁵.

37.2.1 Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 27.5.2011, z. N.K, bashkëshortja e tij, subjekti i rivlerësimit, si dhe vëllai i kësaj të fundit, ia kanë shitur këtë pasuri z. F.M, në shumën 1.634.000 lekë.

37.2.2 Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.1.2017, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë deklaruar se të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj prone, së bashku me djalin e tyre I.K ia kanë dhuruar subjektit të rivlerësimit.

37.2.3 Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto të ardhura si gjendje *cash* në DIP-në para fillimit të detyrës, si dhuratë e pjesëtarëve të familjes, me burim krijimi nga shitja e pjesës së tyre.

37.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesa dhe pakësime të kursimeve *cash* nga deklarimi për herë të parë dhe në vazhdim, sipas tabelës vijuese:

Tabela nr. 3

Viti	Përshkrimi	Vlera	Akumulative
2013	Para <i>cash</i> në banesë, të ardhura nga shitja e një pasurie të paluajtshme në bashkëpronësi me pjesëtarët e tjerë të familjes, të cilët më kanë dhuruar të ardhurat që kanë ardhur nga shitja e pjesës së tyre	1,634,000	1,634,000

²³AMTP nr. *** akti, datë 25.3.1992, në emër të z. N.K i jepet tokë gjithsej 16.670 m² dhe në përdorim 610 m², nga e cila 900 m² janë ullishte dhe 250 m² janë truall. Certifikatë nr. ***, datë 25.5.2011, të pas. nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Lushnjë, arë me sip. 3800 m², në emër të shtetasit N.K. Harta treguese. Kartela e pasurisë së paluajtshme. Kontratë shitblerjeje e pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 27.5.2011, deklaratë noteriale nr. *** datë 27.1.2017; deklaratë noteriale I.K datë 20.10.2016, në gjuhën angleze. Deklaratë datë 20.10.2016, drejtuar ILDKPKI-së, nga I.K në lidhje me deklaratimet e motrës e tij Enkeleda Kapedani konkretisht: I.K konfirmon dërgesën e bërë nga ai të një vlerë *cash* 68.000 lekë të dërguar me MoneyGram në datën 13.9.2014, për llogari të znj. Enkeleda Kapedani si dhuratë; I.K konfirmon dërgesën e bërë nga ai të një vlerë *cash* 100.000 lekë të dërguar me anë të një të njohuri në Shqipëri, në vitin 2014, për llogari të znj. Enkeleda Kapedani si dhuratë; I.K konfirmon dërgesën e bërë nga ai të një vlere *cash* 1.585 euro, të dërguar me MoneyGram në datën 24.8.2015, për llogari të znj. Enkeleda Kapedani si dhuratë; I.K konfirmon se të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitjes datë 27.5.2011 të pronës arë, e përfituar nga ligji nr. 7501, me sip. 3800 m², në zonën ***, Lushnjë me nr. pas. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***. Kopje pasaporte (Aneks nr. *** dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2019 (Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁵Në bazë të transaksioneve si vijon: pasuria nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në fshatin ***, Lushnjë, lloji i pasurisë arë me sip. 3.800 m². Kartelë e pasurisë së paluajtshme në emër të z. F.M. Bashkëlidhur AMTP nr. ***, datë 25.3.1992, në emër të z. N.K me sip. totale 16.670 m² dhe në përdorim sip. 610 m² (Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

2014	Kursime nga të ardhurat e përfituara në vitin 2014 nga marrëdhënia e punës me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjendje <i>cash</i>)	200,000	2,002,000
	Vlera monetare <i>cash</i> dërguar me “MoneyGram” ²⁶ , datë 13.9.2014, nga vëllai I.K, i cili jeton në Skoci, ***, që nga viti 1999	68,000	
	Vlera monetare <i>cash</i> dërguar dorazi nga vëllai I.K, i cili jeton në Skoci, ***, që nga viti 1999	100,000	
2015	Vlerë monetare <i>cash</i> dërguar me “MoneyGram”, datë 24.8.2015, nga vëllai I.K, i cili jeton në Skoci, ***, që nga viti 1999	218,204 ²⁷	2,220,204
2016	Pakësuar me vlerën 1.400.000 lekë, duke mbetur në vlerën 600.000 lekë për shkak se vlera 1.000.000 lekë ka shërbyer si burim për blerjen e një mjeti të llojit kamion në emër të bashkëjetuesit tim L.Q dhe pjesa tjetër, së bashku me kursimet e tjera nga paga dhe transfertat nga vëllai I.K, janë shpenzuar	- 1,400,000	600,000 ²⁸

37.4 Komisioni kreu analizën financiare në datën 29.01.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting* dhe rezultoi si në tabelën vijuese.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	Datë 29.1.2017
1	TË ARDHURA	92,882
	Të ardhura nga paga subjekti	92,882
2	SHPENZIME	3,919,828
	Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI-së	78,364
	Kontratë qiraje, datë 20.12.2016, V.ZH - gusht 2019	20,000
	Shpenzime kredia në “Intesa Sanpaolo Bank” (më 13.11.2015)	18,560
	Hua L.L (28.000 euro) (më 17.1.2017)	3,787,560
	Shpenzime transporti Tiranë-Elbasan-Tiranë	15,343
3	PASURI	(3,906,556)
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	<i>Ndryshim likuiditeti</i> ²⁹	(3,906,556)
	DIFERENCA (1-2-3)	79,611

37.4.1 Nga përlllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të ketë gjendjen *cash* të deklaruar prej 600.000 lekësh, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

37.5 Komisioni kreu analizën vjetore (si në tabelën vijuese), për vitet 2013 – 2015, kur subjekti ka jetuar së bashku me prindërit.

Tabela nr. 5

²⁶Në emër të subjektit të rivlerësimit.

²⁷ Vlera 1.585.21 euro e konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2014.

²⁸Sipas Komisionit, me pakësimin e kursimeve *cash* me 1.400.000 lekë, gjendja në fund të vitit 2016 duhet të ishte në vlerën 820.204 lekë. Por, meqenëse subjekti deklaroi se gjendja është 600.000 lekë, atëherë është vendosur vlera e deklaruar.

²⁹ Është përfshirë dhe deklarimi i bashkëjetuesit lidhur me likuiditetet që disponon dhe gjendja *cash* prej 400.000 lekësh.

Nr.	Përshkrimi	2013	2014	2015
1	TË ARDHURA	566,572	1,164,445	1,243,697
	Të ardhura nga paga subjekti	566,572	996,445	1,025,493
	Të ardhura nga vëllai		168,000	218,204
	Të ardhura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për pasaportë shërbimi	-	-	-
	Të ardhura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpërblim për sëmundje	-	-	-
	Të ardhura nga shitja e kamionit/bashkëjetuesi	-	-	-
2	SHPENZIME	473,824	948,121	996,288
	Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI-së	434,824	879,992	897,104
	Shpenzime qiraje	50,000	-	-
	Shpenzime kredia në "OTP Bank" (ish-Societe General) (më 13.12.2013)	489,000	-	-
	Blerje elektroshtëpiake (fat. nr. *** datë 31.12.2014) + 22.1.2015, "Raiffeisen Bank", statement		20,700	80,000
	Shpenzime me kredinë në "Intesa Sanpaolo Bank" (elektroshtëpiake)	-	-	368,900
	Shpenzime kredia në "OTP Bank" (ish-Societe General) (më 12.12.2013)	(500,000)	135,429	467,905
	Shpenzime (principal + interes) kredia, në "Intesa Sanpaolo Bank" (më 13.11.2015)			(981,440)
	Shpenzime kredia në "Raiffeisen Bank" (më 22.1.2015)		(88,000)	101,409
	Shpenzime transporti Tiranë-Elbasan-Tiranë			62,410
3	PASURI	(1,376)	228,299	432,564
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme			
	Blerje kamioni (më 29.4.2016), me targa ***	-	-	-
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	(1,376)	228,299	432,564
	DIFERENCA (1-2-3)	94,124	-11,975	-185,155

37.6 Duke marrë në konsideratë analizën financiare më lart, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 197.130 lekë, për vitet 2014-2015, për të përballuar shpenzimet familjare, si dhe të për të kursyer³⁰.

37.7 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në përgjigje të barrës së provës, ka parashtruar si vijon:

Subjekti ka pretenduar se pavarësisht që ka jetuar së bashku me prindërit në shtëpinë e tyre, nuk ka qenë nën të njëjtën ekonomi familjare dhe, për pasojë, shpenzimet e jetesës nuk mund të përlllogariten të përbashkëta.

Subjekti ka rikonfirmuar punësimin e prindërve, si dhe dërgesat e vazhdueshme nga i vëllai me Western Union/MoneyGram/dorazi sa herë ka ardhur personalisht në Shqipëri/ose nëpërmjet shokëve kur udhëtonin drejt Shqipërisë.

³⁰Deri aktualisht nuk konfirmohen të ardhura për prindërit përgjatë viteve që kanë jetuar me subjektin.

Subjekti ka depozituar dy fatura për kryerjen e transfertave dhe, më konkretisht, fatura me datë 10.12.2018, ku rezulton se i vëllai i ka dërguar babait shumë 4.305 euro dhe fatura me datë 30.12.2020, ku rezulton se i ka dërguar shumë 2.053 euro.

Subjekti ka qartësuar edhe faktin se prindërit e saj nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe, për pasojë, nuk kanë pasur detyrimin për të ruajtur dokumentacionin.

Sipas subjektit, nëse të ardhurat e saj të ligjshme gjatë asaj periudhe nuk mbulonin dot shpenzimet, nuk mund të hidhen dyshime rreth mënyrës së ushtrimit të profesionit prej saj, pasi ka qenë në pritje të emërimit në detyrë.

Në qëndrimin e saj, subjekti ka kërkuar që Komisioni për vitet 2013 – 2015 shpenzimet e jetesës duhet t'i llogarisë për 2 persona dhe jo për 4 persona, pra, të përgjysmohen dhe në fund të periudhës 2013 – 2015 duhet të jetë maksimalisht me balancë pozitive në shumë 1.056.610 lekë.

Subjekti ka parashtruar se jetesa e tyre nuk është varur ndonjëherë nga ekonomia e saj familjare. Ata nuk kanë qenë në ngarkimin e saj, si dhe nuk kanë qenë në një certifikatë familjare me të.

Subjekti ka pretenduar se pas heqjes së shpenzimeve të tyre nga të ardhurat e saj, analiza financiare do të rezultojë me balancë pozitive për secilin vit.

Subjekti, në funksion të shpjegimeve, por edhe lidhur me përlllogaritjet e shpenzimeve të jetesës në nivel kombëtar apo më gjerë, nisur nga përlllogaritjet e bëra për minimumin e nivelit jetik, ka referuar raporte të Avokatit të Popullit dhe studime të OECD-së, etj.

Subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimet e saj, ka paraqitur³¹ dokumentacionin: mandattransferte “Western Union”, datë 10.12.2018; mandattransferte “Western Union”, 30.12.2020; dhe pesë transfertat në “Western Union” nga vëllai I.K.

37.8 Trupi gjykues, nën konstatimet se: (i) sipas certifikatës së trungut familjar subjekti rezulton i ndarë nga prindërit e saj; (ii) ka jetuar për një periudhë të caktuar në familjen e saj; (iii) nuk ka qenë në detyrë; (iv) jemi përpara një balance negative të shpërndarë në dy vite; (v) nga hetimi u provua se vëllai i subjektit në mënyrë të vazhdueshme ka mbështetur financiarisht jo vetëm prindërit e tij, por edhe subjektin, krijon bindjen se shpenzimet e prindërve mund të jenë mbuluar prej djalit të tyre. Nga ana tjetër edhe në analizë të provave të administruara, shpjegimeve të subjektit në prapësime, duke konsideruar këtu edhe faktin se nga provat e depozituara prej saj për të ardhurat vjetore të vëllait³², provohet mjaftueshmëria dhe ligjshmëria e krijimit të tyre, çmon se nuk evidentohen shkaqe që mund të ndikojnë në penalizimin e subjektit për kriterin e pasurisë.

38. Gjendja e llogarisë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”

38.1 Gjendja në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, në datën 23.1.2017, është e pandryshuar deri në datën e dorëzimit të deklaratës më 29.1.2017. Vlera: 31.328,38 lekë. Bashkëlidhur lëvizja e llogarisë dhe vërtetim bankar (4 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën ka depozituar³³ edhe dokumentacionin tjetër mbështetës.

38.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020, informon se shtetasja Enkeleda Kapedani ka llogari me gjendje në shumë 31.328,38 lekë, në datën 29.1.2017.

³¹Me parashtrimet e depozituara në datat 3.11.2021 dhe 15.11.2021.

³²Dokumentacioni/mandat transfertë që provon se vëllai i subjektit ka kryer dërgesa parash ndaj prindërve edhe pse ato datojnë në vite të mëvonshme sepse për transfertat e hershme ata nuk dispononin dokumentacionin.

³³Nxjerrje llogarie bankare datë 23.1.2017 nga “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Enkeleda Kapedani, në vlerën 31.328 lekë. Vërtetim datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Enkeleda Kapedani (Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

38.3 Në analizë të dokumentacionit bankar, trupi gjykues konstaton se konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

39. Gjendja e llogarisë në “Intesa Sanpaolo Bank”

39.1 Gjendja e llogarisë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 23.1.2017, është e pandryshuar deri në datën dorëzimit të deklaratës më 29.01.2017. Vlera: 262.67 lekë. Bashkëlidhur lëvizja e llogarisë (9 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën ka depozituar³⁴: nxjerrje llogarie bankare, datë 23.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të Enkeleda Kapedani në vlerën 262 lekë.

39.2 “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. ***, informon se znj. Enkeleda Kapedani ka llogari me gjendje në shumën 262.67 lekë, në datën 29.1.2017.

39.3 Në analizë të dokumentacionit bankar, trupi gjykues konstaton se konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

40. Kredi konsumatore në “Intesa Sanpaolo Bank”

40.1 Kredi konsumatore në “Intesa Sanpaolo Bank”, me kontratën e kredisë, datë 13.11.2015, për shumën 1.000.000 lekë, me afat 6-vjeçar, me interes 10%, me këst 18.560,36 lekë/muaj, bashkëkredimarrëse me nënën K.K. Deri në datën 23.1.2017 ka mbetur pa u shlyer shuma prej 847.689,68 lekësh, gjendje kjo e pandryshuar deri në datën e dorëzimit të deklaratës më 29.1.2017. Shuma e detyrimit financiar është 847.689,68 lekë (bashkëlidhur: kontratë kredie 8 fletë; plan amortizimi 4 fletë; si dhe pasqyrë kredie 1 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën, subjekti ka depozituar³⁵ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Subjekti nuk ka deklaruar qëllimin e marrjes së kredisë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vitin 2015. Nga deklarimet, ndër vite, konstatohet se në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2015, subjekti ka deklaruar mbylljen e kredisë në “Societe Generale Albania”, shlyerjen e *overdraftit* në “Credins Bank”, po ashtu edhe të kredisë në “Raiffeisen Bank”.

40.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, në rubrikën e detyrimeve financiare, por pa përcaktuar qëllimin e marrjes së kësaj kredie.

40.2.1 Kjo kredi konfirmohet me kontratën e kredisë³⁶, datë 13.11.2015, me palë kredimarrëse subjektin e rivlerësimit Enkeleda Kapedani dhe shtetasen K.K (nëna e subjektit). Në kontratë cilësohet se banka bie dakord që t’i japë kredimarrësit shumën 1.000.000 lekë, e cila do të përdoret për shlyerjen e shumave të mbetura të kredisë në banka të tjera dhe për blerje të pajisjeve elektroshtëpiake.

Disbursimi i kredisë është kryer me dy këste, përkatësisht në datën 13.11.2015, shuma 640.000 lekë dhe në datën 18.11.2015, shuma 360.000 lekë. Tërheqjet e tyre rezultojnë në të njëjtën datë me atë të disbursimit.

40.2.2 Gjatë hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në datën 13.11.2015 shumën 627.000 lekë dhe, më tej, ka kryer transaksionet e mëposhtme:

- në datën 13.11.2015 ka depozituar në “Credins Bank” shumën 187.000 lekë, me përshkrimin për mbyllje *overdrafti*. Ky *overdraft* është marrë në datën 27.2.2014 dhe është deklaruar në deklaratën përkatëse;

³⁴Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵Kontratë kredie konsumatore datë 13.11.2015, me “Intesa Sanpaolo Bank” dhe palë kredimarrëse Enkeleda Kapedani dhe K.K, në vlerën 1.000.000 lekë. Amortizim i kredisë 6-vjeçare. Vërtetim datë 23.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, i cila vërteton se detyrimi i mbetur i kredisë është në vlerën 847.689 lekë. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁶Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

- në datë 16.11.2015 ka depozituar në “OTP Bank” shumën 355.500 lekë, me përshkrimin për mbyllje kredie. Kjo kredi është marrë në datën 12.12.2013, në shumën 500.000 lekë dhe, njëkohësisht, është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013, së bashku me shlyerjet e saj në vijim;
- në datën 16.11.2015 ka depozituar në “Raiffeisen Bank” shumën 75.600 lekë, me përshkrimin për mbyllje kredie. Kjo kredi është disbursuar në datën 22.1.2015, në vlerën 88.000 lekë dhe subjekti e ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014.

40.3 Nga korrespondenca e Komisionit me “Intesa Sanpaolo Bank”³⁷, rezulton se detyrimi i mbetur i kredisë deri në datën 29.1.2017 është në shumën 847.689,68 lekë, si dhe destinacioni i saj duket se i është përmbajtur përshkrimi në kontratën e kredisë.

40.4 Në analizë të dokumentacionit bankar, trupi gjykues konstaton se konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”, lidhur me detyrimin e mbetur.

41. Gjendja e kartës së kreditit në “Raiffeisen Bank” me limit 100.000 lekë

41.1 Gjendja e kartës së kreditit në “Raiffeisen Bank” në datën 23.1.2017 është me gjendje në vlerën 100.000 lekë dhe nuk ka asnjë detyrim, pasi ky fond nuk është prekur, gjendje kjo e pandryshuar deri në datën e dorëzimit të deklaratës më 29.1.2017. Detyrimi është 0 (zero) lekë (bashkëlidhur kontratë kartës së kreditit, 6 fletë dhe vërtetim bankar datë 23.1.201, 1 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën, subjekti ka depozituar³⁸ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

41.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020, informon se Enkeleda Kapedani ka llogari Master Card pa asnjë detyrim deri më 29.1.2017.

41.3 Në analizë të dokumentacionit bankar, trupi gjykues konstaton se konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËJETUESIT TË SUBJEKTIT L.Q

42. Shtëpi banimi me sip. 300 m² truall dhe 156 m² ndërtesë me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. *** f. ***, në ***, Tiranë, fituar me anë të trashëgimisë ligjore nr. *** akti, nr. *** vendimi, datë 15.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Trualli mbi të cilin është ndërtuar shtëpia është fituar me AMTP-në nr. ***, datë 1.10.1992, përcaktuar tek rubrika nr.*** e saj (në deklaratën Veting) e pavlerësuar. Pjesa takuese: 1/6 pjesë e pasurisë së pandarë (bashkëlidhur: certifikata e pronësisë, datë 28.5.2012; kartela dhe harta e pasurisë; AMTP-ja nr. ***, datë 1.10.1992, si dhe dëshmia e trashëgimisë gjithsej 8 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën, ka depozituar³⁹ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

³⁷Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020.

³⁸Vërtetim datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, konfirmon se znj. Enkeleda Kapedani ka kartë krediti me limit 100.000 lekë dhe pa detyrim financiar deri në datën 23.1.2017. Marrëveshje për përdorimin e kartës së kreditit *Master card*, nga “Raiffeisen Bank”. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁹Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 28.5.2012, të pasurisë nr. ***, z. k. ***, vol. *** f. ***, në ***, Tiranë, e llojit “truall” me sip. 300 m², nga kjo ndërtesë me sip.156 m², regjistruar në emër të shtetasve XH.Q, S.E, F.Q, L.Q, SH.Q dhe A.Q. Kartela e pasurisë së paluajtshme. Harta treguese e regjistrimit. AMTP nr. *** akti, datë 1.10.1992, në emër të z. H.Q, në ***, Tiranë, me sip. të tokës bujqësore 26.580 m², nga e cila 1000 m² truall. Vendim nr. ***, datë 15.2.2012, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së H.Q. Gjykata vendosi si trashëgimtare ligjore bashkëshorten, vajzën dhe katër djemtë. Certifikatë familjare e datës 27.10.2016. ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 17.11.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon se në emër të z. L.Q ka të regjistruar pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “truall” me sip. 300 m² ndërtesë me sip. 156 m², në bashkëpronësi me persona të tjerë. Bashkëlidhur; kartelë e pasurisë së paluajtshme. Certifikatë për vërtetim pronësie. Vendim nr. ***, datë 15.2.2012, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për çeljen e trashëgimisë pas vdekjes së H.Q. Certifikatë familjare. AMTP nr. *** akti, datë 1.10.1992, në emër të z. H.Q, në ***, Tiranë, me sip. të tokës bujqësore 26.580 m², nga e cila 1000 m² truall (Aneks nr. *** dhe Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga ZVRPP-ja Tiranë.

42.1 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, trupit gjykues i rezultoi se kjo pasuri konfirmohet me certifikatën për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, në datën 28.5.2012, me të njëjtat të dhëna të deklaruara. Pasuria rezulton në emër të bashkëpronarëve, trashëgimtarë të shtetasit H.Q (babai i bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit), sipas dëshmisë së trashëgimisë me vendimin nr. ***, datë 15.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke qenë se kjo pasuri është e ndërtuar në truallin për të cilin, gjithashtu, Komisioni ka kryer hetimin përkatës, konkluzioni është vlerësuar për të dy pasuritë së bashku.

43. Tokë bujqësore e llojit arë, me sipërfaqe 26.580 m²

43.1 Tokë bujqësore e llojit arë, përfituar me AMTP-në nr. ***, datë 1.10.1992, me sipërfaqe totale 26.580 m², nga e cila është shitur vetëm prona te rubrika me nr. ***, nën emërtimin “****”, me sip. 5870 m², sipas kësaj AMTP-je. Ndërsa, e gjithë pjesa tjetër e pronave të përmendura në këtë AMTP vazhdojnë të jenë në bashkëpronësinë e tij me bashkëpronarët e përmendur në dëshminë e trashëgimisë, si dhe në certifikatën me datë 1.8.1991, e pavlerësuar. Pjesa takuese: 1/6 pjesë e pasurisë së pandarë (bashkëlidhur: AMTP-ja 1 fletë dhe certifikata e datës 1.8.1991, 1 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën ka depozituar⁴⁰ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

ZVRPP-ja Tiranë konfirmon tokën e përfituar me AMTP-në nga babai i bashkëjetuesit dhe pjesën e trashëguar prej 1/6 me dëshmi trashëgimie.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

43.2 ZVRPP-ja Tiranë⁴¹ konfirmon se shtetasi H.Q ka përfituar nëpërmjet AMTP-së nr. ***, datë 1.10.1992, sipërfaqen e tokës bujqësore 26.580 m², nga e cila 1.000 m² truall. Praktika ka të bashkëlidhur AMTP-në nr. ***, si dhe certifikatën e përbërjes familjare, datë 1.8.1991.

43.3 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, Drejtoria vendore Tirana Rurale 1, Sektori Juridik dhe i Bashkëqeverisjes, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2020, ka informuar se: nga verifikimi në sistemin elektronik dixhital të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, rezulton se në emër të shtetasit L.H.Q (dhe bashkëpronarëve të tjerë të cilët identifikohen lehtësisht në aktet e praktikës, rezultuar si të tillë sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore 1/6 pjesë takuese, përkatësisht nëna e tij, tre vëllezër dhe motra) ka të regjistruar pasuri të paluajtshme me të dhënat:

- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “truall”, me sipërfaqe 300 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji pasurisë “arë”, me sipërfaqe 3000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji pasurisë “arë”, me sipërfaqe 6000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji pasurisë “arë”, me sipërfaqe 5000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji pasurisë “arë”, me sipërfaqe 13000 m²;
- pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji pasurisë “arë”, me sipërfaqe 2650 m².

43.4 Nga aktet e administruara konfirmohet se pasuritë fillimisht janë përfituar nga ligji nr. 7501/1991, në emër të babait të bashkëjetuesit të subjektit, shtetasit H.Q. Të gjithë pasuritë janë me vendndodhje ***, Tiranë. Pasuritë pasqyrohen me specifikat më sipër, në certifikatat, si dhe në kartelat përkatëse të tyre. Gjithashtu, po në këto kartela pasqyrohen transkriptimet e pasurive si rezultat i regjistrimit të dëshmisë së trashëgimisë me vendimin nr. ***, datë 15.12.2012, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për trashëgimlënësin H.Q, babai i bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit. Më tej, konfirmohet se me deklaratën noteriale, datë

⁴⁰Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹Për ILDKPKI-në, me anë të postës elektronike, datë 21.2.2019.

20.12.2018, bashkëpronarët e tjerë kanë hequr dorë nga pasuria me sipërfaqe 2650 m², duke ia kaluar atë tërësisht në favor L.Q, i cili ka pranuar si i vetëm këtë pasuri. Në vijim, rezulton se me deklaratën noteriale, datë 27.12.2018, shtetasi L.Q ka hequr dorë si bashkëpronar i pasurive me sipërfaqe 3000 m², 6000 m², 5000 m² dhe 13000 m², të cilat kanë kaluar në emër të pesë bashkëpronarëve të tjerë.

43.5 Në tërësi, nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar për pasuritë e pasqyruara në pikat 8 dhe 9, trupit gjykues nuk i rezultuan problematika mbi mënyrën e përfitimt dhe regjimin juridik aktual të tyre.

44. Gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë

44.1 Gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë, përfitur nga shitja e një mjeti e llojit kamion, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 13.10.2016, i cili ishte blerë me kontratën e blerjes nr. ***, datë 29.4.2016. Burimi i blerjes së pasurisë është bashkëjetuesja Enkeleda Kapedani, me të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë nr. *** pasurie, z. k. ***, me adresë: ***, Lushnjë, shitur me kontratën noteriale nr. ***, datë 27.5.2011. Çmimi i shitjes së kamionit është 32.000 euro, nga të cilat gjendje *cash* 400.000 lekë, ndërsa shuma prej 28.000 euro është dhënë hua, siç është specifikuar në pikën vijuese nr. 4 (në deklaratën veting). Vlera: 400.000 lekë. Pjesa takuese: 100% (bashkëlidhur kontrata e blerjes së mjetit nr. ***, datë 29.4.2016, 1 fletë dhe kontrata e shitjes së mjetit nr. ***, datë 13.10.2016, 2 fletë). Gjithashtu, së bashku me deklaratën, ka depozituar⁴² edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Vlerë e dyshimtë e shitjes së mjetit tip kamion “***”, me targa ***, në datën 13.10.2016, në shumën 32.000 euro nga bashkëjetuesi i subjektit, mjet i cili më 29.4.2016 është blerë në shumën 950.000 lekë, çka e bën deklarinimin të rremë (nga kontrata me të cilën shitësi ka blerë kamionin, po në vitin 2016, vërehet se çmimi është 1.100.000 lekë). Transaksioni është kryer jashtë sistemit bankar. Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2016, subjekti ka deklaruar veprime që i përkasin vitit 2017, konkretisht, huadhënien e cila ka ndikuar në gjendjen *cash* të mbetur.

44.2 Nga hetimi rezultoi se bashkëjetuesi⁴³ i subjektit të rivlerësimit deklaroi në deklaratën e vitit 2016 se disponon shumën 400.000 lekë gjendje *cash* pas kryerjes së disa transaksioneve financiare. Këto transaksione, Komisioni i ka trajtuar dhe shpjeguar më gjerë në pikën e mëposhtme, pasi kjo gjendje *cash* prej 400.000 lekësh, në raport me nënshkrimin e kontratës së huas në janar të vitit 2017 për shumën 28.000 euro, nga ku rrjedh edhe burimi i gjendjes *cash*, nuk i përket vitit 2016. Parashtrimet e subjektit, lidhur me këtë konstatim, janë integruar në trajtimin e shumës 28.000 euro në vijim.

45. Hua në vlerën 28.000 euro

45.1 Huaja i është dhënë shtetasit L.L me kontratën e huas nr. ***, datë 17.1.2017, dhe me aneksin e kontratës nr. ***, datë 26.1.2017, e cila ka ndryshuar dy kushte të kontratës së huas së datës 17.1.2017, në lidhje me afatin, duke përcaktuar përfundimisht afatin 6-mujor për kthimin e huas, si dhe në lidhje me interesin duke e lënë huan pa interes. Kjo pasuri ka ardhur nga shitja e mjetit kamion, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 13.10.2016, i cili ishte blerë me kontratën e blerjes nr. ***, datë 29.4.2016. Burimi i blerjes së kësaj pasurie është bashkëjetuesja Enkeleda Kapedani, me të ardhurat nga shitja e pasurisë nr. *** pasurie, z. k. ***, në ***, Lushnjë, shitur me kontratën nr. ***, datë 27.5.2011. Vlera: 28.000 euro. Pjesa takuese: 100 % (bashkëlidhur: kontrata e huas nr. ***, datë 17.1.2017, 3 fletë; aneksi i kontratës

⁴²Kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 13.10.2016, me palë shitëse L.Q dhe palë blerëse A.V të mjetit kamion me targa ***, në vlerën 32.000 euro; kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.4.2016, me palë shitëse shoqëria *** sh.p.k., me administrator L.L dhe palë blerëse L.Q, të mjetit kamion me targa ***, në vlerën 950.000 lekë. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴³Ka deklaruar për herë të parë në vitin 2016.

së huas nr. ***, datë 26.1.2017, 2 fletë; kontrata e blerjes nr. ***, datë 29.4.2016; si dhe kontrata e shitjes nr. ***, datë 13.10.2016, 3 fletë). Subjekti, së bashku me deklaratën, ka depozituar⁴⁴ edhe dokumentacion tjetër mbështetës.

Konstatimi i ILDKPKI-së

Në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2016, subjekti ka deklaruar veprime që i përkasin vitit 2017 dhe, konkretisht huadhënien, e cila ka ndikuar në gjendjen *cash* të mbetur. Kontrata e huas konfirmohet nga DPPPP-ja, por subjekti ka mungesë burimi të ligjshëm financiar për shumën 28.000 euro, të deklaruar të dhënë hua, pasi çmimi i shitjes së mjetit tip kamion (i cili ka qenë burim për këtë huadhënie) është jashtë logjikës ekonomike të tregut (kamioni është blerë në vlerën 950.000 lekë, në prill 2016 dhe është shitur në vlerën 32.000 euro, në tetor 2016).

Hetimi i kryer nga Komisioni

45.2 Në deklaratën periodike të vitit 2016, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit e deklaroi këtë huadhënie në vlerën 28.000 euro, ndaj shtetasit L.L, me burim krijimi të ardhura nga shitja e kamionit.

45.3 Gjatë hetimit ka rezultuar se kontrata e huas⁴⁵ nr. ***, daton më 17.1.2017. Sipas kësaj kontrate, shtetasi L.Q, në cilësinë e huadhënësit, i jep hua shtetasit L.L, shumën 28.000 euro, për një afat njëvjeçar, duke filluar nga data 17.1.2017 deri më 17.1.2018. Në kontratë është parashikuar se kjo huadhënie do të shlyhej me interes, në shumën 100.000 lekë/muaj. Po ashtu, në kontratë është parashikuar se shlyerja e huas do të bëhet nëpërmjet një akti noterial, pasi të jetë realizuar kthimi i vlerës së dhënë hua.

45.3.1 Me aneks kontratën nr. ***, datë 26.1.2017, palët e kontratës së huas kanë nënshkruar ndryshimet mbi kontratën e huas, lidhur me afatin e shlyerjes së saj në datën 17.6.2017 dhe jo në datën 17.1.2018 dhe, njëkohësisht, huaja të shlyhet pa interes, jo sipas parashikimit të parë, ku interesi specifikohet në vlerën 100.000 lekë/muaj.

45.4 Vihet re se shitja e kamionit është kryer në vitin 2016 dhe huadhënia në vitin 2017. Veprimet financiare që i përkasin dy viteve të ndryshme kalendarike, bashkëjetuesi i subjektit i ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016. Pavarësisht deklarimeve të kryera, Komisioni, në analizën financiare, transaksionet e kryera i ka përfshirë sipas viteve përkatëse.

Lidhur me burimin e krijimit të huadhënies

45.5 Bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit deklaroi si burim krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja e mjetit kamion. Komisioni hetoi mbi këtë pasuri të luajtshme dhe nga korrespondenca me DPSHTRr-në⁴⁶ rezultoi se shtetasi L.Q ka pasur të regjistruar mjetin me targa ***. Nga dokumentacioni i administruar, rezultoi se mjeti kamion është blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.4.2016, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***, me administrator shtetasin L.L dhe palë blerëse bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit L.Q. Çmimi i shitjes: 950.000 lekë.

Më tej, në datën 13.10.2016, me kontratën nr. ***, shtetasi L.Q ia ka shitur këtë mjet shtetasit A.V, në çmimin 32.000 euro.

⁴⁴Kontratë huaje nr. ***, datë 17.1.2017, me palë huadhënëse L.Q dhe palë huamarrësi L.L të shumës 28.000 euro, për një afat njëvjeçar deri në datën 17.1.2018. Interesi që do të përfitohet çdo muaj është 100.000 lekë. Kopje ID-së. Aneks kontratë nr. ***, datë 26.01.2017, midis dy palëve, L.Q dhe L.L, të cilët kanë rënë dakord që huaja e dhënë me kontratën datë 17.1.2017, të zgjasë gjashtë muaj dhe interesi të ndryshojë nga 100.000 lekë/ ta ndryshojnë duke e lënë huan pa interes. Kopje ID-së. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁵Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁶Shkresë nr. *** prot., datë 21.1.2020.

45.6 Duke parë diferencën e dallueshme në çmimin e blerjes dhe shitjes, ku edhe vetë shoqëria “***” sh.p.k. këtë mjet përpara se ta shiste e kishte blerë në shumën 1.100.000 lekë, Komisioni ngriti dyshime për transaksionet e kryera. Për këtë arsye, Komisioni e ka pyetur⁴⁷ subjektin lidhur me faktin se si mjeti kamion është shitur me çmim më të lartë se ai i blerjes brenda një periudhe të shkurtër kohore dhe nëse është paguar tatim për fitimin e realizuar nga kjo shitje. Subjekti, në përgjigjen e saj, ka deklaruar se: *“Nëse çmimi i ulët i blerjes dhe çmimi i lartë i shitjes do kishin qenë fiktivë atëherë nuk do qëndronte logjika e sqarimeve të mëposhtme. Së pari, siç edhe sqarova më lart ky mjet është blerë me çmim të lirë, por provohet që personi nga i cili ne e kemi blerë e ka blerë me çmim të përafërt me atë me të cilin e ka shitur. Së dyti, fakti që ky mjet është shitur me çmim është një fakt i vërtetë dhe se nuk ka vend për fiktivitet për sa kohë të ardhurat nga shitja e këtij mjeti nuk kanë shërbyer për blerjen e asnjë pasurie, por thjesht janë konsumuar ndër vite. Për këtë pasuri nuk është paguar tatimi mbi fitimin për diferencën e çmimit të shitjes dhe të blerjes”.*

45.7 Subjekti ka vënë theksin⁴⁸ te shprehja e vullnetit të palëve kontraktore, lidhur me përmbajtjen dhe kushtet e përcaktuara, si për rastin konkret/ shitblerjen e kamionit, por duke e parë këtë edhe në raport me qëndrimin e Komisionit për raste të ngjashme. Subjekti ka referuar vendimin e komisionit nr. ***, datë 11.1.2021, duke vijuar të theksojë faktin se kontratat janë mjeti më i përhapur juridik në qarkullimin civil të një ekonomie tregu dhe se vullneti i palëve për lidhjen e një kontrate bazohet në: lirinë kontraktore dhe autonominë e vullnetit të palëve kontraktuese. Në rastin konkret (është shprehur subjekti), vet palët kontraktuese të përfshira në shitblerjen e kamionit në fjalë kanë shprehur lirisht vullnetin e tyre, lidhur me përmbajtjen dhe kushtet e kontratave të lidhura prej tyre dhe në asnjë moment këto kushte, përfshirë edhe çmimin nuk ka ardhur në kundërshtim me ndonjë kufizim ligjor.

45.7.1 Komisioni vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e mjetit kamion (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) nuk e ka marrë në konsideratë, për sa kohë nuk është provuar pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar nuk mund të trajtohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, kjo vlerë është zbritur nga e ardhura e arkëtuara nga shitja e mjetit kamion.

45.8 Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2016, kur është blerë dhe shitur ky mjet. Të ardhurat nga shitja e mjetit janë vendosur në vlerën 950.000 lekë, të blerjes së tij, për sa kohë që nuk u provua pagesa e tatimit mbi të ardhurat e përfituara. Gjendja *cash* për bashkëjetuesin është vendosur në vlerën 32.000 euro për fundvitin 2016, pasi deklarimi i tij se disponon shumën 400.000 lekë, i përket periudhës janar 2017, pas dhënies së huas.

Blerja e mjetit kamion është realizuar me burim krijimi nga kursimet e subjektit të rivlerësimit. Kursimet e subjektit janë pasqyruar në tabelën nr. 3, ku evidentohet se në fund të vitit 2015 dispononte shumën 2.220.204 lekë, në gjendje *cash*. Nga analiza e kryer deri në vitin 2015, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika. Në vitin 2016, subjekti e ka pakësuar gjendjen *cash*, duke blerë kamionin me targa ***, për bashkëjetuesin.

45.9 Nga analiza e kryer për vitin 2016, Komisionit i rezultoi si në tabelën vijuese:

Tabela nr. 6

Nr.	Përshkrimi	2016
1	TË ARDHURA	1,991,604
	Të ardhura nga paga subjekti	991,604
	Të ardhura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, shpërblim për sëmundje	50,000

⁴⁷Pyetësor nr. 2, datë 26.3.2021.

⁴⁸Me pyetësorin nr. 3.

	Të ardhura nga shitja e kamionit, bashkëjetuesi	950,000
2	SHPENZIME	1,617,008
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	940,368
	Shpenzime qiraje	335,000
	Paguar agjencia imobiliare per kontratën e qirasë	10,000
	Shpenzime (principal + interes), kredia në “Intesa Sanpaolo Bank” (më 13.11.2015)	222,724
	Shpenzime transporti Tiranë-Elbasan-Tiranë	108,915
3	PASURI	3,593,751
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Blerje kamioni (më 29.4.2016), me targa ***	950,000
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	2,643,751
	DIFERENCA (1-2-3)	-3,219,154

45.10 Duke marrë në konsideratë analizën e dokumentacionit të administruar, si dhe analizën financiare më lart, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi dukej se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi nuk kanë pasur mundësi financiare në shumën 3.219.154 lekë, për të kryer investimet dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare; (ii) nuk provohej pagesa e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e kamionit; si dhe (iii) dukej i dyshimtë transaksioni i shitjes së mjetit, pasi një kamion i blerë në vlerën 950.000 lekë, në prill të 2016 dhe shitur në vlerën 32.000 euro, në tetor të vitit 2016, është jashtë logjikës ekonomike.

45.11 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti parashtroi si vijon:

a. Nga dokumentacioni që bashkëjetuesi i ka vënë në dispozicion rezulton se ky kamion është blerë në datën 13.4.2016, me faturën nr. ***, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., Kavajë dhe palë blerëse shoqëria “****” sh.p.k., Tiranë, në vlerën 1.100.000 lekë.

Më tej, ky mjet është shitur me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.4.2016, nga shitësi shoqëria “****”sh.p.k., te blerësi L.Q, në vlerën 950.000 lekë.

Subjekti ka dhënë sqarime, për sa i është komunikuar dhe dokumentuar nga bashkëjetuesi i saj, mbi fushën e veprimtarisë së shoqërisë “****” sh.p.k., ku, ndër të tjera, përfshihet edhe import-eksporti i të gjitha makinave të të gjitha llojeve të tonazheve, por edhe mbi rënien në dijeni të nxjerrjes në shitje në mars të vitit 2016 të mjetit kamion me një çmim të volitshëm te shoqëria “****” sh.p.k., Kavajë, siç provohet nga fatura tatimore e shitjes.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se shoqëria “****” sh.p.k. vendosi që këtë mjet ta shiste në një periudhë të shkurtër me një çmim të njëjtë me atë të blerjes për shkak të problemeve financiare dhe nevojës për likuiditet dhe, në kushte të tilla, bashkëjetuesi i saj, i cili ra në dijeni të këtij okazioni, vendosi ta merrte.

Subjekti ka qartësuar se çmimi i blerjes së mjetit në vlerën 950.000 lekë është i përafërt/njëjtë me atë të shpenzuar nga shoqëria “****” sh.p.k., për blerjen e tij.

b. Në lidhje me diferencën midis çmimit të blerjes dhe shitjes së mjetit

Së pari, sipas sqarimeve që na ka dhënë shtetasi L.L, lidhur me çmimin e ulët të blerjes së mjetit nga shoqëria “****” sh.p.k., Kavajë, ishin problemet financiare të kësaj shoqërie, të cilat subjekti nuk ka mundësi objektive t’i provojë, pasi për këtë shoqëri nuk del asnjë e dhënë në QKB.

Së dyti, shitësi i mjetit shtetasi L.L në këtë periudhë ka kaluar probleme financiare në familje dhe në biznesin e tij, siç provohet edhe nga një situacion i gjendjes së tij financiare. Nga ky

situacion duket se shoqëria po kalonte probleme financiare të cilat vinin në ngritje, kryesisht në fillim të vitit 2016, kur është lidhur kontrata e shitjes midis tij dhe bashkëjetuesit të subjektit, kohë kur kishte nevojë për likuiditete. Gjendja e tij financiare u bë shkak që në vijim të marrë hua te bashkëjetuesi i subjektit vlerën prej 28.000 euro, të cilën, përsëri për shkak të problemeve financiare, nuk mundi ta shlyejë në afatin e përcaktuar, duke u bërë shkak për shtyrjen e shlyerjes së saj. Për shlyerjen plotësisht të huas në vitin 2018, ky shtetas ka marrë kredi në vlerën 12.000.000 lekë, në datën 11.5.2018, siç provohet nga vërtetimi bankar që subjekti ka vënë në dispozicion.

Për të provuar këtë fakt, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.7.2018, të lëshuar nga shtetasi L.L, ku, ndër të tjera, deklarohet lidhur me huan e marrë në shumën 28.000 euro në nëntor të vitit 2016, detaje të tjera mbi interesat, ndryshimet lidhur me to, pamundësinë ekonomike për të shlyer huan në kohë, etj.

Subjekti ka deklaruar se ky automjet kamion është shitur me çmim më të lartë se ai i blerjes, brenda një periudhe të shkurtër kohore, sepse ky kanë qenë vullneti i palëve. Marrëdhënia kontraktore është vullneti i lirë i palëve, përfshirë këtu edhe përcaktimin e përmbajtjes brenda kufijve ligjorë, si edhe çmimin, i cili nuk ka ardhur në kundërshtim me ndonjë kufizim ligjor.

Për sa kohë faktet nuk ndryshojnë ato merren të mirëqena, ashtu siç janë parashtruar nga palët. Kontrata është ligj për palët, si dhe për gjykatën dhe çdo institucion tjetër, për sa kohë vullneti i palëve është i qartë.

Subjekti ka referuar vendime⁴⁹ të Komisionit për raste të ngjashme, ku, ndër të tjera, citohet: *“Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin e njohur që në Shqipëri tregu i automjeteve të përdorura funksionon i tillë, madje funksionon si një biznes mjaft fitimprurës (pasi makinat blihen jashtë vendit me një çmim shumë më të lirë nga çfarë shiten në tregun e lirë)..., vlerëson se kontrata e shitblerjes është një marrëdhënie juridike private bazuar mbi një vullnet kontraktor të lirë të palëve, për pasojë, vendosja e çmimit është në vullnet të palëve”*.

c. Lidhur me çështjen e fiktivitetit në shitblerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar se është blerë nga shtetasi L.L, me faturë TVSH-je nga një shoqëri tregtare, ku vlera e TVSH-së është e rimbursueshme. Kjo tregon se nuk ka pësuar asnjë humbje për të mbuluar në dukje ndonjë veprim fiktiv. Provohet që personi nga i cili është blerë, e ka blerë me çmim të përafërt me atë me të cilin e ka shitur. Mund të ishim para një skeme fiktive, nëse shitësi do ta kishte blerë mjetin me një çmim shumë më të lartë p. sh. 32.000 euro dhe do t’ia kishte shitur bashkëjetuesit të subjektit, në vlerën 950.000 lekë, në një kohë të shkurtër, pra, me një çmim disproporcional, nga i cili do të kishte pësuar humbje të madhe. Fakti që në rastin konkret shitësi nuk ka pësuar asnjë humbje është tregues që fiktiviteti mungon.

Subjekti pretendon se fakti që ky mjet është shitur me çmim të lartë është një fakt i vërtetë dhe se nuk ka vend për fiktivitet për sa kohë të ardhurat nga shitja e këtij mjeti nuk kanë shërbyer për blerjen e asnjë pasurie në të ardhmen, por thjesht janë konsumuar ndër vite. Fakti që, ndër vite⁵⁰, nuk është vënë asnjë pasuri me paratë e fituara nga shitja e mjetit, nuk është bërë asnjë investim, tregon se nuk ka ekzistuar asnjë qëllim i tillë.

Fiktiviteti bëhet gjithmonë për të mbuluar një fakt të vërtetë e të paligjshëm për ta kamufluar atë si veprim i ligjshëm, gjë që nuk ka ekzistuar në rastin konkret, pasi realisht nuk ka pasur asnjë të tillë. Në rastin konkret mungon ana subjektive për të bërë ndonjë deklaram fiktiv për sa kohë nuk vjen asnjë përfitim prej tij.

Edhe në këtë rast, subjekti ka referuar vendimin nr. ***, datë 28.5.2021, të Komisionit, ku, ndër të tjera, citohet se: *“... një detaj tjetër që vlen të mbahet në konsideratë është edhe fakti*

⁴⁹Vendimi nr. ***, datë 11.1.2021.

⁵⁰Shihni deklaratat e pasurisë përgjatë gjithë periudhës së deklaramit 2013 – 2020.

se nga hetimi i kryer subjekti dhe personi i lidhur nuk rezultojnë ta kenë përdorur shumën cash prej 4.000.000 lekësh për të investuar në të tjera pasuri, gjë e cila do të çonte në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre ...”.

Konstatimi i ILDKPKI-së, se nga ana e bashkëjetuesit është kryer deklarim i rremë lidhur me këtë pasuri, nuk qëndron, për sa kohë mjeti është blerë dhe shitur me kontrata përkatëse përpara noterit dhe se në rastin konkret nuk po mbulohet asnjë pasuri. Nga ana e tyre nuk është shlyer asnjë prej detyrimeve që kemi pasur ndaj kredive bankare, nuk është shlyer asnjë detyrim ndaj të tretëve, të cilat janë deklaruar, ndër vite, në deklaratat periodik vjetor, madje as nuk është përdorur në marrjen e kredisë së shtëpisë në vijim, duke bërë që të merrnim kredi në vlerën 100% të banesës së blerë.

Nga kontratat që subjekti ka vënë në dispozicion rezulton se konfirmohet qëndrimi i Komisionit lidhur me faktin se *kontrata e shitblerjes është një marrëdhënie juridike private bazuar mbi një vullnet kontraktor të lirë të palëve, për pasojë, vendosja e çmimit është në vullnet të palëve.* Duket qartë që tregu i shitblerjes së mjeteve të punës është një treg i lirë dhe se çmimet vendosen rast pas rasti nga pronarët e këtyre mjeteve në marrëveshje me blerësit e tyre, çmime të cilat variojnë nga çmimet më të ulëta deri në ato më të larta pa pasur një dysheme, apo tavan të përcaktuar. Pra, vendosja e çmimeve nuk ka ndonjë rregullim ligjor të posaçëm, por çdo gjë varion sipas procesit të kërkesës dhe ofertës në tregun e lirë, siç provohet edhe nga kontratat që ka vënë në dispozicion, ku rezulton se më e lira është në vlerën 11.000 euro (ose 1.300.000 lekë), ndërsa më e shtrenjta është në vlerën 4.300.000 lekë. Ndodh që njerëzit për arsye objektive (arsye ekonomike, emigrimi, etj.) detyrohen të shesin mjetet e tyre me çmim të ulët, ndonjëherë edhe më të ulët se i blerjes, e kushtëzuar kjo kryesisht nga rrethanat ekonomike të tyre.

Subjekti ka sjellë të dhëna⁵¹ pas hulumtimeve që ka bërë në internet⁵² në portale të ndryshme, lidhur me vlerat e çmimeve të këtij mjeti. Një mjet i reklamuar në web, i njëjtë me atë të shitur nga bashkëjetuesi (është shprehur subjekti) dhe, më konkretisht, mjeti tip kamion “****”, me vit prodhimi 2006, e ka çmimin 35.000 euro. Pra, një çmim më të lartë se ai i shitur nga bashkëjetuesi i subjektit. Të gjitha këto prova provojnë se çmimet e kamionëve në tregun e lirë janë të larta dhe se çmimi i shitjes nga bashkëjetuesi i subjektit është real dhe më se i vërtetë.

Subjekti ka theksuar se fakti që një pasuri mund të blihet më lirë dhe të shitet më shtrenjtë të paktën një herë në jetë, pranohet edhe në proceset e subjekteve të tjera të rivlerësimit, referuar edhe rastit të subjektit të rivlerësimit A.K⁵³, ku rezulton se kishte kryer 3 herë transaksione të tilla, duke blerë lirë dhe duke shitur më shtrenjtë.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar edhe lidhur me transaksionet midis bashkëjetuesit dhe shtetasit L.L, të cilat janë kryer me para në dorë, duke qenë se veprimi juridik i shitjes së mjetit apo i dhënies dhe kthimit të huas janë kryer midis dy individëve, që nuk ushtrojnë veprimtari tregtare dhe, për pasojë, nuk ekziston detyrimi ligjor për transfertën e çmimit nëpërmjet sistemit bankar⁵⁴.

Subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimet e saj, ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:

- kontratë shitjeje nr. ***, datë 13.3.2015, për shitjen e mjetit kamion tip “****”, vit prodhimi 2001, në vlerën 1.500.000 lekë;

⁵¹Parashtruar në sqarimet shitesë, datë 17.1.2022.

⁵²www.publicitet.al dhe www.merrjep.al të cilët janë portale ku reklamohen mjete të ndryshme për shitje, rezulton se çmimet e mjeteve kamion të ngjashëm me atë të bashkëjetuesit kanë çmime relativisht të larta. Ka mjete të cilat janë vit prodhimi 1994 me çmim 19.000 euro, mjet tjetër vit prodhimi 2000 me çmim 25.000 euro, vit prodhimi 2002 me çmim 28.000 euro, vit prodhimi 2003 me çmim 35.000 euro, “****” me vit prodhimi 2006 me çmim 35.000 euro.

⁵³Vendimi nr. ***, datë 10.9.2021, i Komisionit.

⁵⁴Subjekti ka referuar vendimin nr. ***, datë 7.6.2018, të Komisionit.

- faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 5.9.2013, për shitjen e dy mjeteve kamion tip “***”, ku secili prej tyre ka vlerën 4.300.000 lekë/secili, duke kapur në total vlerën 8.600.000 lekë;
- faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 21.4.2021, për shitjen e mjetit kamion” tip ***”, vit prodhimi 2006, i cili kap vlerën 2.600.000 lekë;
- faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 22.10.2021, për shitjen e mjetit kamion tip “****”, në vlerën 24.000 euro;
- faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 22.10.2021 për shitjen e mjetit kamion tip “****”, në vlerën 11.000 euro;
- akt shitjeje, datë 1.11.2019, për mjetin kamion tip “****”, vit prodhimi 2008, në vlerën 12.000 euro;
- konfirmim bankar, datë 12.4.2021, nga “OTP Bank”;
- listë të ardhurash të shoqërisë së shtetasit L. L.;
- libri i blerjeve të shoqërisë “****” sh.p.k.
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.7.2018, e shtetasit L.L.;
- foto të fletës së regjistrimit noterial, ku është regjistruar kjo deklaratë noteriale;
- kontrata shitje të ngjashme për mjete tip kamion: kontrata e shitjes nr. ***, datë 13.3.2015; faturë tatimore shitje nr. ***, datë 5.9.2013; faturë tatimore shitje nr. ***, datë 21.4.2021; faturë tatimore shitje nr. ***, datë 22.10.2021; akt shitje, datë 1.11.2019, për mjetin tip kamion “****”, vit prodhimi viti 2008, në vlerën 12.000 euro.

ç. Lidhur me konceptin e pastrimit të parave⁵⁵

Subjekti, ndër të tjera, është shprehur se nuk është kryer pastrim parash. Sipas saj, pastrimi i parave është procesi i përdorur për të fshehur burimin e parave ose pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale dhe, përgjithësisht, përfshin shndërrimin e të ardhurave të krimit në një formë “të ligjshme”, kryesisht në pasuri të luajshme ose të paluajshme. Pastrimi i parave është investimi për të fshehur burimin e vërtetë. Është një veprimtari e fshehtë, është procesi i maskimit të origjinës reale të përfitimeve kriminale, të transformimit të tyre në kapital legjitim.

Në funksion të shpjegimit ka referuar përkufizimin e termit të pastrimit të parave⁵⁶ i dhënë në nenin 3, germa “b”, e Konventës së Kombeve të Bashkuara “kundër drogave narkotike dhe substancave psikotrope”, të vitit 1988, e njohur si Konventa e Vjenës, ratifikuar me ligjin nr. 8723, datë 26.12.2000, i plotësuar me akte të tjera ndërkombëtare si në Konventën Evropiane “Mbi pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të rrjedhura nga krimet”, e njohur si Konventa e Strasburgut, 8 Nëntor 1990 (ratifikuar me ligjin nr. 8646, datë 17.5.2000) dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar, e njohur si Konventa e Palermos, 12 dhjetor 2000 (ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002).

Subjekti ka parashtruar se nuk ka përfituar asgjë nga shitja e mjetit tip kamion dhe, si rrjedhim, nuk qëndron logjika e veprimit juridik fiktiv. Nuk ka asnjë sens logjik apo juridik që të kryejë deklaram të rremë për një kontratë shitje, kur të ardhurat nga shitja vetëm janë harxhuar/konsumuar. Subjekti ka ripërsëritur qëndrimin e saj lidhur me çmimet e shitjes së mjetit kamion, të cilat nuk janë fikse, por variojnë, në ndryshim nga referencat që kanë pasuritë e paluajshme kur shiten, për të cilat ka kufizim ligjor dhe ligji, gjithashtu, ka parashikuar edhe organin kontrollues ndaj kufizimit.

Subjekti ka qartësuar se për pasuritë e luajshme vendosja e çmimeve nuk ka ndonjë rregullim ligjor të posaçëm dhe çdo gjë varion sipas raportit të kërkesës dhe ofertës në tregun e lirë, siç

⁵⁵Prapësuar në parashtrimet e dhëna në seancën dëgjimore datë 15.1.2021.

⁵⁶ “(i) shkëmbimin ose transferimin e pasurive duke e ditur se këto pasuri kanë rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme..., me qëllimin e fshehjes ose mbulimit e origjinës së paligjshme të pasurive ose me qëllimin e dhënies së ndihmës ndonjë personi që është përfshirë në kryerjen e një veprimtarie të kundërligjshme; (ii) fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë, të burimit, të vendndodhjes, të sistemimit, të lëvizjes të të drejtave në lidhje me pasurinë ose pronësinë e pasurisë, duke ditur se një pasuri e tillë ka rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme...”.

provohet edhe nga kontratat që subjekti ka vënë në dispozicion, ku rezulton se më e lira kap vlerën 11.000 euro (ose 1.300.000 lekë), ndërsa më e shtrenjta kap vlerën 4.300.000 lekë.

d. Lidhur me kohën e dhënies së huas dhe gjendjen *cash* në shumën 400.000 lekë të deklaruar nga bashkëjetuesi i subjektit në deklaratën për vitin 2016, në raport me kontratën e huas nënshkruar në vitin 2017, subjekti ka shpjeguar se kjo gjendje i përket vitit 2016, pasi huaja është dhënë verbalisht në nëntor të vitit 2016 dhe jo në janar të vitit 2017, sipas kontratës së huas dhe ky fakt provohet nga disa prova.

Subjekti ka cituar deklarinimin e gjendjes *cash* të bërë nga bashkëjetuesi i saj në DVP-në e vitit 2016. Ka saktësuar se deklarata e pasurisë së vitit 2016 provon faktin, që në datën 31.12.2016 paratë e ardhura nga shitja e mjetit nuk ishin gjendje (*cash* apo në sistemin bankar), pasi i ishin dhënë hua shtetasit L.L. Në këtë deklaratë, thjesht nuk është cituar shprehimisht që paratë janë dhënë verbalisht në nëntor të vitit 2016 e në vijim në janar të vitit 2017 është formalizuar me shkrim. Por, nga përmbajtja e deklarinimit të bashkëjetuesit del qartë që paratë e ardhura nga shitja e mjetit nuk kanë qenë gjendje *cash* në datën 31.12.2016, pasi i ishin dhënë më parë huamarrësit. Ky është vullneti i qartë i bashkëjetuesit i shprehur në deklaratën e pasurisë së vitit 2016. Duke qenë se deklarata e pasurisë së vitit 2016 plotësohet në mars të vitit 2017, ka bërë që gabimisht t'i referohet ekstremiteteve të kontratës së huas së lidhur në janar të vitit 2017, kur i referohet huas së dhënë. Në këtë deklaratë bashkëjetuesi deklaroi kontratën e huas së lidhur verbalisht me shtetasin L.L. në nëntor të vitit 2016 (edhe pse gabimisht i referohet ekstremiteteve të kontratës me shkrim në janar të vitit 2017), si dhe gjendjen *cash* të mbetur pas kontratës së huas.

Subjekti ka ricituar edhe një herë deklaratën nr. ***, datë 24.7.2018, e shtetasit L.L. ku, ndër të tjera, deklarohet koha e marrjes së huas, duke theksuar edhe faktin se kjo deklaratë është lëshuar në korrik të vitit 2018, kohë më parë se të njihesha me rezultatet e hetimit.

Ka theksuar se kontrata e huas është veprim juridik jo formal, pra, nuk kërkon formën shkresore, as me shkresë të thjeshtë, as me akt noterial për vlefshmërinë e saj. Mjafton edhe një kontratë verbale midis palëve për dhënien e huas dhe ajo është plotësisht e vlefshme dhe sjellë pasojat e dëshiruara.

Subjekti, gjithashtu, ka qartësuar edhe momentin dhe arsyen e lidhjes së kontratës së huas, për shkak të detyrimit të lindur dhe kërkesave që duheshin përmbushur në plotësimin e deklaratës *Vetting*.

Subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimet e saj, ka paraqitur dokumentacionin në vijim:

- kontratën e huas nr. ***, datë 17. 1.2017;
- deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.7.2018, të shtetasit L.L.;
- një foto të fletës së regjistrimit noterial, ku është regjistruar kjo deklaratë noteriale;
- deklaratën periodike vjetore të vitit 2016; si dhe
- në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e mjetit tip kamion.

dh. Lidhur me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e kamionit

Subjekti, ndër të tjera, në shpjegime lidhur me këtë çështje, ka sqaruar se pasi është pyetur me pyetësin nr. 2, lidhur me dokumentacionin provues mbi pagesën e tatimit, për fitimin e realizuar nga diferenca e krijuar ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes për mjetin tip kamion, është përgjigjur se *për këtë pasuri nuk është paguar tatimi mbi fitimin për diferencën e çmimit të shitjes dhe të blerjes*, madje pa e verifikuar informacionin, kjo për shkak të bindjes së saj.

Subjekti është shprehur se përgjigja e saj e shkurtër dhe formale ka ardhur pasi nuk ka qenë palë e këtij veprimi juridik dhe nuk ka pasur dijeni të plotë dhe të saktë lidhur me pagesat që mund të ketë bërë bashkëjetuesi. Ka vijuar të sqarojë se ka pyetur fillimisht bashkëjetuesin lidhur me këtë tatim duke qenë se veprimi juridik i shitblerjes ishte kryer prej tij, i cili nuk

mbante mend me saktësi lidhur me llojin e pagesës së kryer dhe i ka qëndruar bindjes së saj se nuk duhet të paguhet tatim mbi këtë të ardhur.

Subjekti ka parashtruar analizën juridike bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Ky transaksion (shitblerja e mjetit nga bashkëjetuesi) është i përjashtuar nga detyrimi për tatimin mbi të ardhurat, duke iu referuar nenit 4 të ligjit nën titullin “Burimi i të ardhurave”. Kjo logjikë mbështetet në vijim edhe nga neni 8 i ligjit të sipërcituar, i cili nën titullin “E ardhura e tatueshme”. Edhe nga ky nen konstatohet se të ardhurat nga shitja e një automjeti të luajtshëm nuk parashikohet shprehimisht në ligj si e ardhur e tatueshme. Të ardhurat që i nënshtrohen tatimit nga ky ligj janë ato të ardhura që realizojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të ardhur për një person fizik apo juridik, si p.sh. pagat, dividendët etj., ose të ardhura që lidhen me pasuri të paluajtshme si tjetërsimi apo dhënia me qira e pasurive të paluajtshme. Lidhur me këtë ligj, në nenin 11 të tij parashikohet mënyra e pagimit të tatimit për të ardhurat që vijnë nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ku përcaktohet se: “2. *Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.*”

Ligji i mësipërm ka parashikuar shprehimisht si e ardhur e tatueshme të ardhurat nga tjetërsimi i një pasurie të paluajtshme dhe po ashtu ka rregulluar mënyrën e pagimit të tatimit, i cili kontrollohet nga noteri përndryshe veprimi juridik nuk regjistrohet si rrjedhim nuk kalon as pronësia mbi sendin duke mos sjellë pasojën e dëshiruar. Në rast se një detyrim i tillë do të ishte edhe për pasuritë e luajtshme përfshi edhe automjetet atëherë ligjvënësi do kishte parashikuar shprehimisht mënyrën e pagimit dhe filtrin e kontrollit ndaj këtij veprimi juridik dhe pasojën e mosrespektimit të tij, që do ishte pamundësia për regjistrimin e mjetit në favor të blerësit të ri. Por, në këtë ligj mungon një parashikim i tillë ligjor, si dhe nisur nga gjithë fryma e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk kërkohet pagimi i tatimit mbi këtë të ardhur.

Mbi kërkesën e bashkëjetuesit drejtuar Drejtoria së Përgjithshme të Tatimeve, “Nëse në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të legjislacionit në fuqi, ndër vite, a janë tatuar apo tatohen shumat monetare të përfituara nga individët nëpërmjet shitjes së mjeteve?”, ky institucion ka bërë interpretim ligjor të faktit, nëse të ardhurat nga shitja e mjeteve bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 8, si dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, i ndryshuar, janë apo jo të ardhura të tatueshme, duke sqaruar se në nenin 8 të ligjit, kategoritë e të ardhurave personale janë shteruese dhe sqarimi për të ardhurat personale që përfshihen në pikën “g”, të nenit të sipërcituar është dhënë në pikën 2.3.9 të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, i ndryshuar, të sipërcituar, të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së luajtshme (në rastin e paraqitur në shkresën tuaj, makinë) nuk janë të ardhura të listuara në nenin 8 “Të ardhura të tatueshme”, si dhe në pikën 2.3 të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, i ndryshuar, në zbatim të dispozitave ligjore”.

Me anë të kësaj shkrese DPT-ja, si organi kompetent për vjeljen e taksave dhe tatimeve në vend, konfirmon, pikërisht, qëndrimin e subjektit, që për këtë të ardhur nuk duhet paguar tatim. Sipas këtij institucioni, për sa kohë të ardhurat nga shitja e mjeteve nuk parashikohen në mënyrë taksative në nenin 8 të ligjit, nuk mund të futen as në pikën “g”, të këtij neni “të ardhura të tjera”, e cila është trajtuar në mënyrë shteruese në pikën 2.3.9 të Udhëzimit nr. 5, viti 2006, të Ministrisë së Financave.

Subjekti ka mbajtur korrespondencë me DPT-në edhe për të interpretuar ligjërisht se si është parashikuar taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme automjete.

Pas njohjes me rezultatin e hetimit, subjekti ka depozituar shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 21.10.2021, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, ku thuhet se: “Bazuar në

*kërkesën tuaj të datës 19.10.2021 protokolluar pranë DRT-së Tiranë me nr.*** prot., datë 20.10.2021, për pajisje me vërtetim për të ardhurat nga shitja e pasurisë së bashkëjetuesit L.Q, nga verifikimi i të dhënave në sistemin elektronik tatimor C@TS, rezulton se, z. L.Q ka deklaruar të ardhura në vitin 2016, në shumën 3.114.00 (tre milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë) dhe ka paguar tatim për këtë të ardhur në shumën 467.100 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind) lekë”.*

Subjekti ka shpjeguar se gjatë seancës publike të zhvilluar për të, pyetjes lidhur me datën e pagesës i është përgjigjur se nuk ka dijeni lidhur me datën e saktë të bërjes së pagesës dhe se i vetmi dokument që ajo dispononte ishte vërtetimi që ai e kishte paguar, por nisur nga përmbajtja e shkresës linte të kuptohej se ishte kryer në afat.

Sipas informacionit të marrë nga DRT-ja Tiranë, rezulton se bashkëjetuesi i subjektit, me vullnetin e tij dhe pa u konsultuar me të, ka kryer pagesën e tatimit në datën 28.5.2021.

Subjekti ka theksuar se: *“Nëse do ia kisha kërkuar unë kryerjen e kësaj pagese së pari, minimalisht do kisha kërkuar që ta kryente atë përpara se t’i përgjigjesha pyetësorit nr. 2, së dyti, do kisha paraqitur në vijim kryesisht shkresën e tatimeve që pagesa ishte kryer, para paraqitjes së raportit nga ana juaj, e së treti, do dija t’i përgjigjesha me saktësi në seancë rreth datës së bërjes së pagesës. Pra, tashmë është institucioni kompetent shtetëror që më jep një përgjigje shteruese rreth faktit nëse ishte paguar apo jo tatimi, për të cilin bashkëjetuesi nuk e kujtonte me siguri, duke qenë se ky veprim ishte kryer para disa vitesh dhe nën këshillat sugjeruese të noterit e jo për shkak të ndonjë detyrimi ligjor të kohës.*

Nisur nga këto rrethana të reja të dala pas njohjes me rezultatin e hetimit, kam kërkuar që të merren në konsideratë provat e reja të paraqitura prej meje dhe të bëhet rilogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve duke i konsideruar si të ligjshme të gjitha të ardhurat nga shitja e mjetit duke bërë që në fund të vitit 2016 balanca të jetë pozitive.

Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, vlerësoj se edhe nëse nuk do të ishte paguar tatimi për këtë të ardhur përsëri nuk duhet të ngarkohem me përgjegjësi për dy arsye:

- *Së pari, sepse shuma e ardhur nga shitja e këtij mjeti në vitin 2016 nuk ka shërbyer për shtimin e asnjë pasurie tjetër në të ardhmen, në mënyrë që të më ngarkohet barrë prove për ligjshmërinë/paligjshmërinë e pasurisë së shtuar. Nuk ka asnjë pasuri të shtuar, pasi këto të ardhura janë përdorur vetëm për shpenzime jetese, përveç atyre të nevojshme sipas INSTAT-it, por gjithmonë për shpenzime nën vlerën 300.000 lekë.*
- *Së dyti, në lidhje me shpenzimet e jetesës dua të theksoj se edhe nëse nuk do të ishin të ardhurat nga shitja e mjetit, përsëri shpenzimet e nevojshme të jetesës së familjes sime sipas INSTAT-it mund të mbuloreshin nga të ardhurat e ligjshme (paga, dhurata nga vëllai dhe kursimet ndër vite) duke bërë që të ardhurat e mjetit të mos kishin asnjë vlerë/ndikim në gjendjen time financiare”.*

Në këtë vërtetim përcaktohej se bashkëjetuesi kishte deklaruar shumën 3.114.000 lekë të ardhura në vitin 2016 dhe kishte paguar tatimin 467.100 lekë dhe nuk përcaktohej pagimi i ndonjë gjobe apo penaliteti të ndryshëm si pasojë e bërjes së pagesës me vonesë.

Subjekti ka parashtruar se edhe pse rezulton se bashkëjetuesi ka paguar vlerën 467,100 lekë tatime dhe vlerën 220,634 lekë penaltete dhe gjoba si pasojë e pagesës në vonesë, ajo është vënë në dijeni të datës së saktë të pagesës vetëm në datën 24.11.2021, pas marrjes së dokumentacionit të detajuar nga DRT-ja Tiranë dhe se për të nuk paraqet kurrësi rëndësi data e bërjes së pagesës, pasi në bindjen e saj ligjore bazuar në legjislacionin tatimor në vend, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe të shkresave të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ky tatim nuk duhet paguar.

Lidhur me përgjigjen e DPT-së⁵⁷ ku kërkohet *interpretim ligjor si është parashikuar taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme automjete*, rezulton e qartë se nëse ligjvënësi donte ta taksonte transferimin e së drejtës së pronësisë mbi automjetet do ta linte në fuqi këtë taksë, por e shfuqizoi atë.

Bazuar në përgjigjet e DPT-së⁵⁸, për sa kohë ky tatim nuk kërkohet në mënyrë eksplicite në nenin 8 të ligjit, as në pikën (g) “të ardhura të tjera”, e cila është interpretuar në mënyrë shteruese në pikën 2.3.9 të udhëzimit nr. 5/2006, është shfuqizuar nga ligji “Për taksat kombëtare” do të thotë se ky tatim në mënyrë të qartë, të saktë dhe pa ekuivoqe nuk duhet të paguhet. Ky ka qenë qëndrimi i subjektit (shprehet ajo), koherent si para dhe pas seancës dëgjimore.

Në funksion të shpjegimeve referohet jurisprudenca e Kolegjit⁵⁹, ku sipas subjektit është bërë interpretimi i legjislacionit tatimor në parim lidhur me faktin nëse një e ardhur që nuk është parashikuar shprehimisht as në nenin 8 të ligjit dhe as në pikën 2.3.9 udhëzimit nr. 5 është apo jo e ardhur e tatueshme dhe, në përfundim, është unifikuar se ato të ardhura që nuk parashikohen as në nenin 8 të ligjit dhe as në pikën 2.3.9 të udhëzimit nr. 5 nuk taten në asnjë rast, madje për këto të ardhura edhe pse mund të jenë në shumën mbi 2.000.000 lekë nuk paguhet as DIVA, pasi nuk ka një rubrikë të veçantë për këto lloje të ardhurash, si dhe vendimi nr. 18/2008 i Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti është shprehur se në tërësi të interpretimeve të bëra nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për sistemin e taksave/tatimeve duhet detyrimisht që taksat dhe tatimet të parashikohen në mënyrë eksplicite dhe të qartë, taksapaguesit nuk mund të ngarkohen me këtë detyrim dhe as të ndëshkohen disiplinarisht sepse nuk kanë supozuar/nënkuptuar apo zgjedhur si opsion pagimin vullnetar të këtij “detyrimi”.

Megjithatë, edhe nëse Komisioni do të mbajë qëndrimin që ky tatim duhet paguar, atëherë duhet të pranojë kryerjen e saj edhe me vonesë, bazuar në praktika të mëparshme të ngjashme për subjekte të tjera rivlerësimi⁶⁰.

Sipas subjektit, Komisioni duhet të marrë në konsideratë faktin që personi që ka realizuar të ardhurat ka qenë personi i lidhur dhe jo subjekti i rivlerësimit, faktin që ligji nuk ka qenë asnjëherë i qartë lidhur me tatimin e kësaj të ardhure, faktin që nga veprimet e mëpasshme të subjektit dhe të personit të lidhur nuk rezultoi i provuar asnjë qëllim për vënien e ndonjë pasurie me burim të ardhurat nga shitja e mjetit, faktin që subjekti nuk ka realizuar asnjë përfitim pasuror nga këto të ardhura, shkaqet e mospagimit në kohë nga bashkëjetuesi që nuk kanë qenë në keqbesim dhe profilin e tij profesional duke mos pasur njohuri të posaçme në fushën e së drejtës.

Nisur nga përmbajtja e gjithë legjislacionit tatimor, praktikës gjyqësore të Kolegjit dhe shkresave të institucioneve tatimore, subjekti i qëndron bindjes së saj se ky tatim nuk duhet paguar dhe, si rrjedhim, bashkëjetuesi ka paraqitur një kërkesë drejtuar DPT-së me objekt “kthim shume”, bazuar në nenin 653 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, pasi ka kaluar në favor të tij një shumë të hollash të cilat ky i fundit nuk duhet t’i kishte arkëtuar.

Në përfundim, subjekti duke renditur rrethana të tilla si: (i) jemi para një të ardhure për të cilat nuk duhet paguar tatimi sipas legjislacionit tatimor në fuqi, shkresave zyrtare të institucioneve dhe vendimit të Kolegjit, e cila i cilëson këto të ardhura si të ardhura të patatueshme; (ii)

⁵⁷Përgjigje nr. *** prot., datë 23.11.2021.

⁵⁸Referuar në shpjegimet e subjektit datë 25.11.2021, dy shkresat nr. *** prot., datë 23.11.2021 dhe nr. *** prot., datë 12.11.2021.

⁵⁹Vendimin nr. ***, datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për subjektin e rivlerësimit K.S.

⁶⁰Referuar vendimeve nr. ***, datë 1.8.2018, nr. ***, datë 24.7.2019 dhe nr. ***, datë 25.7.2018, të Komisionit, si dhe vendimit nr. ***, datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

pavarësisht se në qëndrimin tim nuk duhet paguar tatimi, nga ana e bashkëjetuesit është paguar ky tatim, i cili edhe pse gjatë procesit të rivlerësimit duhet të merret si e ardhur e ligjshme, bazuar në të gjitha praktikat e ndjekura më parë nga Komisioni. Vendimet e ngjashme janë analizuar më lart; (iii) edhe nëse nuk do të konsiderohen si të ligjshme nuk duhet të më ngarkojë me përgjegjësi për tri arsye: (a) sepse shuma e ardhur nga shitja e këtij mjeti është pasuri e veçantë e bashkëjetuesit dhe unë nuk kam asnjë interes pasuror lidhur me to. Unë nuk e kam përdorur kurrë pasurinë në fjalë dhe as të ardhurat nga kjo pasuri; (b) shuma e ardhur nga shitja e këtij mjeti në vitin 2016 nuk ka shërbyer për shtimin e asnjë pasurie tjetër në të ardhmen, në mënyrë që të më ngarkohet barrë prove për ligjshmërinë/paligjshmërinë e pasurisë së shtuar. Nuk ka asnjë pasuri të shtuar, pasi këto të ardhura janë përdorur vetëm për shpenzime, nën vlerën 300.000 lekë; (c) në lidhje me shpenzimet e jetesës dua të theksoj se edhe nëse nuk do të ishin të ardhurat nga shitja e mjetit përsëri shpenzimet e nevojshme të jetesës së familjes sime sipas INSTAT-it mund të mbuloreshin nga të ardhurat e ligjshme (paga, dhuratat nga vëllai dhe kursimet ndër vite) duke bërë që të ardhurat e mjetit të mos kishin asnjë vlerë/ndikim në gjendjen time financiare, për rrjedhojë, Komisioni t'i konsiderojë këto të ardhura si të ligjshme⁶¹.

Subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimet e saj, ka paraqitur⁶² dokumentacionin e mëposhtëm:

- kërkesë drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë;
- vërtetim nr. ***, datë 20.10.2021, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë;
- shkresë nr. *** prot., datë 12.11.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë (e administruar para seancës dëgjimore);
- shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë (e administruar pas seancës dëgjimore);
- vendim nr. ***, datë 18.6.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit;
- kërkesë datë ***, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- kthim përgjigje e DPT-së me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2021;
- kërkesë datë 16.11.2021, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë;
- vërtetim nr. ***, datë 24.11.2021, i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë, bashkëlidhur printim nga sistemi lidhur me datën e bërjes së pagesës dhe shumat përkatëse;
- kërkesë drejtuar DRT-së Tiranë për kthimin e shumës nga bashkëjetuesi;
- fotografi të ndryshme të mjeteve tip kamion, lidhur me çmimet e tyre në tregun e lirë;
- vendimi nr. ***, të 10.9.2021, i Komisionit.

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se nuk janë bindëse për arsyet e mëposhtme:

1. Nga subjekti, në parashtrimet e saj, është shpjeguar se huaja është dhënë në muajin nëntor të vitit 2016. Ky fakt nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën *Vetting* nga bashkëjetuesi i subjektit, i cili në këtë deklaratë ka deklaruar se huaja është dhënë me kontratë huaje datë 17.1.2017.
2. Nga hetimi në lidhje me automjetin tip kamion ka rezultuar se bashkëjetuesi i subjektit e ka blerë kamionin nga shoqëria *** sh.p.k. (administrator dhe ortak i të cilës është z. L.L) në datën 29.4.2016, vetëm 16 ditë nga blerja e këtij kamioni nga kjo shoqëri te shoqëria “****” sh.p.k. Ky automjet është blerë në vlerën 950.000 lekë, ndërkohë që shoqëria *** sh.p.k. e ka blerë në vlerën 1.100.000 lekë. Më pas, ky automjet është shitur për shumën 32.000 euro ku 28.000 euro të kësaj shume i janë dhënë hua shitësit të këtij automjeti z. L.L.

⁶¹Parashtrime shtesë të subjektit datë 25.11.2021.

⁶²Me parashtrimet e datave 3.11.2021, 25.11.2021 dhe 17.1.2022.

Këto veprime të kryera midis bashkëjetuesit të subjektit dhe z. L janë veprime, të cilat nuk përputhen me logjikën ekonomike.

3. Në lidhje me pretendimin e vështirësisë financiare të z. L, ky pretendim nuk qëndron, pasi siç rezulton, ai ka arritur të marrë një kredi në vitin 2018 në vlerën 12.000.000 lekë, si dhe nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që shoqëria e tij të ketë pasur probleme financiare, pasi referuar pasqyrave financiare të vitit 2016, të aksesuara nga ekstrakti historik në QKB, shoqëria për vitin 2016 rezulton me një xhiro prej 29.717.339 lekësh dhe fitim pas tatimit në vlerën 2.656.795 lekë dhe për vitin 2015 me një xhiro prej 36.979.225 lekësh dhe fitim pas tatimit në vlerën 1.535.497 lekë. Nëse z. L do të ishte në vështirësi ekonomike, mund të merrte kredi sikundër ka ndodhur më vonë dhe mund të priste momentin e duhur për të shitur automjetin dhe jo të shiste automjetin të bashkëjetuesi i subjektit për t'i marrë më pas hua vlerën e përfituar nga shitja e këtij automjeti.
4. Ndryshimi i kontratës së huas brenda tre muajve nga një kontratë me interes në një kontratë pa interes tregon sërish për veprime fiktive midis bashkëjetuesit të subjektit dhe z. L.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se nuk jemi në kushtet e fiktivitetit, pasi nuk ka blerë asnjë pasuri, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk përputhet me veprimet e bashkëjetuesit të saj, i cili këtë shumë e ka përdorur për t'ia dhënë hua z. L, duke e bërë pjesë edhe të deklaratës *Vetting*, për rrjedhojë shuma 32.000 euro ka shërbyer si burim për dhënien e huas z. L në shumën 28.000 euro dhe, për pasojë, është objekt i vlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016. Subjekti dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për t'ia dhënë hua z. L shumën 28.000 euro, për rrjedhojë çmimi i shitjes i vendosur në shumën 32.000 euro ka shërbyer për të justifikuar me burime të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro.

5. Subjekti, në parashtrimet e saj, është përpjekur të justifikojë çmimin e shitjes nga bashkëjetuesi në vlerën 32.000 euro të kamionit, duke sjellë të dhëna nga disa portale, të dhëna që konfirmojnë faktin se blerja e këtij automjeti nga bashkëjetuesi i subjektit në shumën 950.000 lekë nuk është e justifikueshme.

Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pikërisht, për atë që ajo me pretendimet e saj ka dashur të provojë, pra që për Komisionin ka qenë e dyshimtë që një automjet është blerë në shumën 950.000 lekë dhe është shitur në vlerën 32.000 euro. Nga pretendimet e sjella nga subjekti ky dyshim i Komisionit provohet, pasi bazuar në provat e sjella nga subjekti ky kamion nuk mund të shitej në një vlerë prej 950.000 lekësh, kur në tregun e lirë minimalisht mund të shitej në shumën 19.000 euro dhe maksimalisht në shumën 35.000 euro.

Në përfundim, Komisioni, në lidhje me marrëdhënien e krijuar midis z. L dhe bashkëjetuesit të subjektit, për sa i përket veprimeve ekonomike me automjetin tip kamion dhe dhënies së huas duke iu referuar edhe vendimeve nr. *** datë 23.2.2022⁶³, nr. *** datë 19.11.2018, dhe nr. ***, datë 23.9.2019, të Kolegjtit, krijon bindjen se gjendet në kushtet e një marrëdhënieje fiktive të parashikuar nga neni 92 i Kodit Civil, pasi pavarësisht se palët janë të lira të përcaktojnë çmimet e shitjes dhe pavarësisht se nuk ka çmime reference për shitblerje automjetesh, vlera e shitjes së kamionit është jashtë logjikës ekonomike, si dhe ka pasur për qëllim të justifikojë me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro z. L duke u krijuar bindja për një skemë pastrimi parash.

⁶³Trupi gjykues vlerëson se dyshimet e Komisionit që kishin nisur nga vlera relativisht e lartë e shitjes së sendeve aksesore, nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanave, në mënyrë të ndryshme nga aktet notoriale dhe shkresa bankare, në kushtet kur bindja e Komisionit lidhur me shitjen e sendeve nuk është shoqëruar me shkaqe pavarësisht të veprimit juridik, sipas parashikimeve të nenit 92 të Kodit Civil dhe në kushtet kur palët në kontratë, në përputhje me nenin 660 të Kodit Civil, kanë të drejtë të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosur nga legjislati në fuqi.

Komisioni, në lidhje me këtë marrëdhënie, mban në konsideratë edhe faktin e kryerjes së veprimeve *cash* dhe pa asnjë dokument deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* nga subjekti.

6. Në lidhje me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga diferenca e blerjes dhe shitjes së kamionit, subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, ka dhënë deklarime kontradiktore si vijon:
 - i. Fillimisht, në pyetësonin nr. 2, të datës 26.3.2021, subjekti ka deklaruar se nuk ka paguar detyrimet tatimore për diferencën e çmimit të blerjes dhe të shitjes së kamionit.
 - ii. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2021, sipas së cilës bashkëjetuesi i saj kishte deklaruar të ardhura në vitin 2016 në shumën 3.114.000 lekë dhe kishte paguar detyrimet tatimore në shumën 467.100 lekë.
 - iii. Pyetjes së Komisionit në seancë dëgjimore të datës 15.11.2021 në lidhje me kohën e pagimit të detyrimeve tatimore subjekti iu përgjigj se nuk kishte dijeni në lidhje me datën e saktë të bërjes së pagesës.
 - iv. Nga hetimi rezultoi se pagesa e detyrimeve tatimore ishte bërë në datën 28.5.2021.
 - v. Subjekti, pavarësisht se kishte paguar detyrimet tatimore me vonesë, ka ndryshuar sërish qëndrim në lidhje me këtë detyrim duke deklaruar se bazuar në shkresën e DRT-së Tiranë nuk kishte detyrimin për të paguar tatim në burim për diferencën e çmimit të blerjes dhe të shitjes së kamionit.

Komisioni vlerëson se qëndrimi i subjektit në lidhje me këtë pasuri ka qenë kontradiktor. Ajo është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë marrëdhënie, duke krijuar konfuzion edhe te Komisioni në lidhje me qëndrimin e saj. Komisioni vlerëson se qëndrimi i subjektit nuk është në përputhje me etikën e magjistratit, duke u nisur edhe nga fakti se ajo ka marrë tagrat e një gjykate, duke bërë individualisht një interpretim të ligjit tatimor dhe bazuar në këtë interpretim i ka kërkuar institucionit tatimor kthimin mbrapsht të tatimit të paguar.

Komisioni, bazuar në:

- i. vendimin nr. ***, datë 2.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit ku parashikohet se: *“Nga ana tjetër, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim prej këtyre transaksioneve, në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”), i cili përcakton se: Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë. Nën dritën e sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016”;*
- ii. vendimin nr. ***, datë 22.5.2019, të Kolegjit sipas së cilës: *“Sa u takon pretendimeve të Komisionerit Publik lidhur me moskonsiderimin si të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat e realizuara nga shitja e dy automjeteve, për sa kohë rezulton që subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim prej këtyre*

transaksioneve, trupi gjykues, në vlerësim të parashikimeve të nenit 8, pika 1, germa 'g' e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, i cili përcakton se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merret si e ardhur e tatueshme çdo e ardhur tjetër e realizuar nga individë rezidentë, që nuk identifikohet në format e paraqitura në këtë nen dhe për sa kohë e ardhura e realizuar nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i Komisionerit Publik është pjesërisht i bazuar në ligj, vetëm për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), për sa kohë nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë iu zbrit të ardhurës së arkëtuar nga shitja e këtyre automjeteve, duke u pasqyruar në rezultatin financiar të vitit përkatës”;

- iii. vendimin nr. ***, datë 23.9.2019, të Kolegjit, ku parashikohet se: “Nga shqyrtimi i akteve që gjenden në dosjen e gjykimit nuk rezulton që për këtë shitje subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur të kenë paguar tatim-fitimi për të ardhurën rreth 2,755,000 lekë (20,000 euro) të realizuar nga shitja e autoveturës së mësipërme, apo për fitimin prej 2,155,000 lekësh si diferencë e çmimit të blerjes, 600,000 lekë, në vitin 2009 dhe çmimit të shitjes 2,755,000 lekë (20,000 euro), në vitin 2010. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë nuk ka përcjellë asnjë informacion lidhur me pagesën e ndonjë tatimi mbi këtë shitje. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë shpenzimet e bëra nga personi i lidhur për rritjen e vlerës së automjetit, në mënyrë që më pas ta shiste për një vlerë rreth 4 herë më të lartë se çmimi i blerjes së tij”;
- iv. vendimin nr. ***, datë 23.11.2021, të Kolegjit, ku parashikohet se: “Në lidhje me qiratë e dyqanit, përderisa rezulton se subjekti ka pasur detyrimin sipas kontratave të qirasë për pagimin e detyrimeve tatimore, pagimi jo në kohë i tyre tregon për moszbatimin e këtij detyrimi ligjor prej subjektit në kohën kur ai ka lindur, për pasojë pagimi me vonesë i këtij detyrimi, në referim të vendimit nr. ***, datë 18.6.2021, të Kolegjit, nuk e shëron paligjshmërinë e këtyre të ardhurave”;
- v. vendimin nr. ***, datë 18.6.2021, të Kolegjit, ku parashikohet: “Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, pagimi i tatimit për shumën prej 18.000 euro, në janar të vitit 2017, për shkak të rrethanave të mësipërme që lidhen me qasjen dhe sjelljen e personit të lidhur për mospagimin në kohë të tij, nuk shëron paligjshmërinë e kësaj të ardhure në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19, e ligjit nr. 84/2016. Kolegji edhe për këtë afektim të burimeve të ligjshme të përdorura për financimin e pasurive “apartament” dhe “garazh” në pronësi të subjektit, do të vlerësojë peshën e saj në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, për shkak të një vlerësimi që lidhet me të gjitha rrethanat e çështjes”,

vlerëson të mos përfshijë në analizë financiare shumën e përfituar nga diferenca e blerjes dhe e shitjes të automjetit kamion. Për rrjedhojë rezulton se subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 3.219.154 lekë për të kryer investimet dhe përballuar shpenzimet familjare në vitin 2016, ku përfshihet edhe dhënia e huas në shumën 28,000 euro z. L.L.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit/bashkëjetuesi i saj:

- a. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 3.219.154 lekë për t'i dhënë huan z. L.L, si dhe për të mbuluar shpenzimet e tjera në vitin 2016.
- b. Ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me huan, dhënë z. L.L, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se është dhënë në vitin 2017 ndërsa gjatë hetimit kanë deklaruar se është dhënë në vitin 2016.

c. Ka kryer veprime fiktive në lidhje me automjetin tip kamion, si dhe ka kryer deklaram të rremë.

Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë, të rremë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a”, “b” dhe “ç” të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi çmimi i referuar në kontratën e shitjes, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të shitjes së kamionit.

45.12 Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit

Për nevoja të hetimit administrativ, Komisioni ka mbajtur korrespondencë⁶⁴ edhe me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit, të cilat në përgjigjet⁶⁵ e tyre, në asnjë rast nuk konfirmuan zhvillimin e ndonjë procesi gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “***” sh.p.k. me administrator shtetasin L.L, me këtë të fundit si person, apo edhe me shtetasit e tjerë A.V dhe F.P⁶⁶.

- Në të tilla kushte trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

45.13 Komisioni, nisur nga fakti që bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka ndërtuar disa marrëdhënie me shtetasit L.L, A.V dhe F.P, si: (i) shitblerje automjeti të tipit kamion; (ii) huadhënie; (iii) marrje automjeti në përdorim; si dhe (iv) në raport me një shkrim të bërë publik në media⁶⁷ (ku identifikohet shtetasi L.L dhe shtetasi me initiale L. Q., bashkëjetuesi i subjektit, i cili duket se është përfshirë në një konflikt në një prej zonave të Tiranës) ka mbajtur korrespondencë⁶⁸ me organet ligjzbatuese për të mësuar mbi çështje të kallëzuara apo të regjistruara në ngarkim të bashkëjetuesit të subjektit, si dhe shtetasve të lartpërmendur, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

45.14 Nga administrimi i përgjigjeve institucionale rezultoi se prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë nuk kanë konfirmuar kallëzime apo procedime penale të regjistruara në ngarkim të shtetasit L.Q.

45.15 Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë⁶⁹ (me përjashtim të atyre të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) nuk kanë konfirmuar kallëzime apo procedime penale të regjistruara në ngarkim të shtetasit L.L.

45.15.1 Në lidhje me kallëzimet penale dhe procedimet e regjistruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁰ rezultoi se në ngarkim të shtetasit L.L janë regjistruar procedimet penale: nr. ***, për veprën penale “mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, çështje kjo e pushuar me vendimin nr. ***, datë 14.4.2014, për veprën penale “fshehje e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/2, çështje kjo e cila sipas informacionit të ardhur rezulton të jetë dërguar për gjykim; nr. ***, për veprën penale “fshehje e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/2, çështja kjo e cila sipas informacionit rezulton të jetë nën hetim; nr. 448/2015, për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a, çështje kjo e dërguar për gjykim; si dhe janë depozituar

⁶⁴Kërkesë nr. *** prot., datë 29.4.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁶⁵Shkresat: nr. *** prot., datë 31.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 5.5.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 30.4.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁶Për shkak të përdorimit të automjetit me targa ***, nga subjekti dhe bashkëjetuesi i saj në periudha të ndryshme kohore.

⁶⁷<http://www.panorama.com.al/>***

⁶⁸Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2021, nr. *** prot., datë 24.5.2021; nr. *** prot., datë 24.5.2021; nr. *** prot., datë 24.5.2021; nr. *** prot., datë 21.5.2021, administruar në dosjen e Komisionit, si dhe shkresë “kthim përgjigje *** prot., datë 31.5.2021.

⁶⁹Përfshijtur informacioni i ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021.

⁷⁰Informuar me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 10.6.2021, të po kësaj prokurorie, administruar në dosjen e Komisionit.

kallëzimi nr. ***, për të cilin sipas akteve të administruara është vendosur mosfillimi me vendimin datë 21.9.2016; kallëzimi nr. ***, gjithashtu rezultoi i mosfilluar me vendimin datë 30.12.2015; kallëzimi nr. ***, që sipas akteve të administruara rezultoi i mosfilluar me vendimin datë 30.9.2019.

45.16 Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë nuk kanë konfirmuar kallëzime apo procedime penale të regjistruara në ngarkim të shtetasit A.V (blerësi i automjetit - kamion).

46. Komisionit i kanë rezultuar disa mospërputhje nga verifikimi i informacionit të dhënë nga DPPShtetit⁷¹ (sistemi E-Gjoha), krahasuar me deklarinimin e subjektit në pyetësin standard (nr. 1) për automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit F.P. Më konkretisht, nga sistemi rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit janë aplikuar gjoha edhe në datat 29.6.2016 dhe 26.9.2016, ndërsa subjekti ka deklaruar në pyetësor se në këtë periudhë nuk e përdorte automjetin për shkak të gjendjes së saj jo të mirë shëndetësore (duke deklaruar, ndër të tjera, edhe humbjen e shikimit).

46.1 Subjekti, pasi është pyetur në përgjigjen e dhënë në mënyrë të përmbledhur, ka qartësuar dhe saktësuar se gjoha e pasqyruar në informacionin e dhënë nga Departamenti për Sigurinë Publike në DPPShtetit, si e vendosur në datën 29.6.2016 i përket asaj të vendosur më 26.9.2016 dhe se ky duhet të jetë një gabim material i institucionit përkatës. Kjo për faktin se nga vendimi nr. ***, datë 3.10.2016, i marrë nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për gjobën e dhënë në datën 26.9.2016, numri serial i konstatimit të shkeljes korrespondon ekzaktësisht me numrin serial të shkeljes së pasqyruar në gjobën e renditur në informacionin e dhënë, se është dhënë në datën 29.6.2016. Dokumentacioni tregon se gjoha e vendosur është e datës 26.9.2016 dhe jo qershor 2016. Po ashtu, subjekti qartëson se data dhe muaji lehtësisht mund të ngatërrohen në të shkruar, pasi interferojnë apo ngatërrohen me njëra-tjetrën. Subjekti deklaroi se nuk është vendosur gjobë në qershor të vitit 2016.

46.2 Komisioni, në vlerësim të përgjigjes së dhënë por edhe të verifikimit të dokumentacionit të administruar, vëren se shpjegimet e subjektit qëndrojnë, pasi duket që ka të bëjë me një gabim në pasqyrimin e datës dhe muajit, duke i vendosur ato anasjelltas, jo më 26.9.2016, por më 29.6.2016, si dhe konstaton se kjo gjobë (e vendosur jo drejtpërdrejtë për subjektin, por ka rezultuar se qarkullohet me mjet për të cilin nuk është kryer kontrolli teknik) është paguar me vendimin nr. ***, datë 3.10.2016, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Pra, krahasimi i të dhënave nxjerr në pah lapsusin e bërë dhe të pasqyruar në datën e dhënies së gjobës.

46.3 Subjekti ka bashkëlidhur printimin e fletës së gjobës, vendimin e Komisionit, si dhe shkresën përcjellëse.

46.4 Komisioni, në analizim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, konstatoi se ka të bëjë me një gabim material në pasqyrimin e datës dhe muajit të vendosjes së gjobës, pra jo në qershor, por në shtator të vitit 2016, *indicie* kjo që provon se subjekti nuk ka qarkulluar me këtë automjet në muajin qershor apo përgjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2016 dhe, për rrjedhojë, konkludohet se nuk evidentohen problematika.

47. Në lidhje me përdorimin e këtij automjeti

47.1 Pas aksesit në AMF, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit rezultoi përdorues në policën e sigurimit (akt që siguron mjetin dhe dëmet që mund të vijnë nga aksidentet e mundshme) të këtij mjeti, për periudhat dhjetor 2015 - dhjetor 2016 dhe dhjetor 2016 - dhjetor 2017.

47.2 Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime mbi këtë konstatim, në raport me mosdeklarimin e përdorimit të mjetit në deklaratën *Vetting*.

⁷¹Sipas korrespondencës nr. *** prot., datë 20.1.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

Subjekti, në parashtrimet, ka shpjeguar ndryshimin sipas Kodit Civil të pasurisë në pronësi nga ajo në përdorim.

Subjekti ka qartësuar se e ka mbajtur automjetin në dy periudha shumë të shkurtra kohore, dhjetor 2015 - janar 2016, duke e përdorur rreth tri javë pasi ka marrë lejen e lindjes dhe dhjetor 2016 - shkurt 2017, pasi më pas ka blerë automjetin e saj tip “****”. Subjekti ka vënë theksin te fakti se në çdo rast pronar i këtij automjeti ka qenë shtetasi F.P, për të cilin gjithashtu ka konfirmuar se nuk e njihnte këtë person.

Subjekti ka qartësuar se mosdeklarimi në deklaratën *Vetting* ka ardhur si pasojë e një gabimi njerëzor, për shkak se lidhur me plotësimin e deklaratave periodike të viteve 2013 – 2016 nuk ishte kërkuar ndonjëherë deklarimi i pasurive në përdorim. Gjithashtu, subjekti është shprehur se nuk ka qenë e vëmendshme ndaj këtij detaji të shtuar në deklaratën *Vetting* dhe se nuk ka pasur si qëllim fshehjen e përdorimit të automjetit. Subjekti ka theksuar se ka dhënë sqarime rreth kësaj pasurie që në pyetësin nr. 1, kur ende nuk ishte hetuar ky fakt nga Komisioni, si dhe ka depozituar në kontekstin e provueshmërisë së burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë, kontratën e kredisë së marrë nga shtetasi F.P për blerjen e automjetit, sipas së cilës ky shtetas vazhdon ende të shlyejë kredinë.

Subjekti ka pretenduar se kjo pasaktësi nuk lidhet me deklarinin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka sqaruar se prej muajit shkurt të vitit 2017, kur ka blerë automjetin e saj, asgjë nuk e ka lidhur më tej me automjetin e shtetasit F.P.

Në funksion të shpjegimeve, subjekti ka cituar edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimet nr. ***, datë 7.6.2018 dhe nr. 24, datë 28.7.2021, për subjektin e rivlerësimit L.H.

Për gjithë sa më sipër, subjekti ka kërkuar që kjo harresë e pandërgjegjshme në deklarinin e mbajtjes së automjetit tip “****”, në deklaratën *Vetting*, të mos konsiderohet deklarim i pamjaftueshëm dhe të mos sjellë përgjegjësi disiplinore sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të konsiderohet se e ka përmbysur barrën e provës në lidhje me këtë gjetje të Komisionit.

47.3 Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se përdorimi i automjetit, si një marrëdhënie huapërdorjeje del jashtë kategorisë së marrëdhënies, të cilat do ta vendosnin shtetasin F.P në statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32 dhe, për pasojë, ky fakt nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë automjet. Por, pavarësisht kësaj, edhe në rast të dyshimit për pasuri të fshehur, u provua që shtetasi F.P kishte të ardhura të ligjshme për ta blerë automjetin dhe, më konkretisht, si burim krijimi kishte përdorur një kredi bankare të cilën vijonte ta shlyente.

Komisioni, duke iu referuar shpjegimeve të subjektit, ku ajo ka pranuar faktin që në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* këtë automjet e ka pasur në përdorim, si dhe vendimit nr. *** datë 12.5.2021, të Kolegjit, lidhur me situatën faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit të rezultuar gjatë hetimit në Komision, vlerëson se subjekti kishte detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën *Vetting*, në zbatim të përcaktimeve të pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, ku parashikohet se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*.

Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të

*krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij automjeti si një pasuri në përdorim të saj – sjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për ta deklaruar si pasuri në përdorim, përderisa nga policat e sigurimit sipas sistemit të AMF-së rezultonte se kishte të drejta përdorimi mbi këtë automjet për periudhën e sigurimit dhjetor 2015 - dhjetor 2016 dhe dhjetor 2016 - dhjetor 2017, periudhë që përfshin brenda saj kohën e depozitimit të deklaratës së pasurisë *Vetting* në datën 29.1.2017.*

Komisioni çmon se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* (29.1.2017) provohet nga aktet, por edhe nga deklaratimet e saj se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, sikundër dhe rezultoi që të ketë pasur një policë sigurimi nr. *** për periudhën 16.12.2015 deri më 15.12.2016 dhe nr. serie *** për periudhën 16.12.2016 deri më 15.12.2017, të vlefshme në këtë moment kohor, kjo situatë çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim. Nga sa u analizua më sipër, nga tërësia e rrethanave rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratimet periodike dhe në deklaraten *Vetting*.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit në fjalë, është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

48. Komisioni hetoi edhe në lidhje me pasjen e kallëzimeve apo procedimeve penale në ngarkim të shtetasit F.P, për shkak të marrëdhënies së përdorimit të automjetit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi i saj, në vitin 2015, pjesërisht në vitin 2016 dhe fillim vitin 2017, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë⁷² (me përjashtim të atyre të regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) nuk kanë konfirmuar kallëzime apo procedime penale të regjistruara në ngarkim të këtij shtetasi. Në lidhje me kallëzimet penale dhe procedimet e regjistruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷³, në ngarkim të shtetasit F.P është depozituar kallëzimi penal nr. ***, për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, i cili është mosfilluar me vendimin datë 21.9.2016.

Pasuri të tjera të krijuara pas deklaratës *Vetting*

49. Komisionit, nga verifikimi i deklaratës periodike të vitit 2017, i ka rezultuar se subjekti deklaroi blerjen e një automjeti tip “***”, vit prodhimi 2007, me burim krijimi kursimet sipas deklaratës së vitit 2016. Vlera e automjetit: 360.000 lekë. Po në këtë deklaratë subjekti deklaroi pakësimin e gjendjes *cash* me vlerë 400.000 lekë.

49.1 Nga hetimi rezultoi se DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2020, informon se subjekti i rivlerësimit Enkeleda Kapedani ka të regjistruar automjetin me targa ***. Nga aktet e depozituara nga kjo drejtori vërehet se ky automjet është blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 18.2.2017, në vlerën 360.000 lekë.

Për sa më sipër, duket se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar dhe, për pasojë, Komisioni nuk ngriti dyshime për krijimin e kësaj pasurie.

49.2 Nga hetimi rezultoi se ASHK-ja Drejtoria Vendore Tiranë Veri⁷⁴ ka informuar se në emër të shtetasit Enkeleda N Kapedani figuron e regjistruar pasuria apartament me sip. 117.2 m²,

⁷²Përjashtuar informacionin e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷³Informuar me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 10.6.2021, të po kësaj gjykate, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁴Shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2020.

vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi me shtetasin L.H.Q. Kjo drejtori ka depozituar dokumentacionin përkatës ku, ndër të tjera, është edhe kartela e pasurisë.

“Raiffesien Bank”⁷⁵ informon se shtetasja Enkeleda Kapedani ka marrë një kredi më 3.7.2019, në shumën 17.500.000 lekë. Nga dokumentacioni i depozituar⁷⁶ vihet re se kjo kredi është marrë për blerje apartamenti në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëkredimarrës shtetasi L.Q (bashkëjetuesi).

49.3 Kredia është disbursuar në datën 3.7.2019, në shumën 17.500.000 lekë, ndërsa në datën 4.7.2019 kjo shumë është kaluar në llogarinë e noteres A.H p. f. (NIPT ***) me përshkrimin “kalim për blerje pasurie sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 19.6.2019”.

49.4 Nga kartela e pasurisë së paluajtshme konstatohet se pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** ka kaluar në emër të shtetasve Enkeleda Kapedani dhe L.Q sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 19.6.2019. Kjo pasuri rezulton e bllokuar në favor të “Raiffeisen Bank” sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 26.6.2019, për shumën 17.500.000 lekë.

49.5 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar vërehet se i gjithë çmimi i blerjes së kësaj pasurie është marrë kredi dhe se veprimet financiare lidhur me pagesat e saj janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare të noterit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në të tilla kushte, Komisioni nuk ngriti dyshime mbi ekzistencën e kësaj pasurie dhe ligjshmërinë e burimit të saj.

Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

- i. subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *Vetting*, në përputhje me germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016;
- ii. subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi i saj kanë mungesë burimesh financiare të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016;
- iii. subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën *Vetting*, në kuptim të parashikimeve të germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi bashkëjetuesi i saj ka kryer veprime fiktive në lidhje me automjetin tip kamion;
- iv. subjekti ka tentuar të paraqesë në mënyrë të pasaktë marrëdhënien e bashkëjetuesit të saj me z. L.L në lidhje me huan dhe transaksionet ekonomike që lidhen me shitblerjen e automjetit tip kamion, duke deklaruar të dhëna të pasakta, si dhe duke depozituar dokumentacion fiktiv në lidhje me blerjen në vlerën 950.000 lekë të kamionit, shitjes së tij në vlerën 32.000 euro dhe dhënies së huas në vlerën 28.000 z. L. Subjekti i rivlerësimit ka cenuar, qoftë edhe vetëm me këtë mënyrë sjelljeje, besimin e publikut te një funksionar i drejtësisë, i cili duhet të karakterizohet nga sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës,

në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të rremë për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat sipas pikës 3, të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

a. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin

⁷⁵Shkresë nr. *** prot., datë 21.1.2020.

⁷⁶Kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. ***, datë 26.6.2019.

39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin mbi kontrollin e figurës nr. ***, datë 2.11.2017, të deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 30.4.2021, të KDZH-së ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar *përshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani.

b. Më tej, DSIK-ja ka përcjellë raportin⁷⁷ e përditësuar për subjektin e rivlerësimit ku, ndër të tjera, citohet: *“Për subjektin e rivlerësimit disponohet një e dhënë ... ku sinjalizojnë mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës ... në vlerësim të të dhënave që disponohen rezulton se në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Enkeleda N Kapedani, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryen ndaj subjektit të rivlerësimit”.*

Hetimi i Komisionit

b/1 Komisioni, pasi u njoh me raportin e përditësuar të DSIK-së dhe informacionet përkatëse, kërkoi dhe administroi praktikën që i përket çështjes gjyqësore civile me objekt konflikt pronësor, me palë ndërgjyqëse, paditës L.B, i paditur SH.T, si dhe dosjet penale në ngarkim të shtetasve M.B⁷⁸, L.K, A.G dhe E.S. Verifikimi dhe analizimi i këtyre çështjeve është parashtruar në këtë vendimmarrje, në kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, nën rubrikën “rivlerësimi profesional/ çështje të tjera të trajtuara”.

Megjithëkëtë, Komisioni ka vlerësuar t’i kërkojë subjektit të japë shpjegime në raport me informacionin e DSIK-së, ku citohej se: *“Për subjektin e rivlerësimit disponohet një e dhënë ... ku sinjalizojnë mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës”.*

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj, ndër të tjera, ka parashtruar:

*“Raporti nr. ***, datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës është deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 30.4.2021, të KDZH-së, ndërsa raporti i dytë është hartuar në datën 26.5.2021. Dua të sjell në vëmendjen tuaj se objekt kontrolli për pastërtinë e figurës është periudha 1.1.2012 – në datën e dorëzimit të deklaratës së figurës janar 2017, ndërsa periudha e pretenduar (maj 2021) është jashtë periudhës së rivlerësimit. Ky qëndrim është i konsoliduar në praktikën e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit siç rezulton nga vendimi nr. ***, datë 25.7.2018 ku, ndër të tjera, theksohet se: ‘Po ashtu duhet theksuar se në pikën 2, të nenit Dh, të Aneksit të Kushtetutës është sanksionuar se deklarata e detajuar (prej së cilës fillon edhe verifikimi i figurës) mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit dhe ky është kriter kushtetues. Informacioni i përdorur për arritjen në konkluzion nga Grupi i Punës nuk i përket kësaj periudhe’.*

Si rrjedhim, informacioni i ardhur nga DSIK-ja, gjatë muajit maj të vitit 2021, nuk mund të merret në konsideratë pasi kjo vjen ndesh me Kushtetutën, ligjin dhe me praktikën e konsoliduar të Komisionit.

Informacioni nuk është një e dhënë e përfutur në përputhje me ligjin, si rrjedhim është tërësisht i paligjshëm dhe i papërdorshëm në asnjë proces penal apo administrativ nëse nuk është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin tonë. Pra, për sa kohë ky informacion nuk është konkret, i saktë, i plotë, i qartë dhe as i bazuar në prova, nuk mund të shërbejë as për ngritjen e dyshimeve lidhur me pastërtinë e figurës së personit tim, duke ardhur në kundërshtim

⁷⁷Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2021.

⁷⁸Lidhur me çështjen që i përket këtij shtetasi, Komisioni ka ezauruar hetimin e plotë, parashtrimin dhe kërkimin e tij, në denoncimin nr.1, depozituar nga shtetasit B.M dhe K.B, për shkak se këta të fundit njëkohësisht ankoheshin për veprime të kundërligjshme lidhur me zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj këtij të pandehuri nga subjekti i rivlerësimit.

të hapur me nenin 38 të ligjit, i cili parashikon se kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe në informacione të tjera të disponueshme”.

Arsyetimi në raport me konstatimin e DSIK-së dhe shpjegimet e subjektit

Trupi gjykues në lidhje me pretendimin e subjektit se objekti i kontrollit për pastërtinë e figurës është jashtë periudhës së rivlerësimit dhe se informacioni i DSIK-së nuk është konkret, i saktë, i plotë, i qartë dhe as i bazuar në prova, duke ardhur në kundërshtim të hapur me nenin 38 të ligjit arsyeton:

Vlerësimi i kriterit kontrollit të figurës bazohet sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në kreun V të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në pikat 4 dhe 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, kontrolli për figurën bazohet në kryerjen e verifikimeve të nevojshme në dy drejtime: (a) në konstatimin e ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm; dhe (b) në konstatimin e plotësisë dhe besueshmërisë së deklaramentit, në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës për çdo subjekt rivlerësimi.

Trupi gjykues, referuar raportit të DSIK-së, nuk ka identifikuar në asnjë rast ndonjë të dhënë për kontakt të papërshtatshëm, me të cilin subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri për të mbështetur konstatimin përfundimtar të saj. Ky konstatim lidhet me dyshime, pasi disponohej një e dhënë, që sinjalizon mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës për një çështje të trajtuar prej saj, i cili është trajtuar në aspektin e kriterit profesional.

Trupi gjykues në ushtrim të kompetencës ligjore për të kryer hetime dhe konkluduar mbi kontrollin e këtij kriteri për subjektin e rivlerësimit dhe, gjithashtu, për sa kohë i është adresuar sipas raportit të DSIK-së, arritja në konkluzion për këtë çështje në raport me të dhëna të tjera të analizuara dhe të rezultuara përgjatë hetimit administrativ, ka analizuar të gjithë gamën e problematikës së parashtruar, duke mbajtur në vëmendje trajtimin e çdo shtate të përditësuar apo çështjeje të shfaqur në pozitën që ajo përfaqëson.

Në këtë drejtim, trupi gjykues evidenton faktin se DSIK-ja ka rolin e organit ndihmës në këtë proces dhe se procedura e punës së ndjekur prej saj për kontrollin e figurës bazohet në standarde të përcaktuara shprehimisht në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, por vlerësimi përfundimtar i takon Komisionit si organ rivlerësimi.

Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, me vëmendje faktin se kontrolli i figurës bazohet në standarde të tjera të ndryshme nga kriteri profesional, pa anashkaluar ndërthurjen e konstatimeve kur është rasti, çmtoi që dosjet e administruara si rrjedhojë e *indicieve* të mësuara pranë institucionit të DSIK-së, t'i shqyrtojë gjerësisht në kontekstin e kriterit të vlerësimit profesional, pasi e kundërta do të passillte pazgjidhshmëri të *indicieve*, hetim të paplotë dhe jo të mirargumentuar.

c. Në vijim, në hetimin dhe kontrollin e këtij kriteri u integrua gjetja nr. *** prot., datë 20.1.2022⁷⁹, e vëzhguesit ndërkombëtar, paraqitur në përputhje me parashikimet e pikave 10 dhe 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për këtë çështje

1. Gjetja e përcjellë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përgjatë hetimit administrativ e administruar nga Komisioni, ka në fokusin e saj dënimin e shtetasit L.L nga një gjykatë e huaj në Itali, i cili përgjatë hetimit administrativ rezultoi në lidhje me bashkëjetuesin e subjektit të rivlerësimit, z. L.Q, për shkak të ndërtimit të marrëdhënieve kontraktore të shitblerjes së automjetit tip kamion dhe, më tej, edhe të asaj të huadhënies ndërtuar sërish mes këtyre dy shtetasve, çështje të trajtuara gjerësisht dhe të konkluduara në këtë vendim, në kriterin e vlerësimit të pasurisë.

⁷⁹Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.1.2022.

2. Në gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar thuhet shprehimisht: “L.L, lindur më 8.3.1968, është dënuar për veprën penale ‘mbajtje, transport dhe shitje e lëndëve psikotrope (trafikimi i narkotikëve) në Itali’, të kryer në bashkëpunim dhe është dënuar përfundimisht me 7 vjet burgim dhe me gjobë prej 35.000 euro, nga Gjykata e Apelit të Napolit më 7.3.2012”.

Vëzhguesi ndërkombëtar ka dhënë mendim rreth nevojës që Komisioni të vlerësojë nëse besimi i publikut është cenuar nga subjekti i rivlerësimit me anën e sjelljes dhe kontakteve sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të etikës. Shtetasi L.L është cilësuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëjetuesin e saj.

3. Informacioni i përshkruar bazohet në: (i) certifikatën e dëshmisë së penaltetit të shtetasit L.L (përkthyer në gjuhën shqipe), përcjellë nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, me shkresën nr. ***prot., datë 25.1.2022⁸⁰; (ii) certifikatën e dëshmisë së penaltetit nr. *** për shtetasin L.L, përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2022⁸¹, adresuar për këtë ministri nga Ministria e Drejtësisë së shtetit italian⁸²; dhe (iii) certifikatën e dëshmisë së penaltetit nr. *** për shtetasin L.L, të përkthyer në formën e kërkuar nga ligji nga gjuha italiane, përcjellë nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2022⁸³.

4. Nga verifikimi i certifikatës së gjendjes gjyqësore⁸⁴, lëshuar në shtetin italian, rezulton se shtetasi L.L është dënuar me vendimin datë 7.3.2012, të Gjykatës së Apelit Napoli, marrë formë të prerë më 22.1.2013, për veprën penale “mbajtje, transport dhe shitje e lëndëve narkotike”, i vazhduar në bashkëpunim, neni 81,110 i Kodit Penal, neni 73, pika 1, ***, nr. *** [kryer më 8.5.2004, në Napoli *** (MI)], me heqje lirie 7 vjet, gjobë 35.000, 00 euro.

5. Nga të dhënat e pasqyruara rezulton se vepra penale për të cilën është akuzuar dhe dënuar ky shtetas përfshihet në parashikimet e pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në të cilin thuhet shprehimisht: “Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192⁸⁵, datë 3.12.2009, ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’, të ndryshuar. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: (a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; (b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”.

6. Për shtetasin L.L, Komisioni, përpara administrimit të gjetjes, hetoi gjerësisht në drejtim të pasjes së ndonjë konflikti të interesit me subjektin e rivlerësimit për shkak të funksionit të këtij të fundit, si edhe lidhur me pasjen e ndonjë çështjeje penale të regjistruar në ngarkim të tij, pavarësisht statusit në të cilin ajo mund të ndodhej.

7. Nga hetimi i kryer, në asnjë rast, nuk u konfirmua gjendja e konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit për shkak të funksionit dhe këtij shtetasi dhe po ashtu procedimet penale të regjistruara⁸⁶ në ngarkim të tij për vepra penale të kryera në territor vendi nuk

⁸⁰Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.1.2022.

⁸¹Protokolluar në IMO me nr. ***, datë 25.1.2022.

⁸²Siguruar nga korrespondenca në rrugë elektronike mes dy institucioneve/ministrive respektive.

⁸³Kërkuar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2022.

⁸⁴Ekstrakt nga Zyra Qendrore e Dëshmimeve të Penaltetit – Ministria e Drejtësisë Romë.

⁸⁵1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në *indicie*, për: c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal.

⁸⁶Informuar me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 10.6.2021, të po kësaj prokurorie, administruar në dosjen e Komisionit. Në lidhje me kallëzimet penale dhe procedimet e regjistruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi se në ngarkim të këtij shtetasi (L.L) ishin regjistruar procedimet penale: nr. ***, për veprën penale “mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, çështje kjo e pushuar me vendimin datë 14.4.2014; nr. ***, për veprën penale

identifikuan vepra⁸⁷, të cilat ligji nr. 84/2016 i parashikon në kategorinë e atyre veprave, që e bëjnë personin të përfshirë në krimin e organizuar dhe që, për pasojë, rezultoi se të dhënat e mësuar nuk cenonin kriterin e figurës së subjektit të rivlerësimit.

8. Përtej kësaj faze të hetimit, gjetja e administruar diktoi shtrirjen e hetimit për këtë shtetas me qëllim konkludimin e Komisionit mbi vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën për kontrollin e figurës lidhur me pasqyrimin e dënimit të shtetasit L.L, si dhe mbi provueshmërinë e kontaktit të bashkëjetuesit të subjektit me këtë shtetas, në kushtet e dijenisë për dënimin e dhënë ndaj tij, në raport me legjislacionin ku gjen zbatim verifikimi dhe kontrolli i figurës, i pasqyruar në kreun V të ligjit nr. 84/2016.

9. Hetimi i kryer lidhur me këtë situatë u shtri në provueshmërinë e pasjes dijeni të këtij fakti, pra të ekzistencës së dënimit të shtetasit L.L, duke verifikuar çdo rrethanë, përfshirë këtu çdo të dhënë të grumbulluar edhe përgjatë hetimit të pasurisë/automjetit i tipit kamion dhe në vijim.

10. Në këtë kontekst, fillimisht, Komisioni konkludoi se shtetasi L.L ishte person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 3/14 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se: (i) kishte hyrë në marrëdhënie shitblerjeje me shtetasin L.L për një automjet tip kamion; (ii) ky mjet fillimisht ishte blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 29.4.2016, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT: ***, me administrator shtetasin L.L dhe palë blerëse bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, shtetasi L.Q, në çmimin e shitjes 950.000 lekë; (iii) në datën 13.10.2016, me kontratën nr. ***, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, shtetasi L.Q ia kishte shitur këtë mjet shtetasit A.V në çmimin 32.000 euro; (iv) me kontratën e huas⁸⁸ nr. ***, datë 17.1.2017, shtetasi L.Q, në cilësinë e huadhënësit, i kishte dhënë hua shtetasit L.L shumën 28.000 euro për një afat njëvjeçar, duke filluar nga data 17.1.2017 deri në datën 17.1.2018; (v) në deklaratën periodike të vitit 2016 bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit e deklaroi huadhënien në vlerën 28.000 euro ndaj këtij shtetasi, me burim krijimi të ardhurat nga shitja e kamionit.

11. Në funksion të provueshmërisë së njohjes/afërsisë së bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas, përtej marrëdhënies së shitblerjes së automjetit dhe huamarrjes, hodhi dritë komunikimi i mbajtur në seancë dëgjimore⁸⁹ midis subjektit të rivlerësimit, trupit gjykues, si dhe vëzhguesit ndërkombëtar. Në komunikimin pyetje - përgjigje me subjektin, pyetjes së drejtuar nga trupi gjykues *nëqoftëse mjeti kishte këtë vlerë dhe shtetasi L. L. kishte nevojë për mjete monetare për atë kohë sa ju i dhatë hua, pse nuk ua shiti këtë mjet në vlerën 32.000 euro, sa ishte vlera reale e mjetit, të cilin ju e shitët atë pas tre muajsh, që ia blëtë në vlerën 9.500.000 lekë? Cila është arsyeja? Subjekti i është përgjigjur: arsyeja është, e para, njohje shoqërore midis shitësit dhe bashkëjetuesit dhe arsyeja e dytë është mundësia ekonomike. Vëzhguesi ndërkombëtar drejton pyetjen: Një tjetër çështje është të flasim rreth z. L. L. Mund të na jepni një ide se si e keni njohur zotin L. L? Subjekti i është përgjigjur shprehimisht: “Është lindur në të njëjtën zonë me bashkëjetuesin tim. Pra, kanë njohje që në fëmijëri. Duke vijuar në linjën e pyetjeve – “Do thonit se janë shokë të ngushtë?”, subjekti i është përgjigjur – “Njihen, kanë shoqëri, se sa e afërt apo e largët, nuk jam në gjendje ta vlerësoj sepse mund të përgjigjem 100% për veten time, kush janë miqtë e mi dhe armiqtë e mi, këto di”.*

“fshehje e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/2, çështje kjo e cila sipas informacionit të ardhur rezultoi të jetë dërguar për gjykim; nr. ***, për veprën penale “fshehje e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/2, çështje kjo e cila sipas informacionit rezultoi të jetë nën hetim; nr. ***, për veprën penale “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a, çështje kjo e dërguar për gjykim; si dhe janë depozituar kallëzimi nr. ***, për të cilin sipas akteve të administruara është vendosur mosfillimi me vendimin datë 21.9.2016; kallëzimi nr. ***, i cili gjithashtu rezultoi i mosfilluar me vendimin datë 30.12.2015; kallëzimi nr. ***, që sipas akteve të administruara rezultoi i mosfilluar me vendimin datë 30.9.2019.

⁸⁷Sipas nenit 3/15 të ligjit nr. 84/2016.

⁸⁸Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁹Datë 19.1.2022.

12. Në këto kushte, Komisioni ngriti dyshimin e arsyeshëm se bashkëjetuesi i subjektit kishte pasur dijeni mbi dënimin e shtetasit L.L, duke nënkuptuar deri në këtë fazë të hetimit kontaktin e tij me një person të përfshirë në krimin e organizuar për shkak të veprës penale për të cilën ishte dënuar dhe, për pasojë, verifikoi vërtetësinë dhe saktësinë e plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës nga subjekti i rivlerësimit.

13. Nga verifikimi i kryer u vërejt se subjekti i rivlerësimit:

- në germën “d” ku citohet *“A jeni në dijeni që një nga anëtarët e familjes suaj ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar?”*, është përgjigjur me *“Jo”*;

- në germën “f” ku citohet *“A keni dijeni se një person i lidhur sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një persona të përfshirë në krimin e organizuar?”*, është përgjigjur me *“Jo”*.

14. Për sa më sipër, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar kontaktin e konstatuar të personit të lidhur/bashkëjetuesit të saj me shtetasin L.L (si rezultat i dënimit të këtij të fundit), për të cilin ligji kërkon përmbushjen e këtij detyrimi/plotësimin e saktë dhe me vërtetësi të deklaratës së kontrollit të figurës.

15. Në të tilla kushte, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës⁹⁰ për të provuar të kundërtën e rezultatit, pasi dukej se: (i) personi i lidhur/bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka pasur kontakt të papërshtatshëm me shtetasin L.L, në shkelje të nenit 38 ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk kishte përmbushur detyrimin ligjor për të deklaruar kontaktin e papërshtatshëm të personit të lidhur/bashkëjetuesit të saj me shtetasin L.L, përcaktuar në deklaratën për kontrollin e figurës në germa “d” dhe “f”, në pjesën 5 titulluar *“Të dhëna për sigurinë”*, për shkak të hyrjes në marrëdhënie kontraktore shitblerjeje dhe huadhënie/interesa pasurore të bashkëjetuesit me këtë shtetas⁹¹.

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka parashtruar:

Fillimisht ka ngritur pretendime mbi procedurën e ndjekur lidhur me bërjen prezent të gjetjes, duke cituar shprehimisht: *“Seanca dëgjimore ndaj meje është zhvilluar në datën 19.1.2022, ndërkohë që gjetja e përfaqësuesit të ONM-së mban datën 20.1.2022, pra vetëm 1 ditë pas seancës dëgjimore. Në këto kushte, ajo/gjetja duhej të ishte vënë në dijeni të trupit gjykues, i cili të njoftonte gjetjen, duke më ngarkuar barrën e provës, duke më kërkuar sqarimet përkatëse, si dhe të më jepte të drejtën për t’u mbrojtur për këtë gjetje në seancë publike. Me njohjen e rezultateve, si dhe nisur nga natyra e pyetjeve që përfaqësuesi i ONM-së më ka drejtuar në seancën e datës 19.1.2022, subjekti ka ngritur dyshime se përfaqësuesi i ONM-së ka qenë në dijeni të kësaj gjetjeje ditën e seancës. Në këto kushte, proceduralisht, përfaqësuesi i ONM-së duhet të kishte vënë në dijeni të trupës sime ‘gjetjen’ e tij me qëllim që trupa të ndërmernte veprimet e duhura ligjore dhe të nevojshme procedurale, duke më njoftuar gjetjen, duke më ngarkuar barrën e provës, duke më kërkuar sqarimet përkatëse, si dhe të më jepte të drejtën për t’u mbrojtur për këtë gjetje në seancë publike. Por, përkundër kësaj, Komisioni, në datën 17.1.2022, ora 17:34, nëpërmjet e-mail-it më ka ftuar në seancë dëgjimore për në datën 19.1.2022, ora 10:00, pa më bërë me dije gjetjen në fjalë edhe pse duket se përfaqësuesi i ONM-së ishte vënë në dijeni të saj”*.

⁹⁰Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

⁹¹Referuar nenit 38/4/c të ligjit nr. 84/2016.

Në vijim me thelbin e çështjes subjekti është shprehur se në mënyrë kategorike jeta apo dënimi i këtij shtetasi nuk mund të ndikojnë në jetën e saj, duke pretenduar se nuk ka asnjë lidhje me të.

Subjekti ka sqaruar se shtetasi L.L dhe bashkëjetuesi i saj kanë lindur në fshatin ***, Tiranë, duke qenë kështu nga i njëjti fshat.

Subjekti ka deklaruar se ata nuk kanë pasur ndonjëherë lidhje shoqërore me njëri-tjetrin, të paktën deri në vitin 2016, por thjesht kanë pasur njohje normale si dy djem nga e njëjta zonë.

Subjekti ka sqaruar se shtetasi L.L ka shkuar të jetojë në qytetin e Tiranës që në vitin 2000, ndërsa shpërnguljen zyrtare të vendbanimit e ka marrë në vitin 2003 dhe se nga koha e largimit informacionet rreth tij kanë qenë të pakta, dijenia rreth përditshmërisë së tij dhe mundësia për ta takuar po ashtu, për sa kohë nuk i lidhte asgjë me njëri-tjetrin.

Subjekti ka pretenduar se bashkëjetuesi i saj nuk ka pasur kurrë dijeni rreth problemeve ligjore që ky shtetas mund të ketë pasur në Itali apo në ndonjë shtet tjetër për shkak se nuk ka pasur asnjë lloj shoqërie me të në kohën e procedimit dhe as në kohën e dënimit. Gjithashtu, ka shpjeguar se shtetasi L.L nuk e ka treguar asnjëherë hapur në rrethin e personave të njohur problemet ligjore me atë shtet, si një zgjedhje personale e tij.

Subjekti ka sqaruar se mjetet e informimit masiv nuk e kanë pasqyruar këtë ngjarje të ndodhur jashtë vendit në internet, nuk ka pasur indikacione që ky shtetas ishte dënuar për veprimtari kriminale dhe, për pasojë, ka pasur pamundësi për t'u njohur me informacionin.

Subjekti ka cituar ekzaktësisht: *“Siç rezulton edhe nga dokumentet që ju më keni vënë në dispozicion rezulton se ai ka qenë me masë sigurimi ‘Periudhë prove për 3 vjet’, pra nuk ka qenë i arrestuar, dhe kjo do të thotë që ai nuk ka munguar fizikisht në Shqipëri në mënyrë që dikujt t’i bënte përshtypje mungesa e tij fizike e të prezumonte se mund t’i kishte ndodhur diçka jashtë shtetit. Nuk di të them nëse shtetasi L. L ka pasur dijeni në lidhje me ecurinë e procesit në ngarkim të tij në shtetin italian, pasi sipas sistemit TIMS rezulton se ai ka hyrë e ka dalë nga Republika e Shqipërisë disa herë në vitin 2004, disa hyrje-dalje në vitin 2005, 2006 dhe 2007, si dhe nuk rezulton të ketë datë dalje nga Republika e Shqipërisë në vitin 2012 kur është dënuar me vendim të formës së prerë, e cila tregon se ai nuk e ka vuajtur asnjëherë këtë dënim. Nga dëshmia e penalitetit që ju më keni vënë në dispozicion rezulton se ky dënim i është falur si rrjedhin shteti italian nuk ka pasur asnjë interes për të sjellë vendimin në Shqipëri, pasi nuk mund të kërkonte as ekstradimin e tij dhe as njohjen e vendimit penal të huaj. Fakti që nuk ka asnjë vendim të gjykatave shqiptare lidhur me një nga këto dy objekte (ekstradim ose njohje vendimi penal) tregon se ai nuk e ka vuajtur këtë dënim dhe se shteti italian nuk ka dërguar asnjë kërkesë autoriteteve shqiptare për ekstradim apo njohje vendimi penal të gjykatave të huaja si dy nga format e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”.*

Subjekti ka shpjeguar se nuk mund të aksesonte apo kryente veprime në nivel ndërkombëtar, jo vetëm për faktin se nuk e kishte këtë të drejtë, por edhe se bashkëjetuesi i saj nuk kishte pasur asnjë dyshim e aq më pak ndonjë *indicie* që ky shtetas mund të ishte i dënuar në një shtet të huaj. Subjekti është shprehur se *nëse do të kishin qoftë edhe dyshime të tilla as nuk do i kishte lidhur kontratat me të*. Subjekti ka deklaruar se: (i) nuk e ka njohur nga afër dhe nuk e ka takuar kurrë këtë shtetas në jetën e saj, as ndonjë familjar të tij; (ii) mundësia që ai të ndikonte në punën e saj e aq më pak ta vendoste atë nën presion ka qenë jo vetëm e pamundur, por zero; (iii) nuk ka kryer ndonjë udhëtim me ndonjë automjet apo në shoqërinë e shtetasit L. L. apo të ndonjë prej familjarëve të tij; (iv) dëshmia e penalitetit të këtij shtetasi nuk pasqyron dënimin e marrë në Itali; (v) asnjë institucion shtetëror nuk është në dijeni të këtij dënimi; (vi) arrestimi i tij nuk është pasqyruar në median e shkruar apo vizive të vendit tonë; (vii) marrëdhënia e tyre është tërësisht e largët, si dy djem të lindur nga e njëjta zonë deri në vitin 2016, dhe në vitet 2016 – 2018 marrëdhënie shoqërore për shkak të kontratës së huas në fuqi midis tyre, me

përfundimin e së cilës mbaroi edhe raporti i tyre; dhe se (viii) nuk ka shqyrtuar asnjëherë asnjë çështje gjyqësore në ngarkim të shtetasit L.L duke mos qenë kështu në kushtet e konfliktit të interesit, fakt ky i hetuar nga Komisioni.

Gjithashtu, subjekti ka qartësuar edhe faktin që raporti i DSIK-së, pas kryqëzimit të informacionit të disponuar nga institucionet ligjzbatuese, e ka konsideruar të përshtatshme në raportin e parë dhe atë të përditësuar dhe nuk ka konstatuar asnjë kontakt të papërshtatshëm midis saj dhe personave të përfshirë në krimin e organizuar apo personave të lidhur.

Subjekti ka pretenduar se në rastin konkret rezultoi e provuar ekzistenca e njohjes, por jo e miqësisë midis bashkëjetuesit të saj dhe shtetasit L.L deri në kohën e kryerjes së veprimeve juridike midis tyre dhe, për këtë shkak, ka pretenduar se nuk mund të ngrihen dyshime mbi një përfshirje të personit të saj, në kontekstin e një marrëdhënieje familjare të gjerë midis familjarëve të saj dhe të familjes së shtetasit L.L.

Subjekti, për të përforcuar faktin e mosdijenisë së këtij dënimi, ka deklaruar se nëse do ta kishte ditur dënimin e këtij shtetasi, pyetjeve që i ishin drejtuar gjatë seancës dëgjimore të datës 19.1.2022 do i ishte përgjigjur me bindje dhe vendosmëri duke thënë se ata nuk kanë qenë dhe nuk janë shokë dhe se nuk kanë asnjë lloj raporti me njëri-tjetrin, etj.

Subjekti ka pretenduar se në lidhjen verbale të kontratës së huas, bashkëjetuesi i saj e ka pyetur shtetasin L.L nëse kishte ndonjë problem lidhur me këtë kategori veprash para dhënies së huas në nëntor të vitit 2016 (1 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016) dhe se ai i ka mohuar të kishte ndonjë problem të tillë. Subjekti pretendon se shtetasi L.L ka hezitur të tregojë, pasi ka menduar që nëse tregonte bashkëjetuesi nuk do ia jepte hua paratë për të cilat ai kishte shumë nevojë.

Subjekti ka saktësuar se fakti që ky shtetas është proceduar në Itali në vitin 2004, sipas citimit në dëshminë e tij të penalitetit, në çdo rast e përjashton mundësinë e njohjes së kësaj rrethane prej saj në vitin 2016, pasi në atë periudhë *sqaron subjekti* as nuk njihesh me bashkëjetuesin e saj. Ajo mohon ekzistencën e ndonjë marrëdhënieje shoqërore midis tyre deri në vitin 2016 – 2018 dhe, po ashtu, edhe ekzistencën e marrëdhënieve familjare midis tyre.

Subjekti ka pretenduar për mungesë totale të kontakteve me këtë shtetas, si dhe ka sqaruar se shpjegimet e saj janë bindëse, se është e besueshme, e hapur dhe e plotë në deklaratimet e saj lidhur me padijeninë e arrestimit të këtij shtetasi në Itali si prej saj ashtu edhe nga bashkëjetuesi. Nën këtë qëndrim subjekti ka pretenduar se nuk është në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm sipas ligjit nr. 84/2016.

Ndërsa lidhur me procedurën e ndjekur me Ministrinë e Drejtësisë, subjekti ka pasqyruar veprimet e kryera prej saj (kërkesë të cilën ia parashtroi edhe Komisionit për të mbajtur korrespondencë me këtë ministri) për të marrë informacion lidhur me gjendjen gjyqësore të shtetasit L.L, si dhe për faktin e njohjes së dënimit penal të këtij shtetasi nga shteti shqiptar. Gjithashtu, ka pasqyruar arsyet e kërimit të saj në këtë rast, duke parashtruar se i shërbenin për të provuar se në kushtet kur ky vendim nuk i është komunikuar asnjëherë shtetit shqiptar, si mund të pretendohet që ajo të kishte informacion lidhur me të kur as nuk ishte e detyruar që të dinte dhe as nuk mund të prezumonte dijeninë e saj dhe bashkëjetuesit për të gjitha rrethanat e cituara më sipër në qëndrimin e saj.

Subjekti, për këtë çështje, ka kërkuar kryerjen e një hetimi të plotë, të drejtë, të paanshëm, pa paragjykime subjektive, si dhe pa i dhënë vlerë të paracaktuar provave të mbledhura nga ONM-ja.

Subjekti ka depozituar:

- a) vërtetimin nr. *** prot., datë 11.3.2022, lëshuar nga Njësia Administrative ***, Tiranë;
- b) deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 dhe deklaratën *Vetting*;

- c) deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.3.2022, të shtetasit L.Q;
- d) dëshminë e penalitetit të shtetasit L.L;
- e) kërkesën drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Komisioni pas vlerësimit të kërkesës së subjektit dhe mbajtjes së korrespondencës institucionale me Ministrinë e Drejtësisë administroi⁹² gjendjen gjyqësore të shtetasit L si dhe konfirmimin lidhur me njohjen e vendimit penal të huaj nga autoritetet shqiptare.

Mbi këtë informacion subjekti i rivlerësimit ka vijuar të japë shpjegime të cilat konsistojnë kryesisht në të njëjtët argumente si më sipër, por duke shtuar ndër të tjera se me anë të kësaj shkrese kjo Ministri ka cituar se është ende në pritje të përgjigjes nga autoritet italiane të drejtësisë dhe se ndaj tij nuk është njohur asnjë vendim penal i huaj. Kjo nënkupton se kjo Ministri ende nuk e ka administruar vendimin e dënimit të këtij shtetasi dhe as ndonjë provë tjetër kundër tij nga MD së Italisë, si dhe faktin se ky vendim nuk ka ardhur asnjëherë në Republikën e Shqipërisë dhe, si rrjedhim, nuk është njohur nga ndonjë autoritet shqiptar. Nga kjo provohet se shteti ynë e më konkretisht Ministria e Drejtësisë nuk ka asnjë informacion zyrtar nga autoritetet italiane të drejtësisë për këtë shtetas, në këto kushte do ishte iluzion të kërkohej që unë ta dija atë. Në kushtet kur organet shtetërore (ligjzbatuese) nuk kanë pasur dijeni për këtë fakt si mund të jem unë apo bashkëjetuesi im në dijeni të një fakti të tillë, kur është një ngjarje që ka ndodhur 12 vjet para kryerjes së veprimeve juridike, ngjarje e cila i përket një kohe që bashkëjetuesi nuk kishte asnjë raport shoqëror me të.

Arsyetimi ligjor në raport me ligjin e zbatueshëm për kriterin e kontrollit të figurës

Komisioni konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në fakte dhe në ligj. Pretendimet dhe shpjegimet e parashtruara nga subjekti për të vënë në dyshim marrëdhënien shoqërore midis bashkëjetuesit të saj dhe z. L.L, të cilat më pas evoluan në mungesë përgjegjësie për deklaram apo mungesë dijenie prej saj, nuk arritën të zhbëjnë sa parashtron vëzhguesi gjatë procesit të rivlerësimit. Komisioni çmon të sjellë në vëmendje që një prej kompetencave të njohura të ONM-së, nga Aneksi i Kushtetutës, është edhe paraqitja e gjetjeve mbi çështjet që shqyrtohen nga Komisioni dhe Kolegji. Kjo kompetencë është parashikuar në germën “b”, të pikës 3, të nenit B, të Aneksit të Kushtetutës dhe zbërthyer në terma praktikë në dispozitat e pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon që: “[...] Gjetja, e paraqitur në formën e një deklarate ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji e çmon gjetjen si të barsvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelit [..]. Në lexim të sa më sipër, gjetjet e vëzhguesve ndërkombëtarë, të depozituara në formën dhe në institucionin e rivlerësimit përkatës, sipas fazës procedurale, janë pjesë integrale e procesit të rivlerësimit.

Nga dokumentet rezulton që z. L.L është dënuar me vendimin datë 7.3.2012 të Gjykatës së Apelit Napoli, marrë formë të prerë më 22.1.2013, për veprën penale “mbajtje, transport dhe shitje e lëndëve narkotike”, i vazhduar në bashkëpunim, vepër penale e cila përfshihet në rrethin e veprave të krimit të organizuar, sipas përcaktimeve të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Në nenin 38/4 të ligjit nr. 84/2016, në germën “b” të tij përcaktohet si rrethana rënduese që personi i lidhur me subjektin ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar, ndërkohë në germën “c” të po këtij neni parashikon si rrethana rënduese kur personi i lidhur ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Në nenin 38/5, germa “a” përcakton si rrethanë lehtësuese kur subjekti i rivlerësimit në mënyre të besueshme parashtron se nuk është në dijeni të faktit se

⁹²Shkresë nr. *** prot., datë 29.4.2022.

personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Kjo rrethana mund të vlerësohet në raport me parashikimet e nenit 38/4.

Referuar bazës ligjore të mësipërme, për sa i përket saktësisë së deklaramit nga subjekti, Komisioni vëren se në mënyrën se si e ka trajtuar këtë aspekt të hetimit dhe procesit të rivlerësimit, subjekti, në tërësi nuk është bindëse për mungesën e dijenisë. Ky qëndrim i Komisioni bazohet duke marrë në konsideratë qëndrimin e subjektit në lidhje me marrëdhënien e bashkëjetuesit të saj me z. L.L, ku fillimisht në seancë gjyqësore ka deklaruar se kishin marrëdhënie shoqërore dhe më pas pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar nëse ishin shokë të ngushtë ka hezitur t'i përgjigjet duke deklaruar se nuk ka dijeni se si e kanë pasur këtë marrëdhënie. Më tej, subjekti, pas kalimit të barrës së provës, është përpjekur të përjashtojë një marrëdhënie shoqërore midis bashkëjetuesit të saj dhe shtetasit L.L ku, ndërkohë, në lidhje me huan ka deklaruar se bazuar në marrëdhënien e mirëbesimit që ekzistonte midis bashkëjetuesit dhe këtij shtetasi nuk u pa e nevojshme formalizimi i saj me shkrim në kohën e dhënies së huas. Këto deklarime kontradiktore të subjektit, si dhe marrëdhëniet e krijuar midis z. L.L dhe bashkëjetuesit të saj, për sa i përket veprimeve ekonomike me automjetin tip kamion dhe dhënies së huas, për të cilat Komisioni në vlerësimin e pasurisë ka krijuar bindjen se janë veprime fiktive që kanë pasur për qëllim për të justifikuar me të ardhura të ligjshme dhënien e huas në shumën 28.000 euro z. L.L tregojnë që marrëdhëniet midis bashkëjetuesit të subjektit dhe z. L.L ka qenë një marrëdhënie shoqërore dhe nuk mund të klasifikohet si kontakt i rastësishëm. Ky rezultat përforcohet edhe me faktin se bashkëjetuesi i subjektit është përmendur në një procedim penal ku palë në konflikt ka qenë z. L.L dhe një shtetas tjetër. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për padijeni, bazuar në aktet zyrtare nga institucione të ndryshme në Republikën e Shqipërisë, nuk vërtetojnë asgjë të re pasi provojnë fakte të rezultuara gjatë gjykimit. Konkretisht, një analizë e tyre tregon që autoritetet shqiptare nuk kanë asnjë të dhënë për procedim penal apo vendime penale për z. L.L. Për gjithë sa më sipër, Komisionit, pasi dëgjoi parashtrimet e subjektit, analizoi provat e administruara dhe shqyrtoi në tërësi aktet, i rezultoi se:

- i. Z. L.L (huamarrës dhe shok i bashkëjetuesit të subjektit) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale, të cilat përmbushin testin e përcaktuar në nenin 3, paragrafi 15, i ligjit nr. 84/2016, për t'u konsideruar person i përfshirë në krimin e organizuar.
- ii. Bashkëjetuesi i subjektit me z. L.L ka kryer veprime ekonomike në lidhje me automjetin tip kamion, si dhe paraqiten në cilësinë e huamarrësit dhe huadhënësit të një shume të konsiderueshme në vlerën 28.000 euro.
- iii. Z. L.L është deklaruar në deklaratën *Vetting* në cilësinë e huamarrësit të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit.

Duke marrë në konsideratë rezultatet e mësipërme, si dhe gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar, rezulton se bashkëjetuesi i subjektit ka pasur kontakt me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parashikimeve të germave “b” dhe “c”, të nenit 38/4, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, Komisioni konstaton gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, duke marrë në konsideratë faktin e ndërthurjes së interesave personale të saj dhe bashkëjetuesit të saj (shitblerja e kamionit dhe huaja) me një person të dënuar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin kontrollit të figurës sipas pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 dhe se do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj saj.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti është përgatitur nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (a) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (b) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (c) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me saktësinë e formularit, konstatohet se ai paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Të gjitha rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm. Formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit Enkeleda Kapedani ka depozituar tri dokumente ligjore të llojit “vendim⁹³ gjyqësor”. Të tria vendimet e prezantuara prej saj janë dhënë në vitin 2014, vit në të cilin subjekti ka kryer stazhin profesional si magjistrate.

Të tria vendimet paraqiten të standardizuara në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës.

Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

⁹³Dokumenti 1 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 17.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi çështjen gjyqësore që i përket paditësit S.N (përfaqësuar nga av. G.M), kundër të paditurit shoqëria “****”, me objekt “shpërblim dëmi me pagën e 1 viti për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme të pajustificuar”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në seancë gjyqësore publike, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Kundër vendimit të mësipërm është bërë ankim. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 4.2.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 17.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dokumenti 2 – vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 28.3.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështjen gjyqësore që i përket paditësit shoqëria “****” kundër të paditurit shoqëria “****” sh.p.k. (përfaqësuar nga av. E.M), me objekt “përmbushje e detyrimeve kontraktuale, që rrjedhin nga marrëveshja nr. ***, datë 9.7.2011, lidhur midis palëve për përfitimin e paketës së ofruar nga **** të shërbimeve të telefonisë mobile”. Me anë të këtij vendimi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, por nuk ka të dhëna se si ka disponuar Gjykata e Apelit. Në pjesën hyrëse të vendimit nuk është shënuar data e regjistrimit të çështjes. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e këtij gjykimi nuk mund të përcaktohet. Dokumenti 3 – vendimi gjyqësor penal nr. ***, datë 29.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi çështjen penale, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër të pandehurve E.M, L.H, A.RR, R.L dhe G.D (përfaqësuar nga av. N.V, D.Ç, E.GJ dhe L.M), të akuzuar për veprat penale “kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik”, në bashkëpunim dhe “prishje e qetësisë publike”, në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 236/2, 274 dhe 25 të Kodit Penal, për të cilat gjykata ka vendosur: (1) deklarimin fajtor të të pandehurit E. M për veprën penale “kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik”, të kryer me dhunë në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit e 3 muaj burgim; (2) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin përfundimisht të tij me 10 muaj burgim; (3) pushimin e çështjes penale për akuzën “prishje e qetësisë publike”, në bashkëpunim për shkak të dhënies së amnistisë me ligjin nr. 22/2014, datë 10.3.2014. Ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 3.6.2015, ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit penal nr. ***, datë 29.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të pandehurit, si dhe lënien në fuqi të vendimit për të pandehurin A.RR.

Dosja 1 – çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 31.1.2014 regjistrimi, në ngarkim të të pandehurit SH.K (nuk pasqyrohet përfaqësuesi ligjor), i akuzuar për veprën penale “drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt”, e parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 14.4.2014.

Çështja është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 31.1.2014 dhe me shortin e datës 3.2.2014 i është caktuar gjyqtarës Enkeleda Kapedani. Me vendimin e datës 6.2.2014 (brenda afatit 10-ditor të nenit 333/1 të Kodit të Procedurës Penale) gjyqtarja ka caktuar seancën gjyqësore më 19.2.2014, ora 13:30 (brenda afatit të nenit 333/2 të Kodit të Procedurës Penale). Njoftimi për të pandehurin është bërë me shkresë datë 6.2.2014, dërguar Drejtorisë së Policisë Qarku Tiranë, ndërsa organi i prokurorisë është njoftuar po me shkresën datë 6.2.2014. Pas shtatë seancave gjyqësore, gjyqtarja, me vendim të bazuar në nenin 378/6 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur deklarinimin fajtor të pandehurit SH.K sipas akuzës dhe dënimit të tij me 6 muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe përfundimisht dënimit të pandehurit me 4 muaj burgim; në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim për të pandehurin dhe vënien e tij në provë për një periudhë 18-mujore. Seanca është mbyllur në orën 9:00.

Vendimi gjyqësor nuk është ankimuar nga asnjë prej palëve.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 21.4.2014 – pas 7 ditëve nga shpallja e vendimit, duke tejkaluar me dy ditë afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 2 muaj e 14 ditë në intervalin kohor 31.1.2014 - 14.4.2014, duke respektuar afatin 9-mujor, pika 5, germa “a”, e Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, në aspektin e kohëzgjatjes së gjykimit.

Dosja 2 – çështja civile nr. *** regjistri, datë 26.3.2014 regjistrimi, që i përket kërkueses SH.V (B) (nuk pasqyrohet përfaqësuesi ligjor) dhe personave të tretë DRSSH Korçë dhe Komuna ***, me objekt “njohje e viteve të punës në ish-kooperativën bujqësore ***, sektori ***”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.6.2014.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 26.3.2014 dhe me shortin elektronik të datës 28.3.2014 i është caktuar gjyqtarës Enkeleda Kapedani. Me vendimin e datës 31.3.2014, gjyqtarja Enkeleda Kapedani ka caktuar seancën përgatitore në datën 14.4.2014, ora 11:00. Njoftimi i palëve është bërë me fletëthirrje në datën 31.3.2014 dhe caktimi i seancës respektuar afatin 10-ditor të përcaktuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile.

Pas gjashtë seancave gjyqësore, gjykata, bazuar në nenin 305 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke vërtetuar faktin juridik se kërkuësja ka punuar në Kooperativën Bujqësore ***, sektori *** në periudhën 1.7.1969 – 31.12.1976. Seanca është mbyllur në orën 11:25.

Ky vendim është kundërshtuar nga personi i tretë DRSSH Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.6.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 30.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtarja Enkeleda Kapedani janë dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 8.7.2014 - 8 ditë pas shpalljes, pra në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 3 muaj e 2 ditë, në intervalin kohor 28.3.2014 - 30.6.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është në tejkallim të afatit standard 2-mujor të përcaktuar nga germa “j”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Nga analiza e vendimit konstatohet se është i arsyetuar mjaftueshëm dhe i ka dhënë përgjigje pretendimeve të palëve.

Dosja 3 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 10.1.2014 regjistrimi, që i përket paditësit shoqëria “****” sh.a., kundër të paditurve A.R, A.K, R.Q, Y.C dhe L.L (nuk pasqyrohet përfaqësues ligjor), me objekt “detyrimin e të paditurve të paguajnë respektivisht A.R shumën 44.182.00 lekë, A.K shumën 12.842.00 lekë, R.Q shumën 13.000.00 lekë, Y.C shumën 27.323 lekë dhe L.L shumën 24.435.00 lekë nga shërbimi telefonik celular”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 1.4.2014.

Çështja u regjistrua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 10.1.2014 dhe me shortin elektronik të datës 14.1.2014 iu caktua gjyqtarës Enkeleda Kapedani. Me vendimin e datës 16.1.2014, gjyqtarja Enkeleda Kapedani caktoi seancën përgatitore në datën 28.1.2014, ora 10:00. Njoftimi i palëve është bërë në datën 16.1.2014 me fletëthirrje dhe caktimi i seancës respektuar afatin 10-ditor të përcaktuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile.

Pas katër seancave gjyqësore është vendosur pranimi i padisë, duke detyruar të paditurin A.R t’i paguajë palës paditëse shumën 44.182.00 lekë nga kontrata e abonimit datë 5.9.2008, detyrimin e të paditurit A.K t’i paguajë palës paditëse shumën 12.842.00 lekë nga kontrata e abonimit datë 28.1.2008, etj.

Sipas akteve në dosjen gjyqësore, në të njëjtën datë, gjyqtarja ka dhënë edhe vendimin për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

Nuk ka të dhëna nga dosja nëse ndaj vendimit gjyqësor nr. ***, datë 1.4.2014, është ushtruar ankim nga palët në gjykatat më të larta.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Tiranë në datën 8.4.2014, brenda 7 ditëve nga shpallja, pra në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 21 ditë, në intervalin kohor 10.1.2014 - 1.4.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Dosja 4 – çështja penale nr. *** regjistrimi, datë 3.12.2015 regjistrimi, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt “vlefësim i arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, ndaj të pandehurit S.D (përfaqësuar nga av. A.A), i akuzuar për veprën penale ‘prodhim, mbajtje, blerje apo shitje e armëve të ftohta’ të parashikuar nga neni 279/1 i Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.12.2015”.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 3.12.2015 dhe i është caktuar gjyqtarës Enkeleda Kapedani për shqyrtim, në cilësinë e gjyqtarës së hetimit paraprak (kjo gjyqtare, me vendimin nr. ***, datë 24.11.2015, kishte vendosur lejimin e kontrollit të banesës së shtetasit S.DH.D). Me vendimin e datës 3.12.2015, gjyqtarja Enkeleda Kapedani ka caktuar seancën gjyqësore më 4.12.2015, ora 13:00.

Pas tri seancave gjyqësore është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit S.D sipas akuzës dhe dënimi i tij me 4 muaj e 15 ditë burgim, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimi përfundimisht i të pandehurit me 3 muaj burgim, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vënia e të pandehurit në provë për 18 muaj.

Sipas akteve në dosje nuk rezulton të jetë ushtruar ankim nga aktet e dosjes.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 21.12.2015 – pas 5 ditëve nga shpallja, pra brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Dosja 5 – çështja civile familjare nr. *** regjistri themeltar, datë 9.9.2016 regjistrimi, që i përket kërkesve W. T. H dhe D. L. H (nuk pasqyrohet përfaqësues ligjor), si dhe personave të tretë shtëpia e fëmijës “****” Elbasan dhe Komiteti Shqiptar i Birësimit, me objekt “Birësimi i fëmijës K.N”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.10.2016.

Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 8.9.2016 dhe me shortin elektronik të datës 9.9.2016 i është caktuar gjyqtarës Enkeleda Kapedani. Me vendimin e datës 13.9.2016, gjyqtarja Enkeleda Kapedani caktoi seancën përgatitore më 28.9.2016, ora 13:30. Njoftimi i palëve është bërë me fletëthirrje të dërguara nga gjykata në datën 13.9.2016 dhe caktimi i seancës respektuar afatin 10-ditor të përcaktuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile.

Pas tri seancave gjyqësore është vendosur pranimiti i kërkesës për birësimin e fëmijës nga dy kërkuarit.

Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor u dorëzuan në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në datën 10.10.2016, pra brenda 5 ditëve nga shpallja, në respektim të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 308, paragrafi i dytë, i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 26 ditë, në intervalin kohor 9.9.2016 - 5.10.2016. Kohëzgjatja e gjykimit ka respektuar afatin standard 4-mujor të përcaktuar nga germa “d”, e pikës 5, e Aneksit 1, të Sistemit të Rivlerësimit. Rrjedhimisht, është respektuar standardi për një proces të rregullt ligjor, i parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

C/I. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja mbi të cilin edhe është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt, konstatoi si vijon:

a. Për sa i përket tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, u vërejt se në dokumentet 1 dhe 2, kohëzgjatja e gjykimit nuk mund të përcaktohej, pasi në tekstin e vendimit nuk ishte shënuar data e regjistrimit të çështjes.

a.i Në lidhje me dokumentin 2 nuk identifikoheshin të dhëna nëse ai ishte ankimuar.

b. Në lidhje me pesë dosjet e shortuara, nga analizimi i dokumentacionit nuk rezultoi ndonjë problematikë që mund të ndikonte në vlerësimin profesional të subjektit.

b.i Për çështjet gjyqësore që i përkisnin dosjeve nr. 1, 4 dhe 5 nuk rezultoi të jetë ushtruar ankim nga palët. Sa i përket dosjes 2, vendimi ishte ankimuar dhe pas gjykimit rezultonte se ishte lënë në fuqi.

b.ii Ndërsa, për çështjen civile të përshkruar si dosja nr. 3 nuk kishte të dhëna nëse ishte ushtruar ankim dhe, për pasojë, nuk identifikoheshin statusi përfundimtar i saj.

c. Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë për sa përshkruhet në germa (a.i) dhe (b.ii), si dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës.

Subjekti, në lidhje me këto kërkime, ka parashtruar si në vijim

Në dokumentin nr. 1, që i përket vendimit gjyqësor civil nr. ***, datë 17.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi çështjen gjyqësore që i përket paditësit S.N (përfaqësuar nga av. G.M), kundër të paditurit shoqëria “****”, me objekt “shpërblim dëmi etj.” rezulton se çështja është regjistruar në datën 5.2.2014, sipas vërtetimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi është dhënë në datën 17.4.2014. Nga kjo rrjedh se gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 9 ditë. Pra, kjo çështje është zgjidhur brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Në lidhje me dokumentin nr. 2, që i përket vendimit gjyqësor civil nr. ***, datë 28.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështjen gjyqësore që i përket paditësit shoqëria “****” kundër të paditurit shoqëria “****” sh.p.k. (përfaqësuar nga av. E.M), me objekt “përmbushjen e detyrimeve kontraktuale etj.” rezulton se çështja është regjistruar në datën 20.1.2014 sipas vërtetimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi është dhënë në datën 28.3.2014. Nga kjo rrjedh se gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 8 ditë. Pra, kjo çështje është zgjidhur brenda afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Vendimi është ankimuar nga pala e paditur dhe Gjykata e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 15.7.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të ankimuar.

Në lidhje me dosjen nr. 3, me palë paditëse shoqëria “****”, të paditur A.R etj., rezulton se nuk është ushtruar ankim nga asnjë palë ndërgjyqëse dhe vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 9.5.2014.

Subjekti ka depozituar si prova mbështetëse:

- vendimin gjyqësor civil nr. ***, datë 28.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- vendimin gjyqësor civil nr. ***, datë 1.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- dy vërtetime.

Tej kërkimit të Komisionit, subjekti ka sqaruar edhe lidhur me afatin e shqyrtimit që i përket dosjes nr. 1, ku është konstatuar se: “Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 21.4.2014 – pas 7 ditëve nga shpallja e vendimit, duke tejkaluar me dy ditë afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale”. Konkretisht, ka renditur dispozitat ligjore⁹⁴ për të pasqyruar faktin se *legjislacioni nuk ka bërë një parashikim ligjor lidhur me afatin e arsytimit të një vendimi penal, në praktikë i jemi referuar afatit të ankimit kundër vendimit. Pra, për sa kohë afati i ankimit ishte 10 ditë, atëherë nënkuptohet që vendimi duhet detyrimisht të arsyetohet brenda afatit 10-ditor. Të paktën kjo ka qenë praktika e punës e ndjekur në kohën e dhënies së këtij vendimi nga ana ime deri para ndryshimeve legjislative. Si rrjedhim, kërkoj që arsyetimi i këtij vendimi për 7 ditë të mos konsiderohet jashtë afatit.*

Arsyetimi në raport me shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, të llojit vendime gjyqësore dhe vërtetimeve me shënime përkatëse të gjykatave, ezaurohen paqartësitë e konkluduara në lidhje me statusin e vendimeve gjyqësore pas dhënies së tyre nga subjekti. Në tërësi të verifikimit të çështjeve të identifikuar në raport, trupi gjykues nuk vëren parregullsi të natyrës procedurale dhe në këtë këndvështrim nuk konstaton ndonjë problematikë që mund të ndikojë në vlerësimin e kriterit profesional ndaj subjektit. Po ashtu, përgjithësisht, lidhur me komponentët përbërës të raportit të vlerësimit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit nuk diktohen problematika në aftësitë e

⁹⁴Neni 113 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda 5 ditëve nga bërja e tyre. Për aktet e ankueshme njoftohen prokurori dhe persona që me ligj i njihet e drejta e ankimit”. Neni 415 i Kodit të Procedurës Penale (ligji kohës) parashikon se: “Afati për të bërë ankim është 10 ditë”. Neni 386 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes”. Në asnjë dispozitë ligjore të Kodit të Procedurës Penale nuk parashikohet shprehimisht afati i arsytimit të vendimeve penale. Madje, neni 386 parashikonte që vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes, duke lënë të nënkuptuar që nuk ka asnjë afat për arsyetimin e vendimeve.

saj profesionale në drejtim të njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, njohurive organizative, si dhe në kriteret e tjerë matës të vlerësimit të etikës në punë, integritetit, komunikimit dhe paanësisë në gjykime.

Çështje të tjera

Sikurse është theksuar më sipër në këtë vendimmarrje, gjatë hetimit për kontrollin e figurës, referuar *indicieve* të marra nga autoritetet verifikuese, Komisioni ka administruar një dosje civile dhe disa dosje penale, në kuptim të nenit 41/4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit parashikohet se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale”*.

1. Në lidhje me çështjen civile

1.1 Komisioni⁹⁵ administroi kopje të dosjes elektronike me palë ndërgjyqëse, paditës L.B, të paditur SH.T dhe M.T, palë e tretë: ZVRPP-ja Peqin dhe ALUIZNI, me objekt “lirim e dorëzim sendi, njohje pronari, regjistrim i kontratës së shitjes, sigurim padie dhe pezullim i procedurave të legalizimit”.

1.2 Nga provat e administruara rezultoi se kjo çështje, fillimisht, ishte gjykuar nga disa subjekte rivlerësimi. Së fundi, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 6.4.2021, kishte vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë duke njohur paditësit pronarë në pjesën takuese të tyre dhe, më tej, edhe detyrimin e ASHK-së për regjistrimin e pasurisë, duke rrëzuar pjesën tjetër të objektit të padisë. Nga informacioni i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan rezultoi se çështja ishte në Gjykatën e Apelit Durrës, mbi bazë ankimi. Në tërësi u vërejt se vendimi ishte i strukturuar sipas një standardi të caktuar. Në të identifikohet pjesa hyrëse, ku pasqyrohen palët ndërgjyqëse, objekti i padisë dhe baza ligjore, arsytimi i vendimit, dispozitivi i vendimit së bashku me pasqyrimin e të drejtës ankimore të palëve ndërgjyqëse.

Lidhur me këtë çështje, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësojë statusin aktual të saj, si dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës

1.3 Subjekti, përveçse ka sqaruar mbi statusin e çështjes, ka zgjeruar shpjegimet e saj duke parashtruar lidhur me kompleksitetin e saj duke qenë çështje pronësie me problematika të ndryshme, si ndërtime pa leje, kthimi dhe kompensimi i pronave, legalizimi i ndërtimeve, kryerja e disa aktekspertimeve, shtimi dhe pakësimi i objektit të padisë, ku për pasojë imponohen edhe shtyrjet e seancave.

1.4 Ndër të tjera, subjekti është shprehur: *“... mund të them se kam respektuar me përpikmëri ligjin material dhe procedural civil, kam respektuar të gjitha hallkat që karakterizon këtë lloj gjykimi, kam mbledhur të gjitha provat e nevojshme dhe bazuar në po këto prova kam disponuar me vendim pranim pjesërisht të padisë. Nga aktet e dosjes nuk rezulton se identifikohet ndonjë element që të lërë dyshime për shkelje ligjore apo përfitime të parregullta të trupit gjykues.*

Kjo dosje identifikohet te rubrika e vlerësimit të pastërtisë së figurës, duke lënë të nënkuptuar se ka pasur dyshime për veprime korruptive nga ana e gjykatës. Më lejoni t’ju sqaroj se çështja në fjalë është trajtuar me profesionalizëm nga ana ime, kam respektuar të drejtat e të gjitha palëve në proces, kam garantuar rregullat e procesit të rregullt ligjor, rregullat e solemnitetit të seancës, nuk kam pasur kurrë komunikime ex partes me asnjë prej palëve pjesëmarrëse në këtë gjykim, kam kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, kam marrë vendim vetëm bazuar në

⁹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 14.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ligj dhe prova, si dhe në bindjen time të brendshme, krijuar mbi provat e administruara në gjykim.

Kjo çështje është ankimuar nga pala e paditur dhe është në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës. Ndodhur në këto kushte, përderisa nuk ka një vendim përfundimtar për këtë çështje çmoj se kjo ankesë nuk mund të jetë objekt vlerësimi në kuptim të nenit E të Kushtetutës, ku ndër të tjera thuhet se: ‘Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim’. Pra, kjo çështje është në proces shqyrtimi në shkallë të dytë”.

1.5 Subjekti ka depozituar: RIV të printuar nga sistemi ku përcaktohet data e marrjes së dosjes nga subjekti; vendimin gjyqësor civil nr. ***, datë 6.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; vërtetimin nr.*** prot., datë 21.10.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës.

1.6 Trupi gjykues, nga analizimi i rastit, nuk konstatoi problematika të natyrës procedurale, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit. Në tërësi identifikohet një çështje pronësore me palë ndërgjyqëse të përfaqësuara nga mbrojtës ligjorë.

2. Komisioni administroi⁹⁶ dosjet penale në ngarkim të shtetasve M.B⁹⁷, L.K, A.G dhe E.S.

- Nga aktet rezultoi si vijon:

a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 28.9.2020 (dhënë nga subjekti i rivlerësimit), me palë, kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, kundër A.K a L.T, a XH.S me objekt “njohje e vendimit penal të huaj për këtë shtetas, me bazë ligjore nenin 512 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pranimin e kërkesës, njohjen e vendimit penal të huaj nr. *** reg. Gen, nr. ***, nr. ***, nr. ***, datë 6.5.2002, të Gjykatës Bergamo Itali, i cili ka marrë formë të prerë në datën 21.4.2003, për veprën penale “vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë dhe caktimin e dënimit të tij me 14 vjet burgim, bazuar në gërmën “b”, të nenit 68, të Kodit Penal, mosekzekutimin e këtij vendimi për shkak të afateve të parashkrimit. Shuarjen e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për këtë shtetas, dhënë me vendimin nr. ***, datë 19.3.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Rezultoni se vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Në analizë të bazës ligjore⁹⁸, me të cilën vihet në lëvizje gjykata, vërehet se është organi i akuzës që ka bërë kërkimin e tij për vendimin e dhënë ndaj këtij të dënuari, ashtu sikurse parashikohet në këtë dispozitë.

Nga aktet e administruara në dosje rezultoi se për nga radha dhe rëndësia e veprimeve ato janë pasqyruar në vendimmarrjen e subjektit. Subjekti, në arsyetimin e vendimit, ka përshkruar në mënyrë kronologjike kërkimin e organit të akuzës, vendimmarrjen e huaj, arsyet e njohjes së vendimit penal të huaj dhe ato të mosekzekutimit të vendimit për shkak të parashkrimit.

Në këtë rast gjykata është vënë në lëvizje nga organi i akuzës. Rezultoi se vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, sikurse u citua edhe më lart.

Në tërësi, për këtë çështje, trupi gjykues nuk ka diktuar problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

⁹⁶Shkresë nr. *** prot., datë 15.7.2021, përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁹⁷Lidhur me çështjen që i përket këtij shtetasi, Komisioni është shprehur në denoncimin nr. 1, depozituar nga shtetasit B.M dhe K.B.

⁹⁸Neni 512/njohja e vendimeve penale të huaja: 1. Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar, ose ndaj personave të proceduar penalisht në shtetin shqiptar, i dërgon prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, një kopje të vendimit dhe dokumentacionin përkatës, bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe. 2. Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar. 3. Prokurori i bën kërkesë gjykatës së rrethit gjyqësor për njohjen e vendimit të huaj. Nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë ai mund t'u kërkojë autoriteteve të huaja informacionet që i çmon të nevojshme.

b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në informacionin e dhënë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfirmon mbi ecurinë e procesit të çështjes administrativo - penale nr. *** akti, datë 16.10.2020, me kërkesë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt “njohje vendimi penal të huaj” për shtetasin A.G.

Nga aktet e administruara rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 12.3.3021 (vendim i dhënë nga subjekti i rivlerësimit) ka vendosur “Ti parashtrojë Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës, sa i takon kërkesës penale me nr. *** regj. themeltar, datë 16.10.2020, kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim”.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 11.5.2021, ka vendosur zgjidhjen e konfliktit të kompetencës lëndore për këtë çështje, duke vendosur që kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në trajtimin e kësaj çështjeje, duke iu përmbajtur akteve të administruara, trupi gjykues nuk konstatoi ndonjë problematikë që mund të ndikojë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

c. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021 (dhënë nga subjekti i rivlerësimit), për çështjen me kërkesë, E.S⁹⁹, person i tretë/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kosovë – Lushnje, me objekt: Lirim para kohe me kusht, baza ligjore: neni 64 i Kodit Penal dhe neni 477 i Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “Pranimin e kërkesës, lirimin me kusht të këtij të dënuari, mbajtjen e kontakteve me shërbimin e provës, detyrimin të ushtrojë veprimtari profesionale sipas deklaratës noteriale të punësimit ...”. Sipas shënimit të bërë në këtë vendim rezulton se ndaj tij është ushtruar ankim nga organi i akuzës. Po ashtu, nga informacioni i po kësaj gjykate bëhet me dije se çështja ndodhet në Gjykatën e Apelit Durrës.

Nga verifikimi i vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, duket se janë analizuar të gjithë bazat ligjore që i përkasin këtij objekt kërkimi. Në këtë çështje, organi i akuzës ka kundërshtuar lirimin para kohe me kusht. Pasqyrohen vendimmarrjet unifikuese të Gjykatës së Lartë pothuajse në të gjitha kriteret kumulative që kërkon shqyrtimi dhe vendosja e këtij objekti kërkimi. Ndër të tjera, vërehet se subjekti në arsyetimin e vendimit ka argumentuar referuar ligjit të zbatueshëm (nenit 64 të Kodit Penal, nenit 477 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 31/6 të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, etj.) se i dënuari ka përmbushur $\frac{3}{4}$ e vuajtjes së dënimit për të përfituar këtë kërkim. Po ashtu, vërehet se subjekti ka arsyetuar dhe pasqyruar në arsyetimin e vendimit edhe mbi një kontratë punësi për të dënuarin në rast pranimi të kërkesës, ofruar nga një person fizik i licencuar, duke bërë referencë në këtë rast edhe vendimin nr. 2, datë 25.5.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Subjekti ka cituar në vendim se i dënuari ka qenë përfitues edhe i një amnistie, por që $\frac{3}{4}$ e dënimit (gjithnjë sipas arsyetimit të vendimit) janë përmbushur pa përfshirë këtë përfitim. Pra, në tërësi, pa zëvendësuar logjikën e subjektit të rivlerësimit në arsyetim, vërehet se në vendimmarrje janë dhënë dhe arsyetuar detaje lidhur me përmbushjen e objektit të kërkimit nga i dënuari.

Komisioni (pas analizimit vetëm mbi bazë vendimi) i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën pasi dukej se: (i) nuk qëndronte vendimmarrja në raport me kërkimin e organit të akuzës¹⁰⁰, përfshirë këtu dhënien e shpjegimeve lidhur me veprimtarinë procedurale të ndjekur në dosjen objekt gjykimi, prej regjistrimit të kërkesës dhe deri në vendimmarrjen

⁹⁹Me vendimin nr. ***, datë 17.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është bërë njohja e vendimit penal të huaj për veprën penale “vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 78 dhe 25 të Kodit Penal dhe është dënuar përfundimisht me 24 vjet burgim.

¹⁰⁰Komisioni mban në vëmendje tagrin dhe ushtrimin e kompetencave pa zëvendësuar logjikën e përdorur në arsyetimin e vendimit nga subjekti.

përkatëse (ku përfshihet kohëzgjatja e gjykimit të çështjes, caktimi i seancave dhe njoftimi i palëve), si dhe kopje të dokumentacionit mbështetës.

Subjekti, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Në lidhje me çështjen me kërkues E.S me objekt lirim me kusht rezulton se kam vendosur të pranoj kërkesën e të dënuarit dhe ta liroj atë duke i vënë kushtin që ai të mbajë kontakte me shërbimin e provës për pjesën e mbetur të dënimit prej 2 vjet e 9 muaj e 13 ditë, pasi kishte vuajtur 21 vjet e 2 muaj e 17 ditë burgim. Nga aktet e dosjes rezulton se kam kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes duke marrë në administrim dhe shqyrtim të gjitha provat e sjella nga pala kërkuese, nga IEVP-ja Kosovë Lushnje. Gjithashtu, në kuadër të një hetimi të drejtë, të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin kam ngarkuar edhe Shërbimin e Provës Elbasan për të hartuar një raport vlerësimi, nëse i dënuari është rehabilituar dhe nëse ia ka arritur qëllimit dënimi i vuajtur deri në atë moment.*

Rezulton se institucioni i IEVP-së Kosovë Lushnje ka paraqitur një vlerësim sjelljeje pozitive për të dënuarin duke konkluduar se: ‘Mbështetur në vlerësimin e mësipërm, konkludojmë se shtetasi i dënuar E.S për këtë periudhë të vuajtjes së dënimit ka shfaqur sjellje dhe qëndrim korrekt në respektimin e rregullores. Ka shfaqur komunikim të rregullt verbal dhe joverbal me stafin e institucionit dhe bashkëvuajtësit. Shfaq shenjë përgjegjësie, është i motivuar dhe bashkëpunon për arritjen e objektivave.

*Raporti i Shërbimit të Provës Elbasan ka sjellë një raport vlerësimi pozitiv, ku ka konkluduar se: ‘... nëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan do të pranojë kërkesën me objekt ‘Lirim para kohe me kusht’, riintegrimi i të dënuarit E.S është i mundur sepse: ‘Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. ***, datë 5.10.2020, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se i dënuari E.S është dënuar vetëm një herë (për veprën penale që po vuan dënimin) dhe të mos jetë recidivist në krim. Me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2020, nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër jemi informuar se nuk kanë të dhëna për viktimën apo familjarëve të tij, si dhe nuk kanë dijeni për ngjarjen e datës 17.4.2003 që ka ndodhur në shtetin italian dhe nuk kanë dijeni për probleme të mundshme midis të dënuarit dhe familjarëve të tij me familjen e viktimës. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.1.2021, nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë jemi informuar se nuk kanë të dhëna për viktimën apo familjarëve të viktimës dhe nuk njihet nga shërbimet e DVPL-së. Gjatë vuajtjes së dënimit me burgim i dënuari ka manifestuar një sjellje dhe qëndrim korrekt dhe të qëndrueshëm duke respektuar rregulloren e përgjithshme të burgjeve dhe rregulloren e brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale Lushnje. Në rast të lirimit me kusht, i dënuari kërkon të punësohet, me qëllim rritjen e nivelit ekonomik dhe të jetesës së familjes së tij. I dënuari ka paraqitur një kontratë premtim punësimi pranë subjektit ‘P.M, me NIPT ***, me objekt të aktivitetit ‘shitje me shumicë e pakicë’... Organi i prokurorisë ka paraqitur më pas ankim kundër vendimit, pasi nuk ka qenë dakord me lirimin e tij me kusht dhe në seancë është shprehur për rrëzimin e kërkesës me argumentin që nuk ka një deklaratë për normalizimin e marrëdhënieve midis të dënuarit dhe familjarëve të viktimës.*

Vlerësoj se lirimi me kusht nuk ka si kriter detyruës normalizimin e marrëdhënieve me familjarët e viktimës. Ky është një kriter që merret dhe vlerësohet në harmoni me provat e tjera që karakterizojnë rastin konkret. Duket se qëndrimi negativ i organit procedues është abstrakt, jo i qartë dhe i paargumentuar. Vlerësoj se në rastin konkret, pavarësisht faktit që kërkuesi është dënuar për veprën penale ‘vrasje’, nuk duhet ta penalizoj atë nga e drejta për të përfituar nga një e drejtë ligjore kur kërkimi i tij është i bazuar në ligj dhe në prova. Kodi Penal nuk parashikon ndonjë ndalim ligjor për të përfituar lirimin me kusht lidhur me veprën penale të kryer prej tij, nëse lirimi me kusht për një të dënuar do të mohohej apriori për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprave penale të kryera, do të kishim penalizim të dyfishtë të tij për të njëjtin shkak, pasi po për shkak të rrezikshmërisë së veprave penale, i dënuari do të merrte një dënim të ashpër dhe po për këtë shkak, do të humbiste mundësinë e lirimit me

kusht, institut që lidhet me rehabilitimin e një të dënuari, riintegrimin e tij në shoqëri dhe jo me përcaktimin e dënimit, si rrjedhojë e rrezikshmërisë shoqërore të krimit të kryer.

*Fakti që ky i dënuar është rehabilituar dhe është arritur qëllimi i dënimit provohet edhe nga sjellja e tij pas lirimit me kusht, pasi ai ka respektuar me përpikmëri detyrimet e përcaktuara në vendimin e gjykatës dhe, më konkretisht, nga shkresa nr. *** prot., datë 3.11.2021, e Shërbimit të Provës Tiranë provohet se shtetasi E.S ka mbajtur kontakte të rregullta me shërbimin e provës dhe nuk ka kryer asnjë vepër tjetër penale përgjatë kësaj periudhe. Ai ka ndjekur, gjithashtu, veprimtari profesionale pasi rezultoi i punësuar pranë personit juridik/fizik *** (bashkëlidhur shkresa e Shërbimit të Provës Tiranë dhe vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë).*

Në përfundim kërkoj që qëndrimi im si subjekt rivlerësimi në cilësinë e gjyqtarës në këtë vendimmarrje të konsiderohet i drejtë, pasi vendimi është dhënë bazuar në provat e shqyrtuara, në zbatim të kriterëve ligjore të gjetura kumulativisht të plotësuar dhe në bindjen e brendshme të gjyqtarit, krijuar në mënyrë të pavarur bazuar vetëm në prova dhe në ligj.

Në këtë rast, nga ana e gjykatës nuk ka asnjë shkelje të ligjit material ose procedural, kam respektuar të gjitha hallkat që karakterizojnë këtë lloj gjykimi, kam mbledhur të gjitha provat e nevojshme dhe bazuar në po këto prova, si dhe në konkluzionet pozitive të organeve ndihmëse si IEVP dhe Shërbim i Provës kam arritur në një vendim në favor të të dënuarit. Nga aktet e dosjes nuk rezultoi se identifikohet ndonjë element që të lërë dyshime për shkelje ligjore apo përfitim të parregullta prej meje. Duke qenë se ky vendim është ankimuar nga organi i akuzës dhe çështja është ende në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës, për të cilën nuk ka një vendim përfundimtar dhe nuk mund të analizohet përmbajtja e tij në efekt të kundërt.

Ndodhur në këto kushte, përderisa nuk ka një vendim përfundimtar për këtë çështje, çmoj se kjo ankesë nuk mund të jetë objekt vlerësimi në kuptim të nenit E të Kushtetutës, ku ndër të tjera thuhet se: ‘Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim’. Pra, kjo çështje është në proces shqyrtimi në shkallë të dytë.

Kjo dosje identifikohet tek rubrika e vlerësimit të pastërtisë së figurës, duke lënë të nënkuptuar se ka pasur dyshime për veprime korruptive nga ana e gjykatës. Më lejoni t’ju sqaroj se çështja në fjalë është trajtuar me profesionalizëm nga ana ime, kam respektuar të drejtat e të gjitha palëve në proces, kam garantuar rregullat e procesit të rregullt ligjor, rregullat e solemnitetit të seancës, nuk kam pasur kurrë komunikime ex partes me asnjë prej palëve pjesëmarrëse në këtë gjykim, kam kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, si dhe kam marrë vendim vetëm bazuar në ligj dhe prova, si dhe në bindjen time të brendshme krijuar mbi provat e administruara në gjykim”.

Subjekti ka depozituar:

- dosjen penale nr. *** akti., datë 21.9.2020, për të dënuarin E.S (dosja e plotë);
- vërtetimin nr. ***, datë 21.10.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 3.11.2021, nga Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Tiranë.

Arsyetimi ligjor në raport me shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar

Trupi gjykues, në analizë të provave të depozituara nga subjekti dhe shpjegimeve të dhëna, vëren se gjykimi i kërkesës penale kryesisht për shkak të objektit të saj “lirim me kusht” ka përfshirë në vlerësim një mori provash, të cilat domosdoshmërisht nevojiten në përfundimin e saj. Si në çdo çështje të kësaj natyre, elementi bazë dhe jo i vetëm për vendosjen mbi këtë kërkesë penale është përmbushja e afatit të vuajtjes së dënimit¹⁰¹ me ¾, që në këtë rast rezultoi të plotësuar, por e lidhur ngushtësisht me objektivin kryesor atë të riedukimit, karakterin human

¹⁰¹Dënuar për veprën penale “vrasje me paramendim”.

të lirit me kusht dhe elementë të tjerë, të cilët kryesisht janë raporte të përcjella nga organet kompetente si nga Shërbimi i Provës dhe institucioni i vuajtjes së dënimit, akte këto që i referohen gjykatës dhe nuk krijohen prej kësaj të fundit, ndikojnë të gjitha së bashku në tërësinë e vlerësimit të kërkesës. Në këtë drejtim duket se në këtë rast këto objektivë janë plotësuar dhe konsideruar nga gjykata. Nga ana tjetër, kryerja e veprës penale prej vitit 2003, e shoqëruar edhe me informacionin e organeve kompetente sa i përket marrëdhënieve¹⁰² midis familjarëve të viktimës dhe autorit apo familjarëve të tij, duket se kanë marrë peshë në vendimmarrjen e subjektit. Gjithashtu, në këtë vendimmarrje, peshë ka marrë edhe mundësia/oferta e punësimit për të dënuarin, faktor të cilin vendimi nr. 2, datë 25.5.2015, i Kolegjeve të Bashkuara e konsideron si opSION për lirinë me kusht të të dënuarit. Në tërësi vërehet se janë kryer veprimet e duhura procedurale (pasqyrimi i seancave gjyqësore në procesverbalet përkatëse, njoftimi i palëve, kërkimi i informacioneve atyre institucioneve që përfshihen në këto lloj kërkesash penale, etj.) në këtë çështje duke e finalizuar vendimmarrjen përsëri me kushtin që i dënuari, pavarësisht pranimit të kërkesës, ka qenë i detyruar të jetë nën kontaktet e Shërbimit të Provës¹⁰³ dhe ushtrimit të veprimtarisë profesionale¹⁰⁴. Kjo analizë, përfshirë edhe logjikën e arsytimit të subjektit e cila në çdo rast mbetet e pazëvendësuar, duket se deri në këtë fazë të hetimit nuk përbën shkak për penalizim të subjektit në vlerësimin e këtij kriteri.

Gjetje të tjera

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni është njohur:

- Me informacionin e pasqyruar në sistemin TIMS¹⁰⁵, në të cilin në mënyrë të përmbledhur është përshkruar: *“Shtetasi L.Q shpallet në kërkim, pasi në datën 17.1.2016, në rrugën ‘***’ është qëlluar me armë zjarri me pistoletë. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se autori i dyshuar i kësaj ngjarjeje është shtetasi L.Q, për veprën penale ‘prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake’ dhe ‘prishje e qetësisë së rendit publik’ dhe ‘kanosje’, e parashikuar nga nenet 278, 84 dhe 274 të Kodit Penal”.*

- Me një shkrim të bërë publik në media¹⁰⁶(ku identifikohet shtetasi L.L për të cilin thuhet se është konfliktuar mbrëmjen e së dielës në rrugën “***”, me një shtetas tjetër, për prishjen e pazareve në shitjen e një automjeti, si dhe është identifikuar shtetasi me initiale L. Q., për të cilin në shkrim thuhet se *është identifikuar dhe shpallur në kërkim shtetasi me initiale L. Q., i cili rezultoi të ketë shkrepur dy herë në ajër një pistoletë, që dyshohet të jetë “***”, e kalibrit 7.62 mm).*

Komisioni ka mbajtur korrespondencë me Komisaratin e Policisë Nr. ***, Tiranë, për t’u informuar lidhur me ecurinë e kësaj çështjeje, statusin aktual të saj, si dhe për të marrë një kopje të plotë të praktikës së kësaj çështjeje.

Në informacionin e dërguar¹⁰⁷ qartësohet mbi një konflikt pronësie midis shtetasit L.L dhe G.K, ku në konflikt janë përfshirë edhe rreth i tyre shoqëror. Ndërkohë, thuhet në informacion, në largësi nga vendi i ngjarjes një person i paidentifikuar ka shtënë një herë me armë zjarri në ajër, ku gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale, dy gëzhoja. Nga ky komisarati janë kryer veprimet procedurale në lidhje me këtë ngjarje dhe materialet i kanë kaluar Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më tej është

¹⁰²Në pikën 34 të vendimit nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara, ndër të tjera, citohet: *“Megjithatë, Kolegjet vlerësojnë se ndërsa në vetvete normalizimi i marrëdhënieve nuk është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërkesës për lirim me kusht ...”.*

¹⁰³Mbajtja e kontaktit me Shërbimin e Provës gjendet në ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Neni 31/6, paragrafi 5, i këtij ligji parashikon se: *“Personi i liruar me kusht duhet t’i raportojë rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirit me kusht”.*

¹⁰⁴Shihni pikën 69, të vendimit nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara, ku ndër të tjera citohet: *“Planet për të punuar apo sigurimi i një kontrate pune duhen konsideruar si një element mjaft i rëndësishëm që shkon në favor të kërkuarit”.*

¹⁰⁵Nga aksesi në këtë sistem.

¹⁰⁶[http://www.panorama.com.al/***\)](http://www.panorama.com.al/***))

¹⁰⁷Shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 29.1.2016, për veprat penale “kanosje”, “prishje e qetësisë publike” dhe “armëmbajtje pa leje”. Procedimi është deleguar për kryerjen e veprimeve të tjera procedurale dhe me gjithë punën e kryer nuk është arritur të identifikohet personi që ka qëlluar me armë zjarri në ajër. Megjithatë, thuhet në informacion (në shkresën përcjellëse të çështjes penale), *shtetasi Q është shpallur në kërkim policor si i dyshuar që ka qëlluar me armë zjarri, nuk është intervistuar dhe nuk ka asnjë akt për këtë shtetas, i dyshuari kryesor është shtetasi A.M, megjithëse nuk janë përfutur prania e nitriteve dhe nitrateve, pas marrjes së faktorëve të qitjes. Në përfundim të hetimeve ky procedim është pezulluar për moszbulim të autorit.*

- a. Në analizë të akteve të fashikullit penal duket se bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit, shtetasi L.Q, nuk identifikohet në këtë çështje në asnjë cilësi individuale apo në bashkëpunim, si një person që mund të ketë dijeni për rrethanat e ngjarjes/e veprës penale, në cilësinë e një të dyshuari apo të personit nën hetim. Në lidhje me këtë çështje është vendosur pezullimi, që do të thotë se në çdo moment mund të riçelet hetimi, për aq kohë sa shtetasi Q nuk është intervistuar dhe nuk ka asnjë akt për të.
- b. Një nga dëshmitarët e intervistuar, shtetasi A.M në procesverbalin e rideklarimit të tij datë 14.6.2016, ka përmendur shtetasin L.Q si person prezent në ngjarje.
- c. Duket sikur bashkëjetuesi i subjektit, person i lidhur me të, është përfshirë në ngjarje, që mund të cenojnë edhe figurën e subjektit.

- Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime.

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Bashkëjetuesi im nuk ka qenë absolutisht i përfshirë në këtë ngjarje. Ky fakt mbështetet tërësisht në dokumentacionin që ju më keni vënë në dispozicion. Dua të sqaroj se ditën e ngjarjes datë 17.1.2016, unë kam qenë e shtruar në spital në terapi intensive në repartin e reanimacionit të spitalit “***”, ndërsa vajza e sapolindur ishte në inkubator për shkak të lindjes së parakohshme dhe problemeve shëndetësore. Për shkak të qëndrimit në terapi intensive i vetmi person që lejohej të qëndronte pranë meje ishte bashkëshorti, si rrjedhim ai ka qenë non stop pranë meje duke u kujdesur për mua. Nuk duket as logjike dhe as njerëzore që një person që ka nënën e fëmijëve duke luftuar për jetën të dalë për dreka në grup apo të bëjë aventura të ngjashme me far-west. Për këtë ju paraqes një vërtetim të lëshuar nga spitali “***”, ku tregon se në datën 17.1.2016 kam qenë e shtruar në spital. Bashkëlidhur vërtetimi datë 11.3.2022 i spitalit “***”.*

Së dyti, ka një non sens logjik dhe juridik në konstatimin tuaj lidhur me faktin që kjo çështje është e pezulluar mund të riçelet për aq kohë sa shtetasi Q nuk është intervistuar dhe nuk ka asnjë akt për të. Ndër të tjera, referohet neni 326 i Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë procedurale penale parashikon se vendoset pezullimi i hetimeve nëse nuk njihet autori i veprës penale siç ka ndodhur në rastin konkret. Nga dosja hetimore rezulton se ka ndodhur një ngjarje në janar të vitit 2016 ku janë përfshirë disa persona. Për këtë ngjarje është shpallur në kërkim policor në datën 18.1.2016 bashkëjetuesi im edhe pse nuk ka qenë fare në vendngjarje. Nga studimi në tërësi i dosjes hetimore rezulton se kanë dhënë deklarime personat e përfshirë në këtë ngjarje, deklarime të cilat janë në harmoni me njëra-tjetrën dhe asnjë prej tyre nuk ka përmendur që bashkëjetuesi im të ketë qenë prezent. Këto deklarime janë dhënë ditën e ngjarjes, pra në datën 17.1.2016, si rrjedhim janë dëshmi të vërteta dhe të pandikuara nga faktor të jashtëm (presion, miqësi, armiqësi etj.)”.

Subjekti është shprehur se nga studimi i gjithë dosjes në tërësi nuk i ka rezultuar asnjë provë që bashkëjetuesi i saj të ketë qenë në vendngjarje, askush nuk ka deklaruar që ai të ketë qenë aty, duke pretenduar se pavarësisht kësaj personi që shpallet në kërkim policor është pikërisht ai. Subjekti ka pretenduar se vendimi për shpalljen e tij në kërkim policor është abuziv, pa u bazuar në asnjë akt të dosjes hetimore dhe në asnjë provë të saj, por është kryer nisur nga

vullneti personal e keqdashës i një punonjësi të policisë, i cili kishte hakmarrje personale ndaj bashkëjetuesit të saj. Subjekti ka konfirmuar se prej bashkëjetuesit të saj është kërkuar informacion nga Komisariati i Policisë, por përgjigjja është evazive. Ajo ka pretenduar se emri i bashkëjetuesit të saj është nxjerrë në mënyrë abuzive në kërkim policor për një ngjarje për të cilën nuk kishte asnjë lidhje, veprim i cili ka cenuar rëndë të drejtat e tij kushtetuese, duke konsumuar kështu elementët e figurës së veprës penale “shpërdorim detyrë” sipas nenit 248 të Kodit Penal nga ana e këtyre punonjësve, çështje për të cilën ka sqaruar se do të ndjekë rrugën ligjore.

Subjekti ka sqaruar se nuk ka prova mbi të cilat mund të kryhet intervistimi i tij i ardhshëm, për sa kohë kundër tij nuk ka dhe nuk ka pasur asnjë akt, provë apo *indicie* që ta implikojë lidhur me këtë ngjarje as nuk është bërë intervistimi i tij, si dhe ka saktësuar se urdhri për nxjerrjen e tij në kërkim policor është tërësisht në kundërshtim me përmbajtjen e akteve të dosjes, është i paligjshëm dhe është kryer në kushtet e shpërdorimit të detyrës nga ana e punonjësve të policisë.

Ajo, gjithashtu, ka pretenduar se Komisioni nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi për çfarë mund të ndodhë në të ardhmen. Subjekti, pasi ka shpjeguar mbi pozitave procedurale të një shtetasi në një proces penal, pra si person që ka dijeni për veprën penale, si person ndaj të cilit atribuohet vepra penale dhe si i pandehur ka qartësuar se për shkak të mosplotësimit të asnjërës prej pozitave procedurale, bashkëjetuesit të saj nuk i janë marrë deklaramet.

Subjekti i është referuar disa vendimeve¹⁰⁸ të Kolegjit të Gjykatës së Lartë lidhur me gabimin e çdo gjykate për pranueshmërinë dhe deklarametin fajtor të një personi vetëm me deklarametin e të dëmtuarit, etj.

Subjekti ka mohuar praninë e bashkëjetuesit të saj në këtë episod, duke sqaruar se nuk i dinte arsyes pse ishin ndryshuar deklarametin pas 6 muajsh (nga shtetasi A.M), por që lehtësisht *është shprehur ajo* është e provueshme që është duke gënjyer, *aq më tepër që po flasim për deklarametin e një personi që është i dyshuari kryesor për ngjarjen e ndodhur tek i cili janë gjetur faktorë të nitriteve apo nitrateve, deklarametin të cilat duhen marrë me rezervë pasi ai mund ta ketë bërë për qëllime të caktuara të cilat nuk i di.*

Subjekti ka sqaruar se dosja është pezulluar 7 muaj më pas deklarametin të dhëna dhe ku bashkëjetuesi i saj nuk është thirrur kurrë për t’u pyetur apo ballafaquar me ndonjë prej personave të përfshirë në ngjarje.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se *dukej sikur bashkëjetuesi i subjektit, person i lidhur me të, është përfshirë në ngjarje, që mund të cenojnë edhe figurën e subjektit*, subjekti ka theksuar se edhe nëse ai do ishte i përfshirë në një ngjarje të tillë (edhe pse nuk ka qenë kurrë) nuk është nga ato vepra që ndikojnë në figurën e subjektit të rivlerësimit, pasi ligji ka përcaktuar qartë kategorinë e veprave që cenojnë figurën.

Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 16.3.2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të provuar se: *“Shtetasi L.Q nuk rezulton të këtë proces penal të regjistruar në ngarkim të tij nga data 1.1.2002 deri më sot”*. Në këto kushte *është shprehur subjekti*, dukshëm bashkëjetuesi i saj nuk ka pasur asnjëherë sjellje të kritikueshme dhe të dënueshme penalisht gjatë gjithë jetës së tij deri më sot.

Subjekti ka depozituar:

- vërtetimin datë 17.1.2016, nga spitali “***”;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 16.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- përgjigjen e Komisarariatit të Policisë Nr. *** Tiranë.

¹⁰⁸Vendimet: nr. ***, datë 19.3.2003; nr. ***, datë 21.12.2005; nr. ***, datë 15.3.2007.

Trupi gjykues në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit vëren se në asnjë prej akteve nuk rezulton të jetë thirrur apo komunikuar në çfarëdo lloj cilësie nga organet ligjzbatuese, shtetasi L.Q, për më tepër një thirrje apo komunikim nuk rezulton të jetë bërë as edhe pasi personi i dyshuar e dëshmoi shtetasin Q si të përfshirë në këtë konflikt.

Në lidhje me videot e publikuara në rrjetin social “Tik Tok”

Komisioni, nisur nga lajmi i bërë publik në median e shkruar dhe atë publike, si dhe në rrjetet sociale në datat 30.5.2021 dhe 31.5.2021 për disa video të publikuara në rrjetin social “Tik Tok”, ku identifikohet subjekti i rivlerësimit, mbajti korrespondencë me KLGJ-në, si dhe pyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me automjetin me të cilin ky i fundit u identifikua në video.

a. Komisioni, në lidhje me publikimin në rrjetin social “Tik Tok” të videove ku identifikohet subjekti i rivlerësimit ka administruar praktikën e plotë të përcjellë¹⁰⁹ nga KLGJ-ja. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar vërehet se me vendimin nr. *** prot., datë 31.5.2020, të ILD-së është vendosur “Fillimi i hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates me detyrë zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan” (për shkak se sjellja dhe qëndrimi i magjistrates në video të ndryshme, të realizuara në ditë të ndryshme, në ambiente të ndryshme, është joetike dhe vijuese). Më tej është zhvilluar dëgjesa me subjektin e rivlerësimit pas hetimit të kryer nga ILD-ja, fakte të cilat identifikohen në praktikë me memo dhe procesverbalet përkatëse. Në përfundim, KLGJ-ja, mbi propozimin e njërit prej anëtareve të saj, ka vendosur me vendimin nr. ***, datë 7.6.2021, “Pezullimin nga detyra të magjistrates deri në përfundimin e procedimit disiplinor, iniciuar nga ILD-ja me vendimin nr. ***, datë 1.6.2021”. Ndër të tjera, në relacionin e relatorit të çështjes thuhet se *bazuar në Kodin e Etikës Gjyqësore veprimet e magjistrates lidhur me regjistrimin e disa videove jashtë orarit zyrtar të punës apo në makinë në jetën private, mundet që të përbëjnë shkelje disiplinore. Zyra si rregull nuk është përdorur për ndonjë veprimtari tjetër të ndryshme nga ajo e gjyqësorit, por në rastin konkret në lidhje me faktin që janë realizuar disa video, të cilat janë mbajtur në telefonin e magjistrates, ajo nuk ka pasur qëllimin që të dilnin në publik. Nisur nga veprimet duhet gjykuar nga ana e Këshillit nëse këto të fundit përbëjnë shkelje të rënda profesionale ose etike dhe që diskretitojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, gjithashtu, në këtë relacion thuhet se nga ILD-ja duhet të ishte arsyetuar edhe parimi i proporcionalitetit në lidhje me kërkesën për pezullim, ndërsa në vendimmarrjen e pezullimit arsyetohet lidhur me verifikimin që duhet bërë për publikimin ose jo të videove prej saj, aksesin që mund të ketë dhënë për shikueshmërinë e tyre, shfaqjen përpara të tretëve dhe për të arritur në këto konkluzione ka kërkuar marrjen e mendimit të një eksperti në fushën e teknologjisë së informacionit. Aktualisht, sipas verifikimit të faqes zyrtare të ILD-së, kjo e fundit nuk ka disponuar me një vendimmarrje. Komisioni analizoi mbi dokumentacionin e administruar nën kontekstin e rivlerësimit të subjektit në frymën e ligjit nr. 84/2016, gërshetuar me ligjin nr. 96/2016, në kuadër të etikës dhe sjelljes që duhet të karakterizojë magjistratin në ushtrimin e detyrës së tij funksionale. Kryerja e disa veprimeve nga subjekti në ambiente të institucionit, në tejkalim të detyrës funksionale apo që nuk kanë lidhje me të, duket se prezanton papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit.*

b. Për sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës pasi dukej se përdorimi i ambienteve të institucionit punëdhënës për regjistrimin e videove në raport me qëllimin e ligjit nr. 84/2016, cenojnë integritetin e magjistratit dhe, për rrjedhojë, edhe besimin e publikut në raport me ushtrimin e funksionit.

Subjekti, në lidhje me këtë çështje ndër të tjera, ka parashtruar si në vijim:

¹⁰⁹Nr. *** prot., datë 18.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 22.9.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

Fillimisht, subjekti ka pasqyruar legjislacionin e fushës duke bërë edhe interpretimet rast pas rasti. Më konkretisht është shprehur:

Në interpretim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore (pika 16, e vendimin nr. 21, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pikat 1 dhe 2 të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, nenet 3/12, 40 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016,) ka pretenduar se *vlerësimi profesional i magistratëve gjatë periudhës së rivlerësimit bëhet mbi bazën e ligjit nr. 84/2016 dhe në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periudha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës. Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim si përjashtim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale.*

Ligji nr. 84/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, më 23.9.2016. Vetë ligji, në nenin 71 të tij, përcakton se *ky ligj hyn në fuqi 15 ditë nga botimit në Fletoren Zyrtare*. Rezulton se ky afat 15-ditor është plotësuar në datën 7.10.2016 dhe nëse i referohemi standardit kushtetues që ligji hyn në fuqi si rregull 15 ditë nga e nesërmja e botimit në Fletoren Zyrtare, atëherë ligji ka hyrë në fuqi më 8.10.2016. Kjo do të thotë se periudha e rivlerësimit kalimtar për komponentin e vlerësimit profesional përfshin periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, si përjashtim përfshin periudhën 1.1.2006 – 8.10.2016.

Ligjet nr. 84/2016 dhe nr. 96/2016 janë miratuar në të njëjtën kohë dhe këto ligje janë harmonizuar me njëri-tjetrin që të mos ketë përplasje midis tyre. Prandaj, po të analizojmë nenin 171, pika 1, e ligjit nr. 96/2016, legjislatori është treguar i kujdesshëm që periudha e vlerësimit që do të bëhet nga KLD-ja t'i korrespondojnë periudhave 2007 – 2009 dhe 2010 – 2012 që nuk hyjnë në periudhën e vlerësimit nga Komisioni, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, që përfshin periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016. Këshillat (KLGJ dhe KLP) sipas nenit 171, pika 7, e ligjit nr. 96/2016 kanë kompetencë që të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional për vitin nga 2017 e në vijim.

KLGJ-ja, duke marrë të mirëqenë faktin që periudha e rivlerësimit kalimtar (nga Komisioni) përfshin periudhën 2013 – 2016, në respektim të nenit 171 të ligjit nr. 96/2016 po bën vlerësimin e gjyqtarëve nga data 1.1.2017 e duke vazhduar deri në vitin 2019. Periudha e rivlerësimit nga Komisioni nuk mund të shtrihet asnjëherë pas datës 8.10.2016, në të kundërt do të kishte përplasje kompetencash midis dy organeve kushtetuese.

Ky kufizim është vendosur me qëllim respektimin e parimit të sigurisë juridike nga njëra anë dhe për respektimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kështu, në vendimin nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese thuhet: *“Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese”*.

Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve duhet të zbatohet jo vetëm në kuadër të veprimtarisë së mekanizmave apo institucioneve që veprojnë në një prej tri degëve kryesore të pushtetit shtetëror, por edhe në mekanizma të tjerë kushtetues që ushtrojnë funksionet e tyre kushtetuese sipas rastit, në mënyrë të pavarur apo si ndërthurje e kompetencave me institucione të tjera kushtetuese.

Subjekti, trajtimin e kësaj çështjeje, e cila ka ndodhur pas vitit 2016, e quan mbivendosje kompetencash me organet kushtetuese, sikurse janë Këshilli i Lartë Gjyqësor¹¹⁰, Këshilli i Lartë

¹¹⁰Shihni nenin 147/a të Kushtetutës ku thuhet shprehimisht se: *“1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: (a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; (b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;*

i Prokurorisë¹¹¹ dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë¹¹², të cilët janë organet kompetente kushtetuese për të bërë inspektimin dhe vlerësimin profesional të magistratëve, për rrjedhojë dy organe të ndryshme mund të marrin vendime të njëjta apo edhe të ndryshme për të njëjtin subjekt e për të njëjtin fakt, që do të binte të kundërshtim me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Subjekti ka pretenduar se në rastin konkret gjetjet e Komisionit lidhur me publikimin e disa videove të saj në rrjetin social “Tik Tok”, në vitin 2021, janë jashtë periudhës së rivlerësimit dhe për këtë pretendon se i vetmi organ kushtetues që ka juridiksion dhe kompetencë për t’i hetuar ato është ILD-ja dhe i vetmi organ kushtetues që ka juridiksion dhe kompetencë për të marrë një vendim lidhur me to është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Subjekti ka parashtruar edhe kronologjinë e hetimit disiplinor lidhur me këtë çështje, duke sqaruar mbi procedurat e ndjekura nga ILD-ja dhe KLGJ-ja, marrëdhënien e saj me këto institucione prej kërkesës për dorëheqje si zëvendëskryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, propozimin e masës disiplinore nga ILD-ja dhe kthimin e çështjes për hetime të tjera po këtij institucioni nga KLGJ-ja, të gjitha rastet e dhënies së shpjegimeve përpara këtyre institucioneve, etj. Pavarësisht hetimeve shtesë nuk u provua që videot janë publikuar prej subjektit dhe ky dyshim shkon në favorin e saj, madje nuk u arrit të provohej se kush i kishte publikuar ato¹¹³.

Subjekti, gjithashtu, ka pasqyruar edhe hapat e ndërmarra prej saj lidhur me këtë çështje, me qëllim përfundimin sa më shpejt të procedurës disiplinore dhe të shprehjes së ndjenjës së përgjegjësisë morale, duke theksuar se ka shprehur dakordësinë për arritjen e marrëveshjes së pranimit, si një shenjë reflektimi, qytetarie, përgjegjësie, përgjegjshmërie dhe vetëndëshkimi moral.

Subjekti pretendon se në asnjë moment nuk është cenuar besimi i publikut, pasi videot nuk përmbanin elemente që cenonin drejtësinë apo veprimtarinë si gjyqtare. Nuk cenonin vendimmarrjet e saj, as paragjykonin ndonjë çështje, apo cilësitë e saj si gjyqtare. Ka theksuar se në këtë rast nuk po takonte ndonjë avokat, palë dhe as po kryente ndonjë veprimtari tjetër që mund të cenonte veprimtarinë e saj gjyqësore. Është shprehur e bindur që nuk është cenuar besimi i publikut në figurën e saj si gjyqtare, pasi në video shfaqen pamje lidhur me jetën e saj njerëzore, si individ, si qytetare, si një njeri normal, asnjë përtej normales dhe njerëzores nuk shfaqej asnjë element që lidhej me drejtësinë apo që mund ta cenonte drejtësinë, palët, të drejtat dhe interesat e tyre.

Subjekti ka theksuar se këto video nuk kanë ndikuar në profesionin e saj dhe as në dhënien e ndonjë vendimi të padrejtë në cilësinë e gjyqtares, nuk kanë cenuar të drejtat e asnjë pale në

(c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit; (ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre; (d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; (dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; (e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; (ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj. 2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. 3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor”.

¹¹¹Shihni nenin 149/a të Kushtetutës ku thuhet shprehimisht se: “1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi: (a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve; (b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve; (c) i propozon Kuvendit kandidatët për prokuror të përgjithshëm, sipas ligjit; (ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre; (d) propozon dhe administron buxhetin e tij; (dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë; (e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj. 2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

¹¹²Shihni nenin 147/d të Kushtetutës ku thuhet shprehimisht se: “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë”.

¹¹³Parashtruar në sqarimet shtesë datë 16.5.2022.

proces, nuk kanë cenuar ndonjë element të drejtësisë që mund të cenojë besimin e publikut te drejtësia dhe te aftësia e saj për të dhënë drejtësi në të ardhmen.

Subjekti ka referuar jurisprudencën¹¹⁴ e vendeve të tjera, ku sipas saj nuk gjendet i bazuar jo vetëm shkarkimi i gjyqtarit, por as pezullimi i tij bazuar në shkelje të tilla etike duke cituar nga rastet: “... është i paligjshëm pezullimi i gjyqtarit nga detyra për shkak të drejtimit të mjetit në gjendje të dehur. Në këtë rast, gjykata mban në konsideratë qëndrimin e gjyqtarit në raport me sjelljen e tij, pendesën e tij, si dhe aftësitë e tij profesionale. Ndër të tjera, kjo gjykatë ka konkluduar se preferenca e gjyqtarit ndaj alkoolit nuk ka ndikuar në përmbushjen e detyrave të tij gjyqësore. Gjithashtu, kjo gjykatë shprehet se qëllimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit për shkelje të tillë etike nuk është ndëshkimi apo turpërimi i tij i mëtejshëm, madje nuk është i përshtatshëm pezullimi nga detyra e gjyqtarit në një kohë që kualifikimet e tij nuk janë vënë kurrë në dyshim, ka përmbushur me përkushtim të gjitha detyrat e tij gjyqësore dhe që pushteti gjyqësor nuk ka luksin ta humbasë atë as për dy muaj pezullim nga detyra”.

Subjekti ka kërkuar që Komisioni të mos marrë në shqyrtim këtë fakt, pasi, së pari, nuk ka kompetencë ligjore dhe, së dyti, do të cenonte të drejtën për një proces të rregullt ligjor gjatë procedurës administrative disiplinore ndaj saj, për arsyet e sqaruara më lart në mënyrë të detajuar.

Subjekti ka shtrirë shpjegimet e saj edhe mbi vendimin e formës së prerë nr. ***, datë 17.1.2022, të KLGJ-së “Për pranimin e përfundimit të hetimit disiplinor me marrëveshjen e përbashkët të pranimit, dakordësuar midis ILD-së dhe magistrates”, ku sipas marrëveshjes është dakordësuar pezullimi i subjektit nga detyra për një afat 6-mujor me të drejtë page minimale.

Subjekti është shprehur se në rastin e saj KLGJ-ja ka vlerësuar se: “Veprimet/mosveprimet dhe sjelljet e magistrates janë vlerësuar si shkelje shumë e rëndë disiplinore, vlerësuar në raport të drejtë me natyrën e shkeljes disiplinore, shkallën e fajësisë, përvojën dhe pozicionin e magistrates në sistem, si dhe shkallën e dëmtimit të imazhit apo pasojave të ardhura ose që mund të vinin nga veprimet ose mosveprimet konkrete të magistrates. Ndaj magistrates duhet të caktohet masa disiplinore e pezullimit nga detyra për një periudhë prej 6 muaj me të drejtë page minimale sepse rrethanat e kryerjes së saj nuk e bëjnë magistraten të papërshtatshme ose të padenjë për të vijuar ushtrimin e funksionit, por rëndësia e shkeljes së kryer dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të magistratit kërkojnë që magistratja të pezullohet për një kohë të caktuar. Këshilli vlerëson se ky vendim do të konsiderohet si një vendim i formës së prerë i procedimit disiplinor dhe ndaj tij nuk mund të ushtrohet ankimi”. Subjekti vijon se Këshilli ka vlerësuar se shkelja nuk e bën të papërshtatshme ose të padenjë për të vijuar ushtrimin e funksionit dhe se masa e rënë dakord midis saj dhe ILD-së është masa e përshtatshme, si dhe nuk është e përshtatshme një masë më e rëndë.

Subjekti ka prezantuar një panoramë se si e trajton KLGJ-ja besimin e publikut te drejtësia dhe si e garanton atë në raport me veprimet e magistratëve, duke referuar disa raste të gjyqtarëve për të cilët është shprehur me vendimmarrje pa cenuar vazhdimësinë e ushtrimit të detyrës, duke theksuar se vendimi i arsyetuar i KLGJ-së, në asnjë rresht të tij, nuk citon që ajo të ketë cenuar besimin e publikut te drejtësia, përkundrazi (shprehet ajo), ka cituar që është e denjë për të vazhduar detyrën.

¹¹⁴Gjykata e Lartë e New Jersey p.sh. në çështjen *Colleston*, 599 A.2d 49 *A Study of State Judicial Discipline Sanctions* 1275 (New Jersey 1992, *dissenting opinion*), ku është vendosur pezullimi i gjyqtarit pasi ka shkelur etikën gjyqësore duke drejtuar mjetin në gjendje të dehur, shkelje kjo e kryer për herë të dytë prej tij, çështjen *Judicial Council v. Becker*, 834 P.2d 290 (Idaho 1992) në rastin e një gjyqtari që ka drejtuar mjetin në gjendje të dehur shprehet se: “Gjykata vlerëson se rekomandimi i Këshillit për largimin e tij nga detyra për këtë shkelje etike do të pengonte pushtetin gjyqësor të kishte në rrethin e tij një gjyqtar të kualifikuar... ne jemi të bindur se shkelja disiplinore e gjyqtarit që ka cenuar integritetin e pushtetit gjyqësor për shkak të varësisë së tij nga alkooli është një sëmundje, e cila nuk mund të kurohet por mund të trajtohet dhe të kontrollohet”.

Subjekti ka theksuar se në kushtet kur kjo çështje tashmë është shqyrtuar me vendimin përfundimtar të KLGJ-së, i cili është i formës së prerë, do të thotë se asnjë organ tjetër nuk mund të shprehet më për to.

Subjekti pretendon se nëse Komisioni për çfarëdolloj arsyeje do të bënte vlerësim të ndryshëm për të njëjtin fakt, do të cenonte rëndë parimin e “gjësë së gjykuar” dhe “parimin e sigurisë juridike” “mosdënimin dy herë” “ndarja dhe balancimi i pushteteve” si pjesë e procesit të rregullt ligjor duke i cenuar kështu të drejtat kushtetuese të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në përfundim të parashtrimeve të saj, subjekti ka kërkuar që kjo çështje të konsiderohet gjë e gjykuar për Komisionin, të mos merret një vendim kontradiktor me atë të KLGJ-së, duke minuar çdo parim kushtetues të sanksionuar në Kushtetutë, KEDNJ dhe GJEDNJ, duke shkelur haptazi të drejtat e saj kushtetuese dhe ligjore të mbrojtura nga këto të fundit, si dhe të bëhet një vlerësim objektiv bazuar në kuadrin ligjor dhe jo bazuar në vlerësime subjektive, të cilat mund të shpien deri në arbitraritet.

Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës:

- vendimin nr. ***, datë 23.12.2020, e KLGJ-së;
- vendimin datë 22.9.2021, e ILD-së për vazhdimin e hetimit disiplinor;
- vendimin nr. ***, datë 5.1.2022, të ILD-së “Për përfundimin e hetimit disiplinor me marrëveshjen e përbashkët të pranimit me magjistraten Enkeleđa Kapedani, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- faturën e riparimit të telefonit;
- vendimin nr. ***, datë 17.1.2022, të KLGJ-së;
- vendimin nr. ***, datë 13.10.2021, të KLGJ-së, për magjistratin H.S;
- raportin e ILD-së për magjistratin H.S;
- raportin e ILD-së për magjistraten P.F;
- vendimin nr. ***, datë 10.12.2020, për magjistratin M.K.

Arsyetimi ligjor në raport me shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, konstaton se subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim për të shmangur pasojat më të rënda në lidhje me procedurën disiplinore të ngritur ndaj saj, ka arritur një marrëveshje me KLGJ-në. Në kërkesën e paraqitur prej saj në datën 30.9.2021 ka pranuar autorësinë e videove, të cilat janë regjistruar në telefonin e saj, por ka deklaruar se nuk kanë pasur për qëllim të përhapen në publikun e gjerë. Subjekti ka marrë përsipër peshën e përgjegjësisë së shkeljes së etikës të kryer prej saj, duke deklaruar se nuk është e nevojshme kryerja e ndonjë hetimi të hollësishëm si ekspertimi telefonik, transkriptimi i tekstit të këngëve, verifikimi i kamerave të sigurisë, si dhe verifikimi i të dhënave profesionale. Në këtë kërkesë ajo shprehet: “Duke pranuar që në rastin konkret veprimet e mia cilësohen si shkelje e etikës”.

Nga hetimi i kryer nga ILD-ja, si dhe referuar marrëveshjes së lidhur midis subjektit dhe këtij institucioni konstatohet se:

- Nga subjekti është përdorur ambienti i zyrës së kryetarit, si dhe ambienti nga ashensori i të njëjtit kat dhe korridor, i cili lidh ashensorin me zyrat e gjyqtarëve dhe me zyrën e kryetarit, për të realizuar video të imazhit të vet personal, me lëvizje dhe sjellje provokuese, të shoqëruara në sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati.
- Në datën 17.5.2021 është publikuar një video në ambientet e gjykatës që shoqërohet me ecjen e subjektit, të natyrës sfilatë, si dhe me një lëvizje provokuese të së njëjtës natyrë, e

cila krijon perceptimin se është realizuar me qëllim për të vënë në dukje veshjen, ecjen dhe vendin ku drejtohet magjistratja, si dhe imazhin fizik të saj. Në po të njëjtën ditë rezulton të ketë video të realizuara nga subjekti me të njëjtën veshje, ndërsa bën sërish gjeste jo të përshtatshme për pozitën dhe figurën e magjistratit.

- Subjekti ka pohuar se videot janë realizuar prej saj.
- Subjekti, gjatë pyetjes së realizuar, nuk ka identifikuar personin tjetër, i cili realizon videon, duke iu përgjigjur pyetjes së inspektorëve se a mund të ishte punonjës i gjykatës me shprehje evazive “ndoshta”. Grupit të inspektorëve u është krijuar bindja se personi, i cili ka realizuar videon ishte sekretarja gjyqësore e zëvendëskryetarit të gjykatës.
- Subjekti, përveç vetes së saj, për të realizuar videot, ka përdorur edhe persona të tjerë potencialisht punonjës të administratës, duke përdorur pozitën e saj për realizimin prej tyre të videove.

Nga ILD-ja, në marrëveshjen nr. *** prot., datë 5.1.2022, të firmosur dhe të pranuar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. ***, datë 17.1.2022, është konkluduar:

Në pikën 14.18: “Sjelljet dhe veprimet e subjektit, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës por në ambientet e ushtrimit të detyrës, provohet se janë sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, duke u parashikuar si shkelje disiplinore në germën “dh”, të nenit 103/1, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Në pikën 15.6: “Përdorimi i zyrës së kryetarit nga subjekti i hetimit disiplinor, e cila është njëkohësisht edhe zyra më e lartë e institucionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan si ambient për të reklamuar veshjen, ecjen, imazhin, si dhe në përdorimin e gjesteve, fjalëve dhe lëvizjeve aspak të hijshme për një gjyqtarë e jo më për një drejtues të institucionit, ka cenuar besimin edhe të një vëzhguesi të zakonshëm të ky institucion në dhënien e drejtësisë. Referuar teorisë së dukjes, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet. Në këtë kuptim vlerësohet se ka rëndësi se çfarë veprimesh ka bërë një gjyqtar në përmbushje të detyrës së tij, por është e rëndësishme gjithashtu të vlerësohet se çfarë shoqëria mendon. Në këtë kuptim një sjellje e caktuar e gjyqtarit konsiderohet cenim i parimit të besimit të publikut te drejtësia”.

Në pikën 15.21: “Në rastin konkret për sa është analizuar më sipër është arritur në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga magjistratja Enkeleda Kapedani, të cilat përbëjnë shkelje disiplinore sipas nenit 103, paragrafi 1, germa ‘dh’ e ligjit nr. 96/2016¹¹⁵”.

Në pikën 15.22: “... për shkelje shumë të rënda disiplinore mund të jepet masa disiplinore ‘pezullim’ si masë disiplinore ose ‘shkarkim’. Të dyja këto masa mund të jepen për shkelje shumë të rënda”.

Komisioni, duke u bazuar në marrëveshjen e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit ku ndër të tjera ajo vetë ka pranuar përmbajtjen e saj dhe për rrjedhojë dhe se sjelljet e saj kanë cenuar besimin e publikut, si dhe duke marrë në konsideratë kryerjen e videove në ambientet e punës, shoqëruar këto video me lëvizje dhe sjellje provokuese dhe në sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati, konstaton gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, i cili do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj subjektit.

Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me pretendimet e subjektit për gjë të gjykuar dhe për periudhën e rivlerësimit. Për sa i përket pretendimit për gjë të gjykuar, Komisioni, në vendimmarrjen e tij në lidhje me subjektin e rivlerësimit, nuk është bazuar vetëm në çështjen

¹¹⁵Raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

e trajtuar më lart, por në vlerësimin tërësor të procedurave. Komisioni ka marrë të mirëqenë konkluzionet e ILD-së, të cilat janë pranuar nga subjekti dhe bazuar në këtë konkluzion ka konsideruar se subjekti ka cenuar besimin e publikut. Për më tepër, procesi i rivlerësimit rregullohet nga ligji nr. 84/2016 dhe është një proces i pavarur dhe që nuk lidhet me veprimtarinë e organeve të tjera, për rrjedhojë koncepti i gjësë së gjykuar nuk mund të gjejë aplikim në rastin në fjalë. Në lidhje me periudhën e rivlerësimit, Komisioni vlerëson se bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016 nuk ka asnjë dispozitë që të kufizojë procesin e rivlerësimit për sa i përket veprimeve të subjekteve, të cilat konsiderohen se kanë cenuar besimin e publikut.

b. Komisioni e shtriu hetimin administrativ edhe mbi krijimin e pasurisë/automjet me të cilin subjekti i rivlerësimit shfaqej në videot e publikuara. Në këtë drejtim, subjekti, pasi është pyetur¹¹⁶ lidhur me pronësinë apo përdorimin e këtij automjeti, ndër të tjera ka deklaruar¹¹⁷: “... makina që kam qenë duke drejtuar në disa prej videove të shfaqura është makinë tip ‘***’ në pronësi të djalit të dajës tim, shtetasit V.S. Në kohën që kam realizuar videot, makina e punës që unë kisha në përdorim tip ‘***’ ishte me defekt për të cilën disponoj dokumentacionin përkatës. Riparimi i defektit zgjati më shumë se 1 muaj e gjysmë dhe gjatë kësaj periudhe kam përdorur makinën time personale tip ‘***’. Gjatë asaj periudhe ndodhi që edhe makina ime personale pësoi një defekt me gomën, si rrjedhim përdora makinën tip ‘***’ në pronësi të djalit të dajës, por që në kohën e videove ndodhej në Shqipëri dhe e përdorte daja im. Meqenëse kisha të dyja makinat me defekt (ajo e punës dhe ajo personale) dhe meqenëse daja im qëlloi në shtëpinë e prindërve të mi ato ditë ia mora makinën për 3-4 ditë për të shkuar në punë. Ditët e publikimit të videove janë të ndryshme nga ditët e regjistrimit të tyre, pra videot janë regjistruar në muajin prill (kur makinat ishin me defekt) ndërsa publikimi i tyre ka ndodhur në muajin maj. Por ky përdorim 3-4-ditor nuk është përdorim në kuptimin e institutit të përdorimit në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Përdorimi si institut i së drejtës ka kuptimin e përdorimit të vazhdueshëm, të qëndrueshëm dhe të gjatë në kohë dhe jo përdorimin sporadik dhe rastësor, siç ka ndodhur në rastin konkret. Djali i dajës tim, shtetasi V.S ka jetuar për 10 vitet e fundit në ***, Itali, dhe pas pyetësorit të nisur prej jush kam kërkuar informacion prej tij në lidhje me pronësinë e makinës. Ai më ka vënë në dispozicion disa dokumente, të cilat provojnë se ai e ka blerë atë automjet më 2.9.2019, në Itali dhe e ka përdorur atje pa ndërprerje. Ky automjet është përdorur gjatë gjithë kohës në Itali që nga koha e blerjes së tij nga blerësi V.S. Sipas informacionit të marrë prej tij nga viti 2019 deri në vitin 2021, ky automjet ka ardhur vetëm dy herë në Shqipëri”.

Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës:

- dokumentacionin e blerjes së automjetit (praktikën në tërësi);
- dokumentacionin që provon se automjeti i punës ishte me defekt;
- dy certifikata të trungut familjar, lëshuar nga Njësia Administrative ***.

b/1 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar (procesverbal datë 28.3.2021, për vlerësim gjendje teknike mjeti motorik, leje qarkullimi, kërkesë nr. *** prot., datë 15.4.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për blerje pjesë këmbimi për mjetet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kërkesë nr. *** prot., datë 15.4.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për kryerjen e shpenzimeve për blerje, shërbim, mirëmbajtje mjeti transporti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan) rezultoi se automjeti në pronësi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në periudhën mars - prill 2021 ka pësuar defekt dhe se për të janë investuar riparime të ndryshme. Po ashtu, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se automjeti tip “***”, me targa *** është blerë në vitin 2019 në Itali, në shumën 14.500 euro nga shtetasi V.S. Nga verifikimi i akteve të gjendjes civile, depozituar nga subjekti i rivlerësimit, lehtësisht konfirmohet

¹¹⁶Me pyetësorin nr. 5, datë 9.9.2021.

¹¹⁷Me e-mail datë 15.9.2021.

marrëdhënia fisnore e subjektit të rivlerësimit me shtetasin V.S, ku në certifikatat e lëshuara identifikohet marrëdhënia motër e vëlla e nënës së subjektit me babain e shtetasit S.

Nga verifikimi në sistemin AMF¹¹⁸ ky automjet (nisur nga shasia, si e dhënë e pandryshueshme) rezulton me targa *** dhe ***, në pronësi të shtetasit V.S dhe përdorues shtetasi A.S (babai i tij). Nga sistemi TIMS rezultoi se shtetasi A.S ka hyrë në Shqipëri nga porti i Vlorës, me automjetin me targa ***, në datën 17.1.2021 dhe se nuk rezulton të ketë dalje të këtij automjeti nga territori shqiptar.

b/2 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion justifikues lidhur me ndryshimin e targave të këtij automjeti.

Subjekti, në lidhje me këtë çështje ndër të tjera, ka përjashtuar të drejtën e pronësisë apo të përdorimit me këtë automjet duke parashtruar edhe një herë sqarimet mbi pronësinë e automjetit, përdorimin sporadik të tij për arsyet e lartpërmendura, lidhjen gjinore me pronarin e automjetit, burimin për blerjen e kësaj pasurie e cila ka pasur bazë një kredi bankare të marrë nga daja i saj me bashkëshorten e tij te institucioni financiar “****” sh.p.k., në Shqipëri, më 26.8.2019 në shumën 1.200.000 lekë, kredi e cila është marrë në datën 26.8.2019 nga daja i saj, shtetasi a.s, dhe këtë shumë ai e ka nisur dorazi në Itali. Pas dërgimit të shumës së parave në Itali, djali i dajës ka lidhur kontratën e shitjes për këtë automjet në datën 2.9.2019. Subjekti ka sqaruar se djali i dajës së saj, pas largimit për në Angli, i ka dhënë të drejta të plota përdorimi të automjetit në Shqipëri babait të tij, pra dajës së subjektit, nëpërmjet aktit të përfaqësimit (prokurë të lëshuar në Angli në datën 12.2.2021), i cili ka bërë zhdoganimin e automjetit me qëllim që ta përdorë atë brenda Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi. Madje edhe sot daja vazhdon të paguajë kredinë e mjetit në fjalë, para të cilat i sjell çdo muaj ose çdo dy muaj djali i tij V për shlyerjen e kredisë. Subjekti ka depozituar si prova mbështetëse:

- dokumentacionin e blerjes së automjetit (praktika në tërësi);
- kontratën e kredisë për blerjen e automjetit datë 22.8.2019;
- kopjen e dokumenteve të shtetasit V.S në Itali dhe në Angli;
- kopjen e pasaportës së shtetasit V.S, që provon datën e hyrjes së tij në Angli;
- certifikatën e vajzës së lindur në Angli;
- kopjen e transfertave për pagesat e shlyerjes së kredisë së automjetit në Shqipëri;
- grafikun e shlyerjes së kredisë;
- prokurën datë 12.2.2021 dhe përkthimi i saj.

Trupi gjykues, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar por edhe saktësimeve të bëra nga subjekti në parashtrimet e saj, i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit dhe nuk konkludon në ndonjë dyshim të arsyeshëm lidhur me këtë pasuri.

Në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar si vijon:

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur dymbëdhjetë denoncime. Për dy prej tyre nuk u konstatuan fakte e rrethana, të cilat mund të ndikonin në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit. Subjektit i kaloi barra e provës dhe/ose iu kërkuar shpjegime për denoncimet¹¹⁹ e mëposhtme.

1. Denoncim¹²⁰ i shtetasit K.K

1.1 Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit duke pretenduar disa shkelje të kësaj të fundit në gjykimin e disa çështjeve penale. Më konkretisht, ai ka renditur çështjen penale; (i) me të dënuar shtetasin SH.H, akuzuar për tentativë vrasje dhe armëmbajtje pa leje, për të cilën

¹¹⁸Referojuni fletës së printuar nga sistemi i AMF-së, administruar në dosjen e Komisionit.

¹¹⁹Në përmbajtje të të cilave thuajse secili denoncues trajton më shumë se një çështje.

¹²⁰Protokolluar në IMO me nr. *** prot., datë 15.9.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

pretendon se janë shkelur procedurat e gjykimit, është zvarritur çështja, nuk janë respektuar afatet e shtyrjeve midis seancave; (ii) me të dënuar shtetasin V.Y ku është vendosur shuarja e dënimit dhe urdhërimi i lirit të menjëhershëm të tij, për të cilën pretendon se në vendimin e dhënë nuk duhej përfshirë vendimi i njohjes së ditëve të punës në favor të të dënuarit, pasi nuk kishte marrë formë të prerë; (iii) me të pandehur E.R për të cilin është dhënë pafajësi, duke pretenduar se vendimi është dhënë në kundërshtim me provat, dy të pandehurit janë mbrojtur nga i njëjti avokat, kur dukshëm kishin konflikt interesi, pra janë shkelur procedurat e mbrojtjes sipas nenit 54 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, ai pretendon për bashkëpunim të subjektit me disa avokatë (duke bërë prezent edhe identitetin e tyre) që ushtrojnë funksionin në qytetin e Elbasanit, si dhe për shkelje të etikës.

1.2 Komisioni hetoi në lidhje me denoncimin e depozituar.

Komisioni administroi dosjet përkatëse, nga verifikimi dhe analizimi i të cilave i rezultoi si vijon:

Komisioni administroi¹²¹ praktikën penale (përcjellë nga Gjykata e Apelit Durrës), që i përket çështjes me të pandehur, shtetasin SH.H.

1.3 Nga verifikimi i provave të administruara në dosjen gjyqësore, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupit gjykues dhe ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë sipas neneve 79 dhe 22 të Kodit Penal dhe “armëmbajtje pa leje” sipas nenit 278 të Kodit Penal, duke e dënuar atë me 10 vjet burgim (duke përcaktuar si institucion të ekzekutimit të vendimit, burgun e sigurisë së lartë) sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm. Organi i akuzës, sikurse pasqyrohet në vendim, ka kërkuar deklarinim fajtor të këtij të pandehuri për kryerjen e veprës penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/ë dhe 22 të Kodit Penal dhe “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave deklarimin fajtor të këtij të pandehuri dhe në bashkim të dënimeve, dënimin e tij me 22 vjet burgim. Komisioni i ka kërkuar subjektit të qartësojë statusin ligjor aktual të kësaj çështjeje penale.

Subjekti ka sqaruar se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me ndryshimin që i pandehuri dënohet me 15 vjet burgim dhe në aplikim të gjykimit të shkurtuar ulet 1/3 e dënimit duke e dënuar atë përfundimisht me 10 vjet burgim, pra njësoj sa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Subjekti ka depozituar si prova mbështetëse:

- vendimin nr. ***, datë 9.9.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës;
- vendimet e gjobës ndaj avokatëve mbrojtës të të pandehurit;
- vërtetimin datë 25.10.2021 të Gjykatës së Lartë.

Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar dhe pas njohjes me shpjegimet e subjektit, nuk vëren shkaqe apo rrethana që ndikojnë në vlerësimin e këtij kriteri, ndaj subjektit të rivlerësimit.

b/3 Në lidhje me denoncimin për çështjen me kërkues V.Y me objekt “shuarje dënimi”, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 30.10.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. ***, datë 31.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të cilin ishte vendosur bashkimi i dënimeve të dhëna ndaj këtij të dënuari në një dënim të vetëm me 25 vjet burgim, duke u përcaktuar edhe fillimi i llogaritjes së vuajtjes së dënimit.

Gjykata e Apelit, në dispozitivin e vendimit, ka saktësuar se të dënuarit i kanë mbetur për të vuajtur edhe 3 muaj e 20 ditë nga shpallja e vendimit. Në vijim të analizimit të provave të administruara rezulton se kërkuesi ka paraqitur kërkesë në datën 2.12.2019, me objekt shuarjen

¹²¹Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2021, të Gjykatës së Lartë.

e dënimit dhe lirimin e menjëhershëm. Kërkuesi, në kërkesën e tij të shuarjes së dënimit (lirimit të menjëhershëm), citon se me një vendim tjetër datë 27.11.2019 i janë njohur ditët e punës në institucionin e vuajtjes së dënimit. Nga aktet e administruara rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin (dhënë nga subjekti i rivlerësimit me inicialet T. T.) nr.***, datë 27.11.2019, i ka njohur të dënuarit 5 muaj e 16 ditë pune të kryera të konvertuara në ditë burgimi. Në procesverbalin e seancës gjyqësore datë 27.11.2019, për kërkesën e njohjes së ditëve të punës, vërehet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka shprehur dakordësinë për pranimin e kërkesës. Megjithëkëtë, në vendimin e pranimit të shuarjes së dënimit ndaj këtij të dënuari thuhet se prokurori e ka ankimuar vendimin e njohjes së ditëve të punës (i cili daton pas vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës) dhe për këtë shkak ai nuk e ka ekzekutuar atë. Subjekti, mbi kërkesën e të dënuarit, ka vendosur të caktojë seancën e parë gjyqësore në datën 10.12.2019, brenda afatit 10-ditor dhe për këtë rezulton se janë njoftuar rregullisht palët në proces. Me vendimin nr.***, datë 27.12.2019, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës. Nga analizimi i vendimit në nivel procedural duket se janë respektuar të drejtat e palëve në proces, janë administruar provat e nevojshme dhe janë dëgjuar pretendimet e palëve sipas ligjit, pra në tërësi duket se janë respektuar elementet e procesit të rregullt ligjor.

Në kontekstin e një qartësimi më të plotë të kësaj çështjeje, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime: (i) në raport me ankimin e organit të akuzës dhe parashikimet ligjore për ekzekutimin e menjëhershëm; (ii) mbi statusin ligjor të ankimit të organit të akuzës për vendimmarrjen e njohjes së ditëve të punës; si dhe (iii) mbi statusin aktual të vendimmarrjes së shuarjes së dënimit dhe lirimit të menjëhershëm.

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Shtetasi V.Y ka pasur një dënim me burgim të përjetshëm në ngarkim të tij, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim i cili është ndryshuar më pas nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila e dënoi atë përfundimisht me 25 vjet burgim.*

Unë nuk kam liruar një të dënuar me burgim të përjetshëm, siç është trumbetuar gjerësisht në media dhe në opinionin publik, por kam liruar një të dënuar me 25 vjet burgim. Masa e dënimit që unë i kam shuar këtij shtetasi është vetëm 1 muaj e 23 ditë, e cila është një periudhë e papërfillshme në raport me dënimin prej 25 vjetësh burgim në ngarkim të tij dhe me periudhën e vuajtur të dënimit deri në atë moment më shumë se 23 vjet të vuajtura fizikisht.

*Nga procesverbali i seancës gjyqësore të vendimit nr.***, datë 27.11.2019, duket se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka qenë dakord me kërkesën e të dënuarit, pasi ai e provonte të drejtën e pretenduar, pra faktin që kishte punuar në institucion siç edhe pretendonte, por pas shpalljes së vendimit të gjykatës, prokurori e ankimon vendimin e uljes së dënimit. Për këtë shkak prokurori nuk e ekzekuton vendimin e uljes dhe nuk urdhëron lirimin e të dënuarit, të cilit i kishin mbetur vetëm 2 muaj e 23 ditë burgim deri në ditën e dhënies së vendimit të uljes datë 27.11.2019”.*

Subjekti ka referuar për të mbështetur vendimmarrjen e saj dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht nenet 417/2, 462/2 dhe nenin 11 të ligjit nr. 8331/1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Lidhur me statusin e vendimit të uljes së dënimit (konvertim nga njohja e ditëve të punës) subjekti ka qartësuar se Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.***, datë 30.7.2020, ka shqyrtuar vendimin nr.***, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me të cilin janë ulur 5 muaj e 16 ditë burgim, ka vendosur lënien në fuqi të tij.

Nëse do të pritej që të shprehej Gjykata e Apelit (është shprehur subjekti), e cila rezulton të jetë shprehur në datën 19.10.2020, pra rreth 1 vit pas dhënies së vendimit të uljes, atëherë çështja do të mbetet pa objekt, pasi i dënuari do të ishte liruar si pasojë e vuajtjes së dënimit fizik. Në këtë mënyrë do të cenohej neni 6 i KEDNJ-së, që është e drejta për një proces të

rregullt gjyqësor duke mos i dhënë mundësi kërkuarit të ketë një vendim gjyqësor efektiv dhe të zbatueshëm për kërkesat e tij. Subjekti ka depozituar si prova mbështetëse:

- vendimin nr. ***, datë 30.7.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 27.11.2019, për uljen e dënimit në masën 5 muaj e 16 ditë;
- vendimin nr. ***, datë 27.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- vërtetimin nr. *** prot., datë 21.10.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar dhe pas njohjes me shpjegimet e subjektit, nuk vëren shkaqe apo rrethana që ndikojnë në vlerësimin e këtij kriteri ndaj subjektit të rivlerësimit.

b/4 Në lidhje me çështjen me të pandehur E.R etj., i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim sipas nenit 283/2 të Kodit Penal, rezulton se çështja është gjykuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, me kryesues subjektin e rivlerësimit. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 16.7.2019, ka vendosur deklarinimin e pafajshëm të të pandehurve, ndërsa organi i akuzës në konkluzionin përfundimtar ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurve për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” në bashkëpunim, të kryer në formën e shitjes, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite ka kërkuar dënimin e shtetasit E.R me 8 vjet burgim (në arsyet e organit të akuzës për provueshmërinë e kërkesës për dënim, ndër të tjera pasqyrohet se në shumicën e aktekspertimeve të bëra ka rezultuar se në mostrat e marra është zbuluar prani e produkteve të metabolizmit të kokainës, nga metodat speciale, përgjimet etj., disa herë implikohen telefonata të disa prej dëshmitarëve të pyetur me shtetasin E.R, etj.), ndërsa nën të njëjtin kërkim për shtetasin tjetër M.K ka kërkuar dënimin e tij me 7 vjet burgim. Nga ana tjetër, mbrojtja ka kërkuar pafajësinë për të dy të pandehurit, pasi pas zhvillimit të gjykimit sipas rregullave të gjykimit të zakonshëm, pyetjes së të gjithë dëshmitarëve dhe aktekspertimeve, u provua se të pandehurit nuk e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore nuk u identifikuan të dhëna nëse ndaj vendimit ishte ushtruar ankim.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime mbi pretendimet e denoncuesit, si dhe të qartësojë statusin aktual të çështjes.

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Ky vendim është ankimuar nga organi i akuzës dhe çështja është ende në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës, për të cilën nuk ka një vendim përfundimtar. Megjithatë, deri në këtë moment mund të them me bindje se janë respektuar rregullat procedurale të gjykimit të zakonshëm, janë pyetur shumë dëshmitarë të thirrur nga pala akuzuese, janë kryer aktekspertime, janë analizuar dhe debatuar provat shkresore, janë respektuar të drejtat e palëve pjesëmarrëse në gjykim, elementët e procesit të rregullt ligjor, të cilat të gjitha së bashku kanë çuar gjykatën në vendimin e pafajësisë.*

Aktet shkresore të administruara në dosje, të vlerësuara nga gjykata, provojnë se të pandehurit M.K i është sekuestruar lëndë narkotike e llojit “kokainë” në sasinë 0.688 gram, provohet se midis të pandehurit E.R dhe personave të thirrur në cilësinë e dëshmitarëve ka pasur komunikime telefonike me zë dhe mesazhe, por në asnjë prej këtyre komunikimeve nuk provohet që ata të kenë komunikuar për shitjen apo tregtimin e ndonjë lëndë narkotike, madje provohet se disa prej dëshmitarëve të përgjuar nuk janë fare përdorues të lëndës narkotike.

Në lidhje me zvarritjen e gjykimit të pretenduar në ankim nuk qëndron, pasi së pari, çështja ka përfunduar brenda afateve ligjore, pasur parasysh edhe faktin që çështja është shqyrtuar sipas

rregullave të gjykimit të zakonshëm, janë pyetur 16 dëshmitarë, janë kryer disa aktekspertime etj.

Në lidhje me pretendimin e mbrojtjes së të dy të pandehurve nga i njëjti avokat mund të them se neni 54 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: 'Mbrojtja e disa të pandehurve mund të merret përsipër nga një mbrojtës i përbashkët, me kusht që midis të pandehurve të mos ketë papajtueshmëri interesash'. Në rastin konkret, bazuar në të gjitha aktet e dosjes penale nuk rezulton që midis të pandehurve të ketë kundërthënie, nuk ka pasur kundërthënie as në fazën e hetimit dhe as në atë të gjykimit. Gjatë gjithë hetimit dhe gjykimit të dy të pandehurit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim duke mohuar akuzën në ngarkim të tyre dhe në asnjë moment nuk i kanë ndryshuar deklaratimet e tyre deri në shpalljen e vendimit nga gjykata. As nga avokati mbrojtës nuk është bërë diferencim në lidhje me strategjinë e mbrojtjes së secilit prej tyre, duke e bërë mbrojtjen të përbashkët për të dy ata. Si rrjedhim, nuk rezulton të ketë probleme lidhur me elementin e mbrojtjes.

Nga aktet e dosjes nuk rezulton se identifikohet ndonjë element që të ngre dyshime për shkelje ligjore apo përfitime të parregullta të trupit gjykues. Çështja ndodhet ende në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Durrës. Ndodhur në këto kushte, përderisa nuk ka një vendim përfundimtar për këtë çështje, çmoj se kjo ankesë nuk mund të jetë objekt vlerësimi në kuptim të nenit E të Kushtetutës, ku ndër të tjera thuhet se: 'Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim'. Pra, kjo çështje është në proces shqyrtimi në shkallë të dytë''.

Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 21.10.2021, me të cilin provohet se çështja me të pandehur E.R është në pritje të gjykimit.

Komisioni, pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar dhe pas njohjes me shpjegimet e subjektit, nuk vëren shkaqe apo rrethana që ndikojnë në vlerësimin e këtij kriteri ndaj subjektit të rivlerësimit.

b/5 Komisioni hetoi edhe në lidhje me pretendimin e denoncuesit për ndërmjetësi në marrjen e avokatëve nga të pandehurit me qëllim që çështjet të përfundojnë në favor të tyre dhe në interes të subjektit të rivlerësimit dhe nga hetimi i kryer nuk vërejtë lidhje apo marrëdhënie të subjektit në cenim të etikës dhe integritetit të profesionit që ushtron.

b/6 Në lidhje me përfaqësimet (mbrojtësit ligjorë) selektive të palëve në procese gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, gjithashtu, e shtriu hetimin në drejtim të verifikimit të tyre në çështjet e administruara në këtë hetim administrativ, duke përfshirë në verifikim tri dokumentet ligjore të depozituara nga subjekti në kontrollin e vlerësimit profesional, pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura nga një sistem rastësor/me short, ato të administruara për shkak të denoncimeve të depozituara, si dhe ato/dosjet, të depozituara në kuadër të verifikimit të kriterit të kontrollit të figurës.

Nga verifikimet përkatëse rezultoi se në zhvillimin e 19 proceseve gjyqësore, që u përkasin çështjeve të gjykuara penale apo civile, në dy prej tyre palët përfaqësohen nga av. A.A, në një çështje palët përfaqësohen nga av. B.B dhe në një çështje nga av. A.B. Krahasuar me numrin e çështjeve të renditura, matematikisht, raporti i përfaqësimit të av. A, B dhe B me përfaqësuesit e tjerë ligjorë është i zhdrejtë, pra nuk dominohet përfaqësimi nga këta avokatë, ndërsa në konceptin ligjor dhe në ushtrimin e të drejtave të palëve në procese gjyqësore, çmohet se është e drejta e tyre të zgjedhin përfaqësuesin ligjor.

c. Gjithashtu, në vijim të disa informacioneve konfidenciale, Komisioni hetoi edhe në lidhje me udhëtime të kryera jashtë vendit me shtetasen B.B. Nga verifikimi i informacionit të përcjellë¹²² nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, lidhur me hyrje-daljet e

¹²²Shkresë nr. *** prot., datë 20.1.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

pasqyruara në sistemin TIMS, në asnjë rast të udhëtimeve të bëra nga subjekti apo edhe familjarët e saj nuk u identifikua emri i kësaj shtetaseje.

Komisioni, lidhur me pretendimin e denoncuesit për pozitën e shtetases B.B në marrëdhënie me subjektin, i ka kaluar kësaj të fundit barrën e provës për të shpjeguar dhe provuar mbi: (i) lidhjen e saj me këtë shtetase dhe rrethanat në të cilat është njohur apo njihet me të (gjithnjë nëse ekzistojnë të tilla); (ii) ekzistencën e njohjeve personale me këtë shtetase (nëse ka pasur apo ka të tilla), duke e qartësuar qëndrimin e saj; (iii) nëse është gjendur ndonjëherë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar çështje me këtë shtetase si mbrojtëse ligjore, për shkak të profesionit të lirë që kjo e fundit ushtron. Po ashtu, subjektit i është kërkuar të depozitohë çdo dokumentacion mbështetës të shpjegimeve apo argumenteve të paraqitura.

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Shtetasja B.B është avokate pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe, si e tillë, e njoh nga marrëdhënia avokat – gjyqtar, në sallën e gjykimit. Nuk kam asnjë njohje personale me këtë shtetase dhe, si rrjedhim, nuk kam qenë asnjëherë në kushtet e konfliktit të interesit me të.*

Nga denoncimi i shtetasit K.K (me të cilin nuk kam asnjë njohje dhe nuk e kam pasur as palë në gjykim) pretendohet se bëj trajtim preferencial për avokatët B.B, A.A, E.GJ dhe A.B. Ai ngre pretendime për bashkëpunimin tim me ta në dëm të palëve.

Gjatë gjithë karrierës sime kam punuar me profesionalizëm, kam trajtuar çdo palë dhe qytetar me respekt dhe dinjitet, i kam garantuar atyre të gjitha të drejtat procedurale, i kam trajtuar në mënyrë të barabartë pavarësisht nivelit të tyre kulturor, arsimor, gjendjes sociale, ekonomike etj. Nëse do të kishte pasur raste të tilla, atëherë këto raste do të ishin denoncuar nga vetë pala e dëmtuar, pra palët në gjykim pa qenë nevoja për të pritur predispozicionin e ndonjë kolegu të zellshëm”.

Subjekti ka paraqitur disa printime nga sistemi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për të treguar mbi numrin e çështjeve të ndjekura nga këta avokatë. Ka qartësuar se për njërin prej avokatëve me iniciale A. A. ka aplikuar numrin më të lartë të gjobave dhe me vlera të konsiderueshme, ku 2 prej tyre deri në vlerën 50.000 lekë të reja, gjoba të cilat janë ekzekutuar. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës:

- printimet nga sistemi për disa avokatë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- vendimin për z. E.P të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me av. E.GJ;
- vendimet e gjobës për av. A.A, ku rezultojnë se e ka dënuar tri herë në shumën 105.000 lekë dhe vendimet që i ka rrëzuar heqjen e këtyre gjobave, pas ankimit të tij duke lënë gjobën në fuqi.

Trupi gjykues konstaton se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse. Në tërësi, trupi gjykues nuk identifikon ndonjë shkelje që cenon ndonjë prej kritereve matëse të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncim¹²³ i shtetasit S.H

2.1 Komisioni nuk konstatoi problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit. Për të ezauruar të dhënat mbi statusin e çështjes, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të qartësojë ecurinë e kësaj çështjeje në gjykatat e shkallëve më të larta (gjithnjë nëse është ushtruar e drejta e ankimit nga palët ndërgjyqëse), si dhe të depozitohë edhe dokumentacionin mbështetës. Subjekti, mbi kërkimin e Komisionit, ka shpjeguar se vendimi ka marrë formë të prerë në Gjykatën e Apelit Durrës.

Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 27.1.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës.

¹²³Nr. *** prot., datë 15.9.2020.

Trupi gjykues nuk konstatoi në gjykimin e këtij rasti parregullsi të natyrës procedurale dhe as fakte apo rrethana të tjera të cilat ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncim¹²⁴ i shtetasit Q.L

3.1 Denoncuesi, në cilësinë e prindit të viktimës F.SH (L), pretendon shkelje të kryera nga trupa gjykuese në të cilën bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, më konkretisht, shprehet se bëhet korrupsion për çështjet penale. Çështja penale për të cilën ankohet i përket kërkuesit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt gjykimi sigurimin e provës për t'u pyetur dëshmitari A.G, për çështjen penale kundër të pandehurve S.S dhe A.H, të akuzuar për vrasje në datën 30.7.2020. Denoncuesi pretendon se për subjektin e rivlerësimit, duke qenë pedagogë e jashtme prej 3 vitesh dhe në vitin shkollor 2019 – 2020 në Universitetin e Elbasanit, Fakulteti Ekonomik, ku njëkohësisht është dekane I.S dhe pedagogë e brendshme I.S (S), e motra e kësaj të fundit (me të cilat subjekti ka marrëdhënie pune të përditshme), dhe që ndërkohë është edhe bashkëshorte e bashkëjetuese me të pandehurin e kësaj çështjeje S.S, ka rrethana konkrete dhe arsye serioze për njëanshmëri në procesin gjyqësor, sipas neneve 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale. Gjyqtarët, ku bën pjesë edhe subjekti, pranojnë haptazi të gjykojnë dhe të marrin dëshminë e dëshmitarit, në konflikt të hapur interesi me ligjin, pasi punojnë me kumatën e të pandehurit S.S dhe janë pedagogë bashkë me gruan e të pandehurit. Denoncuesi shprehet se këto i ka mësuar pasi ishte zhvilluar seanca e marrjes së dëshmisë.

Ai pretendon gjithashtu se seanca e marrjes së dëshmisë është gjykuar me shumë vonesë (dëshmia është marrë në datën 25.9.2020) dhe jo në kohën e duhur që parashikon (për sigurimin e provës) Kodi i Procedurës Penale. Në këto kushte, pretendon se gjykata nuk ka marrë masat e nevojshme që seanca të bëhej në kohën e duhur dhe brenda afatit.

3.2 Komisioni administroi dosjen gjyqësore nr. *** akti, datë 4.8.2020, me kërkues Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt “sigurim prove i dëshmisë së shtetasit A.G”.

3.2.i Nga aktet e administruara u konstatua se në datën 4.8.2020 prokuroria i ka dërguar kërkesën për sigurimin e provës për akte të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve nën hetim S.S dhe A.H, për veprën penale të parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të Kodit Penal, me viktimë F.Q.SH (L).

Me vendimin datë 7.8.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me një tjetër subjekt rivlerësimi, ka vendosur: *Pranimin e kërkesës për sigurimin e provës, marrjen paraprakisht të dëshmisë së dëshmitarit, shtetasit A.G; caktimin e datës 17.8.2020, si datë zhvillimi të seancës gjyqësore për marrjen e dëshmisë, si dhe pasqyrimin e trupës gjykuese (nuk identifikohet subjekti i rivlerësimit në këtë trupë) që do të marrë dëshminë, sipas urdhrin nr. ***, datë 2.7.2020, të kryetarit të gjykatës.*

Në dosje është administruar njoftimi i datës 13.8.2020, babait të viktimës, si dhe konfirmimi i marrjes dijeni për seancën për marrjen e dëshmisë. Po ashtu është administruar edhe marrja dijeni e dëshmitarit për seancën gjyqësore.

Seanca e datës 17.8.2020 (e zhvilluar nga një tjetër subjekt rivlerësimi) për marrjen e dëshmisë është shtyrë për në datën 8.9.2020, për të cilën ka qenë dakord edhe i ati i viktimës (denoncuesi).

Në dosje është administruar vendimi me nr. *** akti, datë 16.7.2020, i dhënë nga subjekti i rivlerësimit për caktimin e seancës gjyqësore datë 14.9.2020, me objekt dhe dispozitiv “për zgjatjen e afateve hetimore”, kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në këtë vendim duket se nuk përpunohet dispozitivi me bazueshmërinë ligjore të përdorur për marrjen e

¹²⁴ Ardhur me e-mail në datën 28.9.2020.

tij (neni 244¹²⁵ i Kodit të Procedurës Penale). Është e paqartë se si është përfshirë subjekti i rivlerësimit në këtë proces, duke pasur parasysh se vendimi i saj daton më 16.7.2020, ndërsa në fakt seancat gjyqësore në këtë muaj, por edhe më tej në muajt pasardhës, janë zhvilluar nga të tjerë subjekte, sikurse ajo e datës 17.8.2020 (gjyqtare Z. V) e cila është shtyrë për marrjen e dëshmisë në datën 8.9.2020 (kjo e fundit e zhvilluar nga gjyqtar Z. SH). Njoftimet e subjektit të rivlerësimit datë 10.9.2020, për seancën e datës 14.9.2020, cilësojnë si objekt “sigurimin e provës për marrje dëshmie”. Duket se nuk përputhet objekti i shtyrjes së seancës për datën 14.9.2020, për zgjatjen e afateve hetimore (cilësuar kështu edhe në dispozitivin e vendimit), me objektin e njoftimit të palëve “për marrjen e dëshmisë/sigurim prove”.”.

3.2.ii Më tej rezulton se janë shtyrë seancat për në datat 17.9.2020 dhe 22.9.2020 (në këtë rast p.sh., për mosformim të trupës gjyqësore) dhe datë 25.9.2020.

3.2.iii Përgjithësisht konstatohet se seancat janë shtyrë për arsye të motivuara.

3.2.iv Rezultoi se në datën 25.9.2020 subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar seancën dhe në përfundim të saj ka marrë dëshminë e dëshmitarit, e ka fiksuar atë në procesverbal ..., etj.

3.3 Në vijim, duke qëndruar tek pretendimi i denoncuesit se subjekti i rivlerësimit ka qenë në konflikt interesi në marrjen e dëshmisë për shkak se i merrej një personi për llogari të të pandehurit i cili ishte bashkëshort i koleges së saj në fakultetin ku jepte mësim si pedagoge e jashtme, legjislacioni i kohës (Kodi i Procedurës Penale), ndër të tjera, parashikon shprehimisht:

“Neni 17

Heqja dorë (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: ... ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie. 2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili e miraton ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar...”

Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”¹²⁶, një zyrtar në ushtrimin e funksioneve të tij, me qëllim për të garantuar një vendimmarrje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, duhet të parandalojë konfliktin midis interesave publike dhe interesave private.

Për sa më sipër, subjekti duhet të qartësojë pozitën e saj në këtë proces gjyqësor në raport me dispozitat ligjore të lartpërmendura.

¹²⁵Neni 244, Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit (shtuar pika 3 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; shtuar fjali në pikën I me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) 1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar. 2. Edhe kur gjykata deklaron moskompetencën e vet për çdo lloj shkak, në qoftë se janë kushtet dhe ekziston urgjenca për marrjen e masës ajo vendos marrjen e saj dhe i dërgon aktet gjykatës kompetente. 3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori.

¹²⁶Ky ligj, në nenin 3 të tij, pika 4, parashikon llojet e ndryshme të shfaqjes së konfliktit të interesit, si vijon: “a)... ; b) ‘konflikt në dukje i interesit’ është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisë të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë; c) ‘konflikt i mundshëm i interesit’ është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara; ç) ‘konflikt rast për rast i interesit’ është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë; d) ‘konflikt i vazhdueshëm i interesit’ është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen”. Ndërsa në nenin 5 të tij, përcaktohen shprehimisht interesat privatë, konkretisht: “Interesat private të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni”.

Komisioni, nën pretendimet e denoncuesit, por edhe për sa konstatohet në tërësi, ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime, si dhe të depozitojë dokumentacion mbështetës mbi shpjegimet e dhëna.

Subjekti, mbi pretendimet e denoncuesit dhe kërkimin e Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi në gjykimin e çështjes, në rastin konkret bazuar në urdhrin nr. *** prot., datë 1.11.2019, unë jam shpallur fituese për pozicionin e pedagoges së jashtme në muajin nëntor 2019, duke u zgjedhur fituese për lëndën ‘E drejta penale e posaçme’, lëndë e cila do të zhvillohej gjatë semestrit të dytë në muajt mars-korrik 2020. Në përfundim të vitit akademik në muajin korrik 2020 marrëdhënia ime e punës me Universitetin ‘Aleksandër Xhuvani’ përfundon, duke qenë se është punë me kohë të pjesshme e lidhur për një semestër të caktuar. Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 24.9.2021, rezulton se: ‘Për vitin akademik 2019 - 2020 marrëdhënia e punës me znj. Kapedani ka filluar në datën 1.11.2019 dhe ka përfunduar me përfundimin e procesit të mësimdhënies së lëndës/modulit’.*

Pra, theksoj se deri në muajin shtator 2020 (vendimi mban datën 25.9.2020) unë jo vetëm që nuk isha pjesë e stafit si pedagoge e jashtme, por as nuk kisha aplikuar për të aspiruar një pozicion të tillë.

Pra, duket qartë që në muajin shtator 2020 kur kam marrë vendimin për sigurimin e provës për çështjen me të pandehur S.S, nuk kam qenë pjesë e stafit akademik të Universitetit ‘Aleksandër Xhuvani’, Elbasan dhe as kisha aplikuar ende për të qenë pjesë e tij.

Këta shtetas nuk kanë lidhje gjaku të drejtpërdrejtë dhe as mbajnë të njëjtin mbiemër që të lindte dyshime tek unë, qoftë një indicie për lidhjen e tyre.

Konflikti i interesit interpretohet në harmoni me nenin 17/ë të Kodit të Procedurës Penale, ku ndikimi që mund të ketë njohja e tyre shkakton arsye serioze njëanshmëri, gjë që nuk provohet në rastin konkret.

Kam respektuar me përpikëri rregullat procedurale për zhvillimin e seancës gjyqësore që nga afatet deri tek procedura e ndjekur për marrjen e dëshmisë”.

Subjekti ka referuar vendimet e Gjykatës së Lartë¹²⁷ dhe, ndër të tjera, ka cituar pjesë nga vendimi: *“...kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues është një mjet garancie për palët për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe se ky mjet ligjor nuk duhet të keqpërdoret duke u shndërruar në një kërkesë abuzive (kur nuk shoqërohet me shkaqe dhe prova), pasi kjo dëmton sistemin e drejtësisë dhe zvarrit në mënyrë të pajustificuar proceset gjyqësore”.*

Sipas subjektit, provohet që ajo nuk ka qenë në marrëdhënie pune me Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në kohën e dhënies së vendimit dhe nuk ka asnjë indicie e aq më pak bazueshmëri për një konflikt të tillë interesi. Palë në gjykim nuk ka qenë dekania I.S me të cilën supozohet që ka njohje, por ka qenë një familjar (jo lidhje gjaku) i saj për të cilin nuk kam pasur dijeni për lidhjen e tyre familjare dhe as ishte e detyruar të kishte dijeni, parashtron subjekti. Edhe nëse do ishte në dijeni të lidhjes së tyre familjare, kurrsesi nuk përbën shkak për të hequr dorë nga gjykimi, pasi nuk jemi para asnjërit prej rasteve të parashikuara në nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka parashtruar se *nuk ka pasur asnjë marrëdhënie varësie me dekanen I.S në kohën e gjykimit, si dhe nuk ka dijeni për lidhjen familjare midis të pandehurit dhe dekanes. Në seancën e sigurimit të provës nuk disponohet me vendim nga trupi gjykues, por vetëm administrohet procesverbali i seancës dhe i vihet në dispozicion organit procedues. Rezulton se janë garantuar të drejtat e të gjitha palëve*

¹²⁷Nr. ***, datë 22.6.2021 dhe nr. ***, datë 18.5.2021.

pjesëmarrëse në proces. Nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e subjektit nga gjykimi i çështjes. Nuk janë konstatuar elemente që të vinin në dyshim paanësinë e saj.

Subjekti ka qartësuar edhe mbi afatin e gjykimit, duke sqaruar se fillimisht në këtë çështje kanë qenë të tjerë subjekte rivlerësimi, ndërsa thekson se në shtyrjen e seancave në afate tepër të shkurtra prej saj ka pasur arsye ligjore si mosformim të trupit gjykues apo shtyrje për mosprezencë të avokatëve mbrojtës.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për marrjen e dosjes pa short, subjekti ka parashtruar se është një akuzë e pabazuar. Dosjet shorthen nga shorti elektronik ose shorti manual të cilët në asnjë rast nuk menaxhohen prej saj, duke depozituar kopje të shortit manual, nga i cili rezulton se në datën 8.9.2020 është hedhur shorti në prani të gjyqtarëve të seksionit penal të gjykatës dhe janë përzgjedhur gjyqtarët Enkeleda Kapedani si kryesuese dhe T.T e M.K si anëtarë.

Subjekti ka depozituar si prova mbështetëse:

- vërtetimin nr. *** prot., datë 24.9.2021;
- informacionin nr. *** prot., datë 22.9.2021;
- shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.9.2021;
- urdhër punësimi nr. ***, datë 1.11.2019;
- urdhër punësimi nr.***, datë 25.11.2020;
- vendimin e nr. ***, datë 15.6.2021, të zëvendës kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës, i cili rrëzon dorëheqjen e gjyqtares M. F.;
- aktin e shortit manual;
- deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.1.2022, të shtetasit Q.L.

Trupi gjykues konstaton se subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të denoncuesit, sipas së cilës deklaron se nuk ka e ka bërë ai denoncimin. Ky veprim i subjektit, në vlerësim të trupit gjykues, nuk përputhet me etikën e magjistratit, pasi së pari nuk mund të ketë kontakt me ndonjë person që ka gjykuar dhe, së dyti, nuk mund të kontaktojë persona të cilët kanë paraqitur një denoncim pranë organeve të rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin e subjektit në seancë, se këto persona janë kontaktuar nga avokati, mbetet në nivel deklarativ, pasi në asnjë nga deklaratat noteriale nuk citohet ky fakt.

4. Denoncim¹²⁸ i shtetasit M.P

4.1 Denoncuesi ankohet për disa shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit në disa vendime të dhëna prej saj.

Paraprakisht, nga të dhënat e vendimeve, konstatohet se denoncuesi nuk rezulton të ketë lidhje apo të jetë i prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga këto vendimmarrje.

Komisioni administroi dosjet gjyqësore që i përkasin vendimeve për të cilët ankohet denoncuesi.

4.2 Dosja gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 11.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt caktim i masës së sigurimit “arrest me burg me afat”, për të pandehurit E.L dhe A.R, me detyrë funksionale pedagog, akuzuar për veprat penale “korrupsion” dhe “ushtrim të ndikimit të paligjshëm në provimet e studentëve”.

Denoncuesi, për këtë çështje gjyqësore, informon se pa u ndryshuar asnjë lloj rrethane, pa u zbutur kushtet, kriteret dhe nevojat e sigurimit (caktuar dhe konstatuar me vendimin nr. ***, datë 11.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan), gjyqtarja Enkeleda Kapedani në këtë çështje penale vendosi (në kundërshtim me nenet 228, 229, 245 e 260 të Kodit të Procedurës

¹²⁸Me e-mail-in datë 9.10.2020.

Penale), me vendimin e datës 29.6.2018, zëvendësimin e masës së sigurimit për pedagogen E.L, në “detyrim paraqitje” dhe në datën 11.6.2018 për pedagogun A.R.

Nga aktet e dosjes rezulton se çështja penale me objekt “marrjen në pyetje të shtetasve P.K, A.R, E.L, A.K, M.Ç, A.N, E.Ç”, me masë sigurimi “arrest në burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, është regjistruar në datën 10.5.2018 dhe ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 11.5.2018, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim të procesit, përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar rikonfirmimin e masës së sigurimit “arrest në burg” (dhënë me vendimin nr. ***, datë 8.5.2018), për të gjithë personat nën hetim të dyshuar për kryerjen e veprës penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1/2 i Kodit Penal.

Gjykata, me vendimin e saj administrativ - penal, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës. Ndër të tjera, ka miratuar kërkesën e organit të akuzës për vazhdimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin A.R, ndërsa ka ndryshuar masën për shtetasen E.L në “arrest në burg me afat 60 ditë”.

Mbi ankimin e përfaqësuesit të organit të akuzës për personat e tjerë nën hetim për të cilët gjykata e shkallës së parë kishte vendosur zëvendësimin e masës nga “arrest në burg” me “arrest në shtëpi”, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 29.5.2018, ka vendosur miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për personin nën hetim E.L dhe ndryshimin për disa prej personave të tjerë nën hetim (ku nuk identifikohet A.R), duke i lehtësuar masën e sigurimit në “detyrim paraqitje”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 29.6.2018, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me objekt “revokim masë sigurimi”, mbi kërkesën e personit nën hetim E.L, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e masës “arrest me afat” me “detyrim paraqitje”. Në dosje është administruar akti i IML-së (ekspertimi psikiatrik i kërkuar nga personi nën hetim dhe e lënë detyrë për t’u realizuar nga organi procedues) lidhur me probleme shëndetësore e mendore të personit nën hetim. Në këtë kërkim organi i akuzës ka qenë dakord me zëvendësimin e masës, por me atë “arrest në shtëpi”. Gjykata ka arsyetuar mbi përmbushjen e nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale, nën aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, duke arsyetuar se mbeten dyshime të arsyeshme që shtetasja E.L ka kryer veprën penale, por gjendja e saj shëndetësore bën që masa e sigurimit të mos i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, pasi sipas ekspertëve qëndrimi i saj në paraburgim mund të sjellë pasoja të rënda dhe të pariparueshme për jetën dhe shëndetin e saj. Në ligjin e zbatueshëm gjykata ka cilësuar edhe vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2021, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të qartësojë statusin e vendimmarrjes lidhur me zëvendësimin e masës “arrest me afat” me “detyrim paraqitje në Policinë Gjyqësore” dhe në vijim, të qartësojë nëse është ushtruar ankim apo më tej edhe rekurs, si dhe të depozitojë vendimmarrjet përkatëse (gjithnjë nëse rezultojnë të tilla).

Subjekti i rivlerësimit, mbi kërkimin e Komisionit, ndër të tjera, ka sqaruar se organi akuzës nuk ka pasur pretendime rreth vendimit të gjykatës. Kjo provohet edhe nga fakti që ky vendim nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datën 4.7.2018.

Në vijim ndaj kësaj shtetaseje çështja ka shkuar për gjykim në themel dhe organi i prokurorisë, në përfundim të hetimeve, ka kërkuar pushimin e çështjes në ngarkim të saj, pikërisht për faktin se nuk kishte kryer vepra penale për të cilën dyshohej. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 27.12.2019, ka vendosur pushimin e çështjes për këtë shtetase.

Subjekti ka depozituar:

- vendimin nr. ***, datë 27.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për pushimin e akuzës për personin nën hetim E.L;
- vendimi nr. ***, datë 29.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me shënimin që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe provave të depozituara, konstaton se nuk identifikohen problematika që të mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

4.3 Në çështjen e zëvendësimit të masës së arrestit me një masë më të butë të personit nën hetim A.R, vërehet se, në ndryshim nga arsytimi që subjekti ka bërë në vendimin nr. ***, datë 11.5.2018, ku edhe ka vendosur vazhdimësinë e arrestit në burg ndaj këtij shtetasi, duke e quajtur vendimmarrjen të bazuar në prova e ligj, vendim i cili duket mjaft i argumentuar dhe thelluar lidhur me rrezikshmërinë shoqërore që paraqet ky person, shmangien që mund t'i bëjë hetimit, mohimit të mbajtur në seancën e verifikimit të masës, pozitën e mbajtur prej tij si dekan, shembullin e dhënë në drejtim të favorizimit të studentëve apo edhe të një pedagogeje të jashtme, rezultuar përmes përgjimeve, etj., ndërsa me vendimin nr. ***, datë 11.6.2018, ka vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me “detyrim për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Në arsyetim, ndër të tjera, cilësohet se është përmbushur kërkimi i nenit 260/2 i Kodit të Procedurës Penale, për shkak se gjendja shëndetësore (është rënduar) dhe profesionale (duke qenë se ka lënë disa projekte të profesionit të tij të papërfunduara) bëjnë që masa e sigurimit nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet.

Në këtë çështje, përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për zëvendësim të masës së sigurimit.

Më tej, mbi ankimin e ushtruar, edhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 3.7.2018, ka lënë në fuqi zëvendësimin e masës së sigurimit.

Çështja është rekursuar nga përfaqësuesi i organit të akuzës. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton i paplotë vendimi gjyqësor nr. ***, datë 27.12.2018, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Për sa më sipër lidhur me këtë çështje, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime duke u përqendruar te dy vendimmarrjet, përkatësisht në vendimet nr. *** dhe nr. ***, si dhe të depozitojë vendimin e plotë nr. ***, datë 27.12.2018, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Në kohën e dhënies së vendimit unë si gjyqtare jam bazuar edhe në historikun e personalitetit të personit në hetim, faktin që kishte arsim të lartë, i padënuar më parë, fakti që ai ishte pezulluar nga fakulteti me vendim të Rektoratit, e cila nuk përbënte asnjë rrezik që ai të ndikonte tek marrja ose vërtetësia e ndonjë prove dhe as rrezikonte të kryente të njëjtën vepër penale ose më të rëndë. Këto fakte nuk ekzistonin të provuara në seancën e caktimit të masës së sigurimit, si rrjedhim, nuk janë marrë në shqyrtim. Ndërsa lidhur me statusin e çështjes, ka qartësuar se edhe nga Gjykata e Lartë është vendosur mospranimi i rekursit.*

*Edhe lidhur me themelin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 27.12.2019, ka vendosur pushimin e çështjes për këtë shtetas.*

Për sa kohë kam respektuar gjithë dispozitat materiale dhe procedurale për çështjen në gjykim, kam dhënë një vendim të bazuar në ligj, por edhe në një analizë të hollësishme të provave, duke i bërë një vlerësim në harmoni edhe me bindjen e brendshme, vlerësoj se në mënyrë kategorike nuk ka vend për dyshime për abuzim me detyrën”.

Subjekti ka depozituar si prova mbështetëse:

- vendimin nr. ***, datë 27.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për këtë shtetas;
- vendimin nr. ***, datë 27.12.2018, të Gjykatës së Lartë.

Trupi gjykues konstaton se subjekti ka dhënë shpjegime bindëse. Në tërësi, trupi gjykues nuk identifikon ndonjë shkelje që cenon ndonjë prej kriterëve matës të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

4.4 Në lidhje me dosjen penale nr. *** akti, me numër elektronik ***, regjistruar për gjykim në vitin 2018, me të pandehur B.K për akuzën “pastrim i produkteve të veprës penale”, denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur gjykimin, seancat nuk i ka filluar në orar dhe se gjatë komunikimit me palët ndërhyr në mënyrë jo profesionale.

4.4.i Komisioni administroi dosjen e gjyqësore të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan që i përket vendimit nr. ***, datë 22.2.2018 (konstatohet se dosja nuk mban të njëjtin numër akti, sikurse citohet në denoncim).

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore pasqyrohet procedura e ndjekur për kërkesën e përfaqësuesit të organit të akuzës për dërgimin në gjyq për disa të akuzuar, ku përfshihet edhe shtetasi B.K, për veprën penale “pastrim të produkteve të veprës penale”. Rezulton se çështja është gjykuar e përfunduar nga një tjetër subjekt rivlerësimi.

5. Denoncim¹²⁹ i shtetasve B.M dhe K.B

5.1 Denoncuesit ankohen se subjekti i rivlerësimit ka marrë para nga shtetasi T.S (kontigjent krimi) nga Peqini për të liruar nga arresti me burg me një masë më të butë trafikantin e drogës në Elbasan M.B, nën argumentet se gjoja ky shtetas ka fëmijë të sëmurë dhe babain, duke i vdekur me qëllim për ta liruar nga burgu. Gjithashtu, njëri prej denoncuesve ka cituar se policia nuk vepron për shkak të lidhjeve që subjekti ka me përfaqësues të këtij institucioni. Paraprakisht u konstatua se denoncuesit nuk identifikojnë ndonjë lidhje të drejtëpërdrejtë në këtë çështje, apo të jenë prekur a cenuar në këto vendimmarrje.

5.2 Komisioni administroi¹³⁰ dosjen gjyqësore nr. *** akti, datë 19.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të pandehur M.B, gjykuar nën akuzën e vleftësimit të masës së arrestit.

5.3 Nga aktet e administruara në dosjen objekt gjykimi rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarës së vetme, me vendimin nr. ***, datë 19.12.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë; vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë të personit nën hetim M.B, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal; caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg” për personin nën hetim M.B. Pas ankimit të ushtruar ndaj vendimit, rezulton se Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 5.1.2021, ka miratuar vendimin e shkallës së parë.

5.4 Në vijim, Komisioni ka administruar¹³¹ dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 16.3.2021, me objekt “zëvendësim mase sigurimi”.

5.5 Nga aktet e administruara rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 16.3.2021, ndër të tjera, ka arsyetuar edhe kushtet dhe rrethanat e reja të pashqyrtuara më parë në vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg”. Në vendim është argumentuar mbi gjendjen familjare dhe ekonomike të të pandehurit, gjendjen shëndetësore të prindërve të cilët kanë nevojë për përkujdesje, gjendjen psikologjike të vajzës së të pandehurit e cila rezulton të marrë seanca këshillimi nga psikologjia e shkollës, gjendjen shëndetësore të të pandehurit, diagnozën e konkluduar ndaj tij sipas QSUT-së¹³², faktin se ai është përdorues dhe në vartësi të rëndë nga drogat, sugjerimet e mjekut për të mos qëndruar në ambiente të mbyllura por të përfshihet në terapi grupi nëpërmjet programeve afatgjata psiko-sociale në qendra

¹²⁹I ardhur me *e-mail* në datën 28.1.2021 dhe në datën 16.3.2021.

¹³⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 8.4.2020.

¹³¹Referuar shkresës nr. *** prot., datë 15.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

¹³²Reflektuar në vlerësimin klinik për këtë shtetas, dokument që mban datën 22.1.2021.

rehabilitimi, etj. Nga verifikimi i këtyre akteve, mbi të cilët është argumentuar, rezultoi se disa prej tyre janë lëshuar pas vendosjes së masës së sigurimit personal “arrest me burg”, apo edhe pas kërkesës së organit të akuzës (datë 17.12.2020)¹³³ drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për caktimin e masës së “arrest me burg”. Po nga aktet rezultoi se pas masës së sigurimit personal “arrest me burg” është regjistruar procedimi penal ndaj këtij shtetasi dhe se për të kanë nisur procedurat hetimore. Ndër të tjera, në arsyetimin e vendimit të subjektit për ndryshimin e masës së sigurimit, citohet se nga organi i prokurorisë në njoftimin e akuzës është cituar se nuk u provua bashkëpunimi dhe se në vendimmarrje është mbajtur në vëmendje edhe sugjerimi i Ministrisë së Drejtësisë për përdorimin e masave të tjera të sigurimit nga ajo e arrestit me burg për shkak të situatës së pandemisë COVID-19. Përkundër këtij vendimi dhe arsyetimi mbi ankimin e paraqitur nga organi i akuzës, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 20.4.2001, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (dhënë nga subjekti)... Rrëzimin e kërkesës së shtetasit B për ndryshimin e masës së sigurimit... Në këtë vendim, ndër të tjera, citohet se: “(a) rrethanat familjare dhe fakti që i arrestuari ka qenë përdorues i lëndës narkotike, rezulton i njohur nga gjykata e shkallës së parë që në vendosjen e masës së sigurimit personal ‘arrest me burg’; si dhe fakti që (b) çështja është regjistruar dhe për të ka një çështje penale gati për gjykim, pasi në fillimin e muajit mars 2021 janë mbyllur hetimit dhe është kërkuar dërgimi i çështjes në gjyq”.*

Komisioni ka ftuar subjektin të japë shpjegime më të detajuara në raport me argumentet e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, siç përshkruhet më sipër në germat (a) dhe (b), si dhe të qartësojë mbi vijimësinë e këtij procesi, në kontekstin e gjykimit të themelit të procedimit penal të regjistruar ndaj këtij shtetasi.

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar: *“Lidhur me çështjen me të pandehur M.B rezulton që nga ana ime është caktuar fillimisht masë sigurimi ‘arrest në burg’ brenda një afati të shkurtër dhe të shpejtë prej 48 orësh. Në këtë seancë nuk është paraqitur dhe as është marrë në shqyrtim asnjë provë e palës mbrojtëse, përveç kërkesës dhe provave të paraqitura nga organi prokurorisë dhe janë ngritur disa pretendimeve me gojë nga pala mbrojtëse. Në vijim, në datën 25.1.2021, nga ana e personit nën hetim është paraqitur kërkesë me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit nga ‘arrest me burg’ në një masë më të lehtë sigurimi. Kërkuesi ka paraqitur disa prova¹³⁴ mbi të cilat pretendon se nevojat e sigurimit janë zbutur dhe se duhet të bëhet zëvendësimi i saj.*

Provat i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe nga ana e prokurorisë nuk pati asnjë pretendim lidhur me vërtetësinë, autenticitetin apo përmbajtjen e tyre. I vetmi argument i dhënë nga

¹³³Administruar në dosjen gjyqësore penale që i përket vendimit nr. ***, datë 19.12.2020, të masës së “arrest me burg”.

¹³⁴Vërtetim nr. *** prot., datë 16.12.2019, i Bashkisë Elbasan, Njësia Administrative Nr.***, ku rezultoi se shtetasi M.B ka sjellje të mirë në komunitet dhe jeton në një familje prej 8 anëtarësh; një karakteristikë e lëshuar nga kjo Njësia Administrative e cila provon faktin se familja B vuan nga probleme sociale dhe ekonomike; certifikatë familjare që provon faktin se familja B përbëhet nga 8 anëtarë; vërtetim i lëshuar nga Njësia Administrative Nr. ***, që provon se vëllezërit e tij jetojnë jashtë shtetit në Itali; vërtetim nr. *** prot., datë 30.12.2020, lëshuar nga Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Arsimit, i cili provon faktin se vajza e mitur M.B ndjek çerdhen publike nr. *** në Elbasan; vërtetim datë 18.12.2020 dhe datë 30.12.2020, lëshuar nga shkolla 12-vjeçare jopublike “****”, i cila provon faktin se vajza tjetër e mitur M.B ndjek klasën e tretë në këtë shkollë dhe se ndaj saj ndiqen seanca këshillimi për shkak të një aksidenti të ndodhur më parë; vërtetime nga qendrat shëndetësore për të dy prindërit e M, shtetasi V dhe N.B, ku provohen problemet shëndetësore që ata kanë, si dhe faktin që askush tjetër nuk mund të kujdeset për ta; vlerësim klinik për personin nën hetim M.B, lëshuar nga QSUT-ja, i cili konkludon se diagnoza mjekësore është “Vartësi e rëndë nga lëndë drogë cocaine dhe lëndë drogë heroinë. Situacion craving. Të fillojë farmakoterapinë me antagonist duke e këshilluar lidhur me efektet e kundërta të përdorimit të preparatit, të zgjidhet preparati në bashkëpunim me shtetasin M.B dhe familjarët e tij”. Rekomandime mjekësore: “Shtetasi M.B zhvillon situacionin ‘craving’ për lëndën drogë cocaine dhe lëndën drogë heroinë dhe është mirë të tregohet kujdes sepse ka nevojë për mbështetje ose këshillim psiko-social sepse mund të ndjejë nevojën për konsumim të lëndës drogë cocaine duke bërë relaps në përdorimin abuzues... tërheqja në një mjedis me një mbikëqyrje profesionale me ose pa mjekim është më i udhës me rrethanat e lartpërmendura për shkak të çrregullimeve psiko-emocionale këshillohet të mos qëndrojnë në ambiente të mbyllura, duhet të përfshihet në terapi grupi nëpërmjet programeve afatgjata psiko-sociale në Qendra Rehabilitimi. Rekomandohet që vlerësimet psiko-sociale të ndiqen në mënyrë periodike çdo 3 javë nga psikolog klinik gërshetuar me terapi farmakologjike”; rekomandim i dhënë nga mjeku toksikolog klinik pranë QSUT-së që duke qenë se vuan nga çrregullime psiko-emocionale këshillohet të mos qëndrojnë në ambiente të mbyllura, të përfshihet në terapi grupi çdo tre javë.

organi akuzës është rrezikshmëria shoqërore e autorit dhe e veprës penale, bazuar kryesisht në dyshimet që ai mund ta kishte kryer veprën në bashkëpunim me persona të tjerë për të cilët po priteshin përgjigjet e akteve të ekspertimit teknik të telefonit të tij celular nga ku mund të dilnin bashkëpunëtorët. Pas kalimit të çështjes në konkluzione përfundimtare, organi procedues në seancën e ardhshme ka kërkuar të riçelet hetimi gjyqësor, pasi gjatë asaj periudhe kishte mbërritur në prokurori akti i ekspertimit teknik të telefonit celular, rezultatet e të cilit ishin në kundërshtim me dyshimin e prokurorisë, pasi në analizë të tij nuk rezultonte që personi nën hetim ta kishte kryer veprën penale në bashkëpunim me persona të tjerë.

Vendimi që bëri zëvendësimin e masës së sigurimit 1 muaj më pas u ndryshua nga gjykata e apelit e cila e riktheu në burg personin nën hetim, por në asnjë rresht të këtij vendimi nuk jepet ndonjë argument nëse gjykata e shkallës së parë kishte gabuar, nëse po, cilin ligj procedural apo material kishte shkelur gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e apelit ka krijuar një bindje tjetër vetëm lidhur me faktin nëse janë zbutur apo jo nevojat e sigurimit dhe nuk ka bërë asnjë analizë të provave të marra në shqyrtim nga unë si gjyqtare e shkallës së parë.

Në asnjë rresht të vendimit të gjykatës së apelit nuk janë marrë në shqyrtim provat lidhur me kushtet personale dhe familjare të personit nën hetim. Nuk është shqyrtuar vlera dhe fuqia e tyre provuese dhe as ndikimi që ato mund të kenë për të zëvendësuar masën e sigurimit.

Në vijim ndaj këtij shtetasi, çështja ka shkuar për gjykim në themel dhe një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka zgjidhur çështjen në themel duke e deklaruar fajtor të pandehurin dhe duke caktuar ndaj tij dënimin përfundimtar prej 5 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe prej 5 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale. Nga pjesa përshkruese - arsyetuese e vendimit të themelit rezulton se gjyqtari i themelit, bazuar në provat që ishin marrë në shqyrtim në seancën e zëvendësimit të masës së sigurimit, ka vlerësuar se ai nuk duhet të vazhdojë vuajtjen e dënimit në formën e tij klasike në burgim, siç edhe kishte kërkuar organi prokurorisë, por duhet të pezullohet dënimi i tij dhe ai të qëndronte në liri për shkaqe shëndetësore dhe familjare.

Pra, duket se shkaqet shëndetësore dhe familjare të analizuara në seancën e zëvendësimit të masës së sigurimit qëndronin dhe kanë qenë të bazuara në nivel të tillë që atij një ditë i sollën lirinë në mënyrë definitive.

Gjithashtu, në denoncim pretendohet se M.B është i skeduar për trafik narkotikësh, ndërkohë që nga gjithë provat e administruara në dosje rezulton i pandënuar më parë. Pretendohet se atij i është sekuestruar një sasi e madhe lëndësh narkotike, ndërkohë që i është sekuestruar vetëm 140 gram lëndë narkotike”.

Subjekti, në cilësinë e provave mbështetëse, ka depozituar:

- vendimin nr. ***, datë 22.7.2021, të dënimit në themel të të pandehurit M.B, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- vendimin nr. ***, datë 19.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;
- procesverbalin e seancës gjyqësore datë 19.12.2020, për caktimin e masës së sigurimit;
- shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2021, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për procedimin penal të DSIK-së.

Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse në lidhje me ndryshimin e masës së sigurimit, por veprimet e saj në këtë rast nuk mund të përbëjnë shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit ndaj subjektit.

6. Denoncim¹³⁵ i shtetasit B.K

6.1 Denoncuesi, në ankimin e tij, pretendon për vendimmarrje të padrejta dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe për bashkëpunim të kësaj të fundit me avokaten B.B, e cila, sipas tij, ndikon në proceset gjyqësore. Denoncuesi adreson si problematikë vendimin e datës 30.4.2020, dhënë gjatë kohës së karantinimit total në fillim të pandemisë, mbi pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2013, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për të pandehurit M.L, ose i njohur ndryshe S.Ç, dhe E.Ç të cilët në atë kohë ishin në kërkim, pasi gjykata kishte vendosur masën e arrestit me burg ndaj tyre. Denoncuesi ankohet: (i) se përse ky vendim u dha pikërisht në kohën e karantinimit total për shkak të pandemisë; si dhe (ii) për lidhjet dhe bashkëpunimin e treguar mes subjektit dhe avokates B, megjithëse për këto pretendime nuk ka paraqitur apo dhënë *indicie* provueshmërie. Gjithashtu, denoncuesi ankohet për çështjen penale me të dënuar shtetasin SH.H.

Paraprakisht, Komisioni ka konstatuar se, sa i takon pretendimit të denoncuesit për lidhje dhe bashkëpunim të subjektit në funksion të detyrës së saj me avokaten B.B, nuk janë paraqitur prova, çështje për të cilën është arsyetuar më sipër në këtë vendimmarrje.

Gjithashtu, Komisioni ka trajtuar edhe çështjen penale me të dënuar SH.H (denoncuar më parë nga shtetasi K.K), për të cilën, pasi ka administruar aktet gjyqësore, ka kryer verifikimet përkatëse, i ka kërkuar subjektit shpjegime në dërgimin e rezultateve të hetimit, çështje kjo e trajtuar më sipër në këtë vendimmarrje.

Komisioni ka hetuar në lidhje me pretendimin e këtij denoncuesi për vendimmarrjen e dhënë nga subjekti (gjatë kohës së karantinimit të plotë) në çështjen penale me të dyshuar M.L dhe E.Ç, që lidhet me procedimin penal nr. *** të vitit 2013, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe për këtë administroi kopje të praktikës gjyqësore¹³⁶ lidhur me vijimësinë e kësaj çështjeje edhe në Gjykatën e Lartë, ku është ankuar një tjetër denoncues¹³⁷ i cili pretendon për zbatim të gabuar të ligjit nga subjekti në vendimmarrjen e saj, fakt ky (shprehet denoncuesi) i konstatuar nga kjo gjykatë. Denoncuesi ka depozituar vendimin nr. ***, datë 8.3.2022, të Gjykatës së Lartë. Në verifikimin tërësor të çështjes rezultoi si vijon:

i) Çështja penale është vënë në lëvizje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkesë “për dërgimin e çështjes në gjykim”, ndaj të pandehurve M.L dhe E.Ç, të akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 110/2 dhe 278 të Kodit Penal.

ii) Fillimisht kjo çështje është marrë për gjykim nga një tjetër subjekt rivlerësimi, i cili, bazuar në nenin 17/2 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar me kërkesën datë 11.3.2020, “për heqje dorë nga gjykimi”, zëvendësimin e tij, pasi më parë kishte vendosur revokimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, datë 16.12.2013, dhe rifillimin e procedimit.

iii) Mbi këtë argumentim zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin e datës 2.4.2020, ka pranuar kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjes penale nr. *** akti, datë 14.2.2020, dhe kalimin e çështjes për short.

iv) Ndryshimi i gjyqtarit të çështjes, konkretisht zëvendësimi i gjykimit të saj, me subjektin e rivlerësimit është bërë me shortin elektronik të datës 2.4.2020, ora 9:40:03.

v) Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 30.4.2020, për këtë çështje me objekt “dërgimin e çështjes (për gjykim) penale nr. *** të vitit 2013, në ngarkim të të pandehurit L, akuzuar për veprën penale ‘mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit’, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal (sipas ligjit të kohës) dhe ‘heqje e paligjshme të lirisë’ e kryer në bashkëpunim,

¹³⁵Nr. *** prot., datë 17.11.2021.

¹³⁶Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

¹³⁷Shtetasi T.B ka depozituar denoncimin e tij në mënyrë elektronike në datën 3.5.2022.

parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal ...”, ka vendosur *pushimin e çështjes dhe shuarjen e masës së sigurimit ‘arrest me burg’ për të pandehurin M.L.*, dhënë me vendimin nr. ***, datë 11.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

vi) Më tej, mbi ankimin e organit të akuzës, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 23.9.2020, ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

vii) Në analizë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pa zëvendësuar logjikën e subjektit në arsyetimin e tij, vërehet se prokuroria ka kërkuar dërgimin në gjyq të kësaj çështjeje penale, ndërsa të pandehurit, mbrojtur me avokatët përkatës, si dhe viktimia dhe mbrojtësi i këtij të fundit, kanë kërkuar pushimin e çështjes. Në arsyetim thuhet se viktimia K i qëlluar në këmbë pas një konflikti të ndodhur në automjet, ka dhënë deklarime kontradiktore, pra një herë ka identifikuar autorin e ngjarjes, konkretisht shtetasit L dhe Ç, ndërsa i pyetur më pas ka mohuar t’i ketë njohur ata. Në këto kushte është bërë ndarja e procedimit penal duke vijuar me procedimin nr. *** në ngarkim të shtetasit B.K, akuzuar për veprën penale “deklarim të rremë përpara prokurorit” dhe në procedimin penal nr. *** të vitit 2013, për veprat penale të parashikuara nga nenet 89-25 dhe 278/2 të Kodit Penal. Pas ndarjes, procedimi penal në ngarkim të shtetasit K ka kaluar për gjykim, ndërsa procedimi tjetër nr. *** është pezulluar në vitin 2014 për moszbulim të autorëve dhe ka kaluar për hetime të mëtejshme në Komisariatin e Policisë Elbasan, ndërsa në datën 26.12.2013 është pushuar (nga subjekte të tjera rivlerësimi) procedimi penal për akuzat në ngarkim të personit nën hetim M.L, pasi nuk provohej që veprat penale ishin kryer prej tij, vendim ky i formës së prerë, i pa ankimuar. Në korrik të vitit 2018 është dërguar një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (Njësia Speciale Task-Forcë) në lidhje me rifillimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore organi i akuzës ka kërkuar në gjykatë revokimin e vendimit të pushimit, datë 23.12.2013, në ngarkim të shtetasit M.L, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e gjykatës nr. ***, datë 14.12.2018, duke u vendosur vazhdimi i hetimeve. Sa i përket veprës penale “plagosje e lehtë me dashje” të shtetasit B.K, është bërë pushimi i pjesshëm i çështjes, pasi vepra është parashkruar bazuar në nenin 66 të Kodit Penal, duke qenë se kishin kaluar mbi 5 vjet nga dita e ngjarjes. Më tej, thuhet në vendimin e subjektit, nga prokuroria është urdhëruar regjistrimi i veprave penale “korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim dhe “korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, pasi gjatë përgjimeve të kryera ka rezultuar se shtetasi K, së bashku me të tjerë dhe me persona që ushtrojnë funksione publike pranë institucionit të AMA-s, favorizoheshin dhe favorizonin kundrejt pagesave të ndryshme në para, me qëllim transmetimin e paligjshëm të sinjalit televiziv dhe se ky procedim penal është ndarë edhe në procedimin penal nr. ***, për sa u përket këtyre veprave penale, me qëllim shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Subjekti ka arsyetuar se organi i akuzës në çështjen L i është referuar thujtave të njëjtave prova që ka pasur në kohën e pushimit të procedimit në ngarkim të këtij shtetasi, vendim i cili ka ezauruar akuzat e ngritura, si dhe ka pasqyruar faktin se shtetasi K, i dënuar më parë për deklarim të rremë, edhe në rifillimin e hetimeve, por edhe seancën gjyqësore të dërgimit të çështjes në gjyq, ka pohuar se i qëndron deklarimeve se nuk është i pandehuri L që i ka gjuajtur me armë dhe as E.Ç që drejtonte makinën. Subjekti ka arsyetuar disa vendime unifikuese, vendime të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ-së, etj., lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar” dhe “parimin e sigurisë juridike” apo lidhur me faktin se kush përbën provë për rishikimin e vendimit (vetëm ato prova të dala apo zbuluara pas vendimit të formë së prerë), nën arsyetimin se është hetuar mbi të njëjtat prova duke i riadministruar ato. Subjekti ka pasqyruar në vendim edhe faktin se organi procedues që në pushimin e vendimit në 2013 ka arritur në konkluzion se vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë nuk është konsumuar, ndërsa në këtë rifillim të hetimeve dhe dërgim të kërkesës për gjykim ka konkluduar se kjo vepër është kryer nga të dy shtetasit në bashkëpunim. Në këto argumente

ligjore dhe shumë të tjera të pasqyruar gjerësisht në vendim, është arritur në pushimin e çështjes nga subjekti, si gjyqtar i seancës paraprake.

Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës, duke u përqendruar në pretendimin e denoncuesit lidhur me gjykimin dhe përfundimin e gjykimit në kohën e karantinimit total për shkak të COVID-19.

Subjekti, në parashtrimet e saj, fillimisht ka pretenduar se shtetasi K ka qenë viktimë në çështjen penale, por ka mohuar që dy të pandehurit të jenë autorët e ngjarjes kundër tij dhe për pasojë nuk mund të ishte denoncuesi i këtij denoncimi. Për të provuar këtë fakt subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të këtij shtetasi, ku mohon të jetë autori i këtij denoncimi.

Më tej, subjekti ka parashtruar se shqyrtimi i kësaj/këtyre çështje/ve gjatë karantinimit është rregulluar nga akti normativ nr. 9, datë 25.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19” i cili në nenin 3 të tij parashikon se:

“1. Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha gjykatave, shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

2. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve, si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë”.

Rregullat sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen në këto raste: “...e) Në çdo çështje tjetër penale kur i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgimin, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit”.

Në rastin konkret, ndaj të pandehurit M.L ishte caktuar masë sigurimi “arrest me burg” në mungesë, e cila nuk ishte zbatuar, ndërsa i pandehuri E.Ç ishte me masë sigurimi “arrest me burg”, pra ishte në paraburgim. Kjo provohet nga fakti që ai ka lëshuar deklaratë noteriale përfaqësimi për avokaten e tij nga IEVP Elbasan dhe avokatja e tij me shkrim ka kërkuar vazhdimin e gjykimit, duke qenë kështu në përputhje me kriteret e kërkuara nga neni 3, germa “e” e aktit normativ të sipërcituar. Pra, plotësohen dy kushtet e kërkuara nga akti normativ për zhvillimin e gjykimit, që janë: (i) i pandehuri është në paraburgim; dhe (ii) nga ana e avokates së zgjedhur prej tij është bërë kërkesë me shkrim për vazhdimin e gjykimit. Duke qenë se të dy të pandehurit akuzohen për një vepër penale të kryer në bashkëpunim, rrjedhimisht do të vazhdonte gjykimi për të dy, pasi çështja nuk mund të ndahej. Pra, ndryshe nga ajo që pretendohet në denoncim, subjekti ka vepruar tërësisht në përputhje me aktin normativ nr. ***, të kryeministrit. Subjekti ka depozituar:

- deklaratën e lëshuar nga i pandehuri i paraburgosur E.Ç nga IEVP Elbasan;
- kërkesën me shkrim të bërë nga avokatja e tij për vazhdimin e gjykimit;
- vendimin nr. ***, datë 30.4.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka vendosur pushimin e çështjes për këtë procedim penal;
- vendimin nr. ***, datë 23.9.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, e cila ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e ankimuar;
- vendimin e pushimit datë 26.12.2013, ku është vendosur pushimi i ndjekjes penale në lidhje me shtetasin M.L a S.C për këtë fakt penal.
- aktin normativ nr. 9, datë 25.3.2020.

Në vijim për këtë çështje, mbi denoncimin e radhës lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar: “Ndër të tjera, në vendimin e arsyetuar thuhet se

Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, e cila ka lënë në fuqi vendimin tim dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit Durrës. Në mënyrë të përmbledhur, në këtë vendim citohet se gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të bëjë vlerësim të provave dhe të vendosë pushimin e çështjes bazuar në këtë vlerësim edhe nëse rezultoni se çështja është gjë e gjykuar. Sipas këtij vendimi, gjyqtari i seancës paraprake ka një rol tërësisht pasiv i cili vetëm verifikon nëse hetimet janë të plota, nëse duhet të kryhen veprime të tjera hetimore, nëse provat janë të pavlefshme apo të papërdorshme. Gjithashtu, arsyetimi vijon duke cituar se gjyqtari i seancës paraprake mund të bëjë pushimin e çështjes vetëm nëse konstatohet se fakti penal nuk ekziston ose nëse vepra penale nuk ekziston”.

Sipas subjektit, ajo nuk pajtohet me këtë arsyetim të Gjykatës së Lartë, bazuar në nenet 332/dh dhe 328/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi vendimi i kësaj gjykate vjen në kundërshtim të hapur me përmbajtjen e këtyre dy neneve. Neni 332/dh i Kodit të Procedurës Penale nën titullin “Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake”, parashikon: “1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës; b) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit; c) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi; ç) pushimin e akuzës ose të çështjes kur janë rastet e paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi”. Neni 328, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale nën titullin “Pushimi i akuzës ose çështjes”, parashikon: “1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimi nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj”.

Sipas nenit 332/dh, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se rastet kur gjyqtari i seancës paraprake vendos pushimin e çështjes janë rastet e parashikuara nga paragrafi i parë i nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, raste të cilat janë cituar më lart nga subjekti dhe janë 9 të tilla.

Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë shpreh se të vetmet raste kur gjyqtari i seancës paraprake mund të vendosë pushimin e çështjes janë mungesa e faktit penal ose mungesa e veprës penale që janë germat “a” dhe “b” të paragrafit të parë, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, duke i hequr kështu gjyqtarit të seancës paraprake kompetencat nga germa “c” deri në germën “f” të këtij neni, kompetenca të cilat ia ka njohur neni 332/dh, germa “ç” e Kodit.

Subjekti ka argumentuar se rastet kur gjyqtari i seancës paraprake mund të vendosë pushimin e akuzës ose të çështjes është rasti kur çështja është zgjidhur një herë me vendim të formës së prerë, pra, kur jemi para gjësë së gjykuar sipas nenit 328/1, germa “e” e tij. Shkaqet pse lindi figura e gjyqtarit të seancës paraprake ishin për të krijuar një filtër selektiv në mënyrë që jo çdo çështje të kalonte për shqyrtim në themel për të krijuar cilësi, shpejtësi në gjykim, si dhe ekonomi gjyqësore. Për këtë arsye, ligji i ka njohur të drejtën ta pushojë çështjen nëse konstatohet secilin nga rastet e nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe jo vetëm dy rastet e para të tij. Gjyqtari i seancës paraprake ka detyrimin ta pushojë çështjen nëse konstatohet se është gjë e gjykuar, sipas germës “e”, të nenit 328/1 të Kodit, pasi kështu i ndërpret rrugën fillimit të një kalvari gjykimi të padrejtë dhe të pabazuar në ligj, bën ekonomi gjyqësore dhe jep drejtësi në kohë. Madje, ky është qëllimi për të cilin u krijua kjo figurë e posaçme e gjyqtarit, figurë e cila nuk ka thjesht një rol formal, siç pretendohet në këtë vendim të Gjykatës së Lartë, por ka disa

kompetenca ligjore të detyrueshme për zbatim, kompetenca të cilat ia ka njohur vetë ligjvënësi. Gjykata mund të bëjë interpretimin e një norme ligjore, por nuk mund të ndryshojë dhe as të kufizojë përmbajtjen e saj, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret nga Gjykata e Lartë, pasi kompetencën për pushimin e çështjes në rastet e gjësë se gjykuar gjyqtarit të seancës paraprake ia ka dhënë Kodi i Procedurës Penale, neni 332/dh, germa “ç” e tij, kompetencë e cila nuk mund të hiqet apo kufizohet as me një vendim gjyqësor të Gjykatës së Lartë dhe të asnjë gjykate tjetër.

Sipas nenit 328/1, germa “dh” e Kodit, Gjykata e Lartë e njeh si një nga rastet kur gjyqtari i seancës paraprake mund ta pushojë çështjen dhe në fakt edhe kjo pikë e këtij neni është përdorur prej subjektit në arsyetimin e vendimit të pushimit, dhe më konkretisht, në germën “dh” del se *i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai*, argument ky i përdorur prej subjektit për pushimin e çështjes.

Sipas subjektit, që një gjyqtar të arrijë në konkluzionin se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet ta ketë kryer ai, do të thotë që duhet të analizohen provat në harmoni me njëra-tjetrën dhe në përfundim të analizës së tyre të konkludohet nëse i pandehuri e ka kryer veprën “përtej dyshimit të arsyeshëm” apo jo. Nëse po, çështja kalon për gjykim, dhe nëse jo, çështja pushohet.

Duket se vendimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor, pasi nga njëra anë thotë se gjyqtari i seancës paraprake mund ta pushojë çështjen nëse del që i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet ta ketë kryer ai, por nga ana tjetër thotë që gjyqtari i seancës paraprake nuk mund të analizojë parimin “përtej dyshimit të arsyeshëm”. *Lind pyetja: Si mundet gjyqtari i seancës paraprake të konkludojë se nuk është kryer vepra penale nga i pandehuri apo se nuk provohet ta ketë kryer pa analizuar provueshmërinë e akuzës “përtej dyshimit të arsyeshëm” si i vetmi parim që ndan faktin nëse i pandehuri do mbajë apo jo përgjegjësi penale? Subjekti shprehet se: “Në mënyrë që gjyqtari i seancës paraprake të arrijë në konkluzionin se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai, duhet të bëj një vlerësim tërësor të provave përndryshe nuk mund të arrij në një konkluzion të tillë nga një vlerësim prima facia të tyre siç pretendon Gjykata e Lartë. Gjykata e Lartë thotë në vendimin e saj se gjyqtari seancës paraprake nuk analizon provat por verifikon a janë hetimet e plota. Por në fakt sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë gjyqtari i seancës paraprake ka disa kompetenca si: vlerësimi i vlefshmërisë, pavlefshmërisë apo papërdorshmërisë së akteve të procedurale dhe konstatimi i tyre si të pavlefshme apo të papërdorshme; verifikimi i plotësisë së hetimeve dhe kthimi i dosjes në rast mosplotësie të tyre ka të drejtë të bëj ndryshimin apo shtimin e akuzës, ka të drejtë të ndryshojë kualifikimin juridik të veprës penale, ka të drejtë të pushojë çështjen në secilin prej 9 rasteve të nenit 328 paragrafi 1 i Kodit. Kurrë asnjëherë në praktikën gjyqësore të të gjitha gjykatave të vendit, por as edhe në trajnimet e ndryshme ku unë kam marrë pjesë, nuk është shtruar ndonjëherë për diskutim ky qëndrim i Gjykatës së Lartë. Nuk ka pasur asnjëherë qëndrime të ndryshme apo të kundërta në praktikën gjyqësore lidhur me këtë kompetencë të gjyqtarit të seancës paraprake”.*

Subjekti pretendon se në çdo vendim të dhënë prej saj, por edhe nga çdo gjyqtar i Republikës së Shqipërisë në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake, bëhet analiza e të gjitha provave dhe faktit penal të pretenduar nga organi akuzës, si dhe analizohet dhe u jepet përgjigje gjithë pretendimeve të palës mbrojtëse.

Subjekti ka depozituar disa vendime të saj me objekt “dërgim çështje në gjyq”, për të cilët shprehet se në secilin prej tyre ka analizuar ekzistencën e veprës penale dhe pas analizës ka vendosur kalimin në gjyq ose pushimin e akuzës/çështjes.

Gjithashtu, ajo ka pretenduar se kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake janë aq të gjëra sa ai mund të përcaktojë edhe akuzën. Për këtë ka depozituar disa vendime gjyqësore të dhënë prej saj, por edhe të kolegëve, për të cilët shpjegon se është vendosur pushimi i çështjes si

gjqtar i seancës paraprake, sipas rasteve të parashikuara nga neni 328/1 të Kodit, në rastet kur: janë gjë e gjykuar; nuk provohet fajësia; nuk mund të dënohet; është parashkuar etj. subjekti shprehet se: *“Edhe nga këto vendime rezulton se gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur pushimin e çështjes pas analizimit të hollësishëm e të detajuar të provave, pas vlerësimit të tyre në harmoni me njëra-tjetrën, ku në secilin prej tyre është analizuar provueshmëria e veprës penale përtej dyshimit të arsyeshëm. Në dijeni time gjithë trupa gjyqësore e gjykatës ku unë kam ushtruar profesionin por edhe gjithë trupa gjyqësore e Republikës së Shqipërisë nuk ka pasur ndonjë dilemë apo paqartësi lidhur me zbatimin në praktikë të dispozitave procedurale penale ku përcaktohen kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake”*.

Subjekti ka sqaruar se Gjykata e Lartë nuk mund të marrë një rol aktiv dhe të zëvendësojë gjykatat e zakonshme në ushtrimin e kompetencës së tyre për interpretimin e dispozitës ligjore, duke bërë keqinterpretim të tekstit të dispozitës së zbatueshme për zgjidhjen e çështjeve konkrete kur dispozita as nuk lë vend për keqinterpretime. Pra, në rast se dispozita është e qartë dhe ka një interpretim dhe zbatim të unifikuar të saj nga të gjitha gjykatat e zakonshme, as që ka vend për një interpretim të kundërt të saj nga një gjykatë më e lartë dhe sidomos kur kjo gjykatë bën interpretim të cinguar të dispozitës. Subjekti pretendon se ky vendim i Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim të hapur me dispozitat procedurale penale dhe me vendimmarrjet e të gjithë gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë.

Ajo deklaron mosdijeninë e saj që në praktikë për këto raste të ketë pasur ndonjë problematikë lidhur me zbatimin e këtij neni, duke u shprehur gjithashtu se nëse do të qëndronte ky vendim i Gjykatës së Lartë do të duhet të prishen me mijëra vendime dhënë nga gjithë trupat gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.

Subjekti pretendon se si gjyqtare e seancës paraprake nuk ka kryer asnjë shkelje ligjore dhe asnjë shkelje procedurale, por ka respektuar të drejtat dhe detyrimet që i ngarkon neni 332/dh, germa “ç”, në referencë të nenit 328, pika 1, e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Subjekti ka zgjeruar argumentet e saj lidhur me rastin konkret të gjykuar nga Gjykata e Lartë, duke parashtruar një analizë juridike të neneve 332/dh/ç dhe 328/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Trupi gjykues konstaton se subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të denoncuesit, sipas së cilës deklaron se nuk ka e ka bërë ai denoncimin. Ky veprim i subjektit në vlerësim të trupës gjykuese nuk përputhet me etikën e magjistratit, pasi, së pari, ajo nuk mund të ketë kontakt me person që ka gjykuar dhe, së dyti, nuk mund të kontaktojë persona të cilët kanë paraqitur një denoncim pranë organeve të rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin e subjektit në seancë se këto persona janë kontaktuar nga avokati, mbetet në nivel deklarativ, pasi në asnjë nga deklaratat noteriale nuk citohet ky fakt.

Në lidhje me procedurën konstatohet se subjekti ka kryer veprime në tejkalim të kompetencave të saj, të cilat janë konfirmuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila nuk gjykon çështjen në themel¹³⁸.

Komisioni do të vlerësojë këto konstatime në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.

7. Denoncim¹³⁹ i shtetas A.XH

¹³⁸Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe: (a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; (b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; (c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹³⁹Nr.*** prot., datë 18.11.2021.

7.1 Denoncuesja ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë (për çështje të vitit 2017) në caktimin e masës së sigurimit personal dhe më tej ndryshimit të saj për dy ish-administratorët e shoqërisë “****”, nën pretendimin se kjo ka ndodhur nga ndikimi i avokatit mbrojtës të të akuzuarve. Gjithashtu ankohet për vendimmarrjen e dhënë ndaj shtetasit I.K (çështje penale e vitit 2020) me të cilën ka hequr sekuestron pasurore vënë ndaj këtij shtetasi në vitin 2017 për krim të organizuar dhe trafikim lëndësh narkotike, dënuar me 10 vjet burgim.

a. Komisioni administroi¹⁴⁰ dosjet gjyqësore në ngarkim të shtetasve K.Z (administrator i shoqërisë “****” dhe Y.A (drejtor i skrapit).

b. Ndër të tjera, vërehet se themeli i çështjes i referohet tregtimit të skrapit, pra blerjes së tij në disa shoqëri, nga shoqëria “****”, që sipas organit të akuzës shoqëritë shitëse nuk kanë ushtruar në aktivitetin e punës së tyre shitblerjen e skrapit dhe në këtë kontekst faturat e shoqërisë “****” për këtë blerje kanë qenë fiktive, me qëllim ligjërimit të shumave të shlyera përmes bankës në favor të shitësve. Në kontekstin procedural vërehet se ndaj administratorit dhe drejtorit të shoqërisë është nisur me masat e sigurimit personal, kërkimet për zëvendësimin e tyre, etj. Kryesisht të dyshuarit janë përfaqësuar nga av. TH.S. Për të qëndruar në rolin dhe punën e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, nën pretendimet e denoncuesit, nga analizimi i akteve të administruara në dosjet gjyqësore, rezultoi si vijon:

i) Subjekti i rivlerësimit, mbi kërkesën e organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” kundër personit nën hetim K.Z, dyshuar për kryerjen e veprave penale “mashttrim”, kryer në bashkëpunim, dhe “pastrim të produkteve të veprës penale”, me vendimin e saj nr. ***, datë 19.7.2017, ka vendosur sipas kërkesës së organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2017, duke u vendosur si masë e sigurimit personal ndaj këtij të dyshuari: *“Ndalimi i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...”*. Vendimi i apelit është rekursuar edhe gjykata e lartë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 2.11.2017, ka vendosur *mospranimin e rekursit*.

ii) Subjekti i rivlerësimit, mbi kërkesën e shtetasit K.Z për zëvendësim të masës së sigurimit nga “ndalim i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, me vendimin e saj nr. ***, datë 23.12.2017, ka vendosur *rrëzimin e kësaj kërkesë*. Nga leximi i vendimit vërehet se organi i akuzës, në procesverbalin e datës 23.12.2017, ka shprehur mosdakordësinë e zëvendësimit të masës, duke qartësuar se: *“Nuk jemi përpara asnjë kushti për zëvendësim, nuk ka ndryshuar asnjë nga kushtet, nuk u provua dhe nuk u paraqit asnjë provë nga pala kërkuese që duhet të udhëtojë për shkak të detyrës për lidhjen e kontratave me të huaj që pretendohet, duke qenë se nuk ka ndryshuar asnjë kërkesë nga neni 260 i Kodit të Procedurës Penale ...”*.

iii) Më tej, përsëri mbi kërkesën e personit nën hetim K.Z, subjekti i rivlerësimit, në gjykimin e zëvendësimit të masës së sigurimit personal, pasi ka arsyetuar kushtet dhe rrethanat e reja sipas nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat mundësojnë zëvendësimin e masës (si depozitimi i një kontrate individuale punësimi e lidhur me një tjetër shoqëri, vërtetimi i shoqërisë punëdhënëse se detyrat e specifikuara për t’u kryer dhe përmbushur prej tij kërkojnë udhëtime jashtë vendit, si dhe dokumentacioni që pasqyrore qenien e tij si anëtar në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë “****” sh.a.), me vendimin nr. ***, datë 20.1.2018, ka vendosur *pranimin e kërkesës*.

iv) Duket se në këtë rast organi i akuzës (i përfaqësuar nga e njëjta prokurore) nuk ka adresuar kontestim procedural se çështja duhej të gjykohej nga gjyqtari i seancës paraprake, përveçse referuar procesverbalit të seancës gjyqësore (shihni faqen 224 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 27.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe parashtrimet

¹⁴⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 6.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

datë 20.1.2018, me numërtim 244 e vijim), ku vërehet se ka kërkuar rrëzimin e kërkesës.

Në parashtrimet e saj në datën 20.1.2018, përfaqësuesi i organit të akuzës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke theksuar, ndër të tjera, faktin e avancimit të ndryshimit të pozitës procedurale të kërkesës nga “person nën hetim” në “të pandehur” dhe dërgimin në datën 10.1.2018 në gjykatë të “kërkesës për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. ***”.

Nga aktet e administruara në dosje rezulton se shtetasi Z, në datën 16.1.2018, pra pas depozitimit të kërkesës për gjykim, ka depozituar kërkesën për zëvendësimin e masës, kërkesë për të cilën subjekti ka kryer veprime procedurale në datë 17.1.2018, duke caktuar zhvillimin e seancës gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës në datë 20.1.2018, datë në të cilën edhe ka vendosur pranimin e saj. Gjykimi i kërkesës, dhe për pasojë edhe vendimmarrja e subjektit, duket të jetë ndërmarrë në kundërshtim me nenin 260/4 të Kodit të Procedurës Penale, për sa kohë çështja ishte adresuar për gjykim përpara depozitimit të kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

v) Më tej, mbi ankimin e organit të akuzës (ku në apelin kundërshtues nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës është trajtuar çështja e moskompetencës nga subjekti në gjykimin e kërkesës së zëvendësimit të masës së sigurimit), çështja është kthyer për rigjykim për t’u gjykuar nga gjyqtari kompetent (ai i seancës paraprake), nga ku është vendosur përsëri, sikurse kishte vendosur subjekti më parë, pra ndryshimi i masës së sigurimit personal të kundërshtuar nga organi i akuzës, vendim ky i lënë në fuqi nga gjykata e apelit me vendimin nr. ***, datë 8.5.2018.

vi) Në vijim, subjekti i rivlerësimit, mbi kërkesën e organit të akuzës për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” kundër personit nën hetim Y.A, dyshuar për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, kryer në bashkëpunim më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, me vendimin nr. ***, datë 19.7.2017 (të formës së prerë), ka vendosur sipas kërkesës së organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

vii) Më tej, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 2.2.2018, mbi kërkesën e të dyshuarit Y.A (i hetuar në procedimin penal të regjistruar ndaj tij me nr. ***), ka vendosur zëvendësimin e masës ndaj të dyshuarit nga “ndalim i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim ...” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, duke përcaktuar ditën dhe orën e paraqitjes së tij në çdo muaj. Në këtë rast, organi i akuzës ka ngritur probleme procedurale, nën kontekstin se nuk duhet që këtë kërkesë ta gjykonte subjekti por gjyqtari i seancës paraprake, duke qenë se çështja kishte shkuar për gjykim, nisur nga parashikimet e reja të bëra në Kodin e Procedurës Penale në vitin 2017. Nga aktet e administruara vërehet se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e ndërmjetëm nr. ***, datë 26.1.2018, “Për shpalljen e moskompetencës”, ka arsyetuar rolin dhe pozitën e saj në raport me legjisllacionin procedural, me të cilën ka vendosur rrëzimin e kërkesës, si dhe ka bërë me dije organin e akuzës mbi mënyrën e shortimit të çështjes, me qëllim shmangien e dyshimeve për njëanshmërisë në gjykimin e kërkesës me këtë të dyshuar dhe njëkohësisht ka kërkuar edhe dorëheqjen nga gjykimi i kërkesës (sikurse vihet re kjo kërkesë duket t’i ketë paraprirë çdo dyshimi të organit të akuzës për shkak të pranimit më parë të zëvendësimit të masës së sigurimit personal ndaj personit në hetim K.Z), ndërsa rezulton se kjo kërkesë nuk është pranuar nga drejtuesi i gjykatës. Në kushte të tilla, ka vijuar gjykimi nga subjekti i rivlerësimit i përmbyllur me pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës, sikurse u citua më sipër. Pas rikthimit të çështjes vërehet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 11.4.2018, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 15.5.2018, ka vendosur sërish (por me një trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh), sikurse kishte vendosur subjekti, *zëvendësimin e masës ndaj të dyshuarit Y.A nga “ndalim i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”*. Ajo që vërehet në këtë çështje me dy të dyshuar (hetuar nën të njëjtin procedim penal nr. ***) është

fakti se organi i akuzës (i përfaqësuar nga e njëjta prokurore) nuk ka adresuar të njëjtin kontestim procedural në kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga shtetasi K.Z, nga “ndalim i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, përveçse referuar procesverbalit të seancës gjyqësore (shihni faqen 224 në dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 27.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe parashtrimet datë 20.1.2018, me numërtim 244 e vijim), ku ka kërkuar rrëzimin e kërkesës. Edhe në gjykimin e zëvendësimit të masës së sigurimit personal të shtetasit K.Z, subjekti i rivlerësimit, pasi ka arsyetuar kushtet dhe rrethanat e reja sipas nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat (sipas arsyetimit) mundësojnë zëvendësimin e masës (si depozitimi i një kontrate individuale punësime e lidhur me një tjetër shoqëri, vërtetimi i shoqërisë punëdhënëse se detyrat e specifikuar për t’u kryer dhe përmbushur prej tij kërkojnë udhëtime jashtë vendit, si dhe dokumentacioni që pasqyrojnë qenien e tij si anëtar në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë “****” sh.a.) me vendimin nr. ***, datë 20.1.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës. Mbi ankimin e organit të akuzës, çështja është kthyer për rigjykim për t’u gjykuar nga gjyqtari kompetent (ai i seancës paraprake), nga ku është vendosur përsëri, sikurse kishte vendosur subjekti më parë, pra ndryshimi i masës së sigurimit personal të kundërshtuar nga organi i akuzës, vendim ky i lënë në fuqi nga gjykata e apelit me vendimin nr. ***, datë 8.5.2018.

viii) Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, në tërësi në këtë çështje, me vendimin nr. ***, datë 19.7.2017, ka caktuar edhe masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive mbi llogaritë bankare të personit nën hetim shoqëria “****” sh.a., në të gjithë bankat e nivelit të dytë që operojnë në Republikën e Shqipërisë, sikurse është kërkuar nga organi i akuzës. Me gjithë qëndrimin e organit të akuzës për të mos u pranuar ankimi i ushtruar nga personi nën hetim/shoqëria, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2017, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke hequr masën e sekuestros preventive vetëm mbi llogaritë rrjedhëse të shoqërisë tregtare “****” sh.a., që shërbejnë si likuiditet për pagat e punonjësve të kësaj shoqërie.

ix) Përgjithësisht duket se zbutja e masës së sigurimit fillimisht nga “arrest me burg” në “ndalim të daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...”, është pranuar nga një gjykatë më e lartë pas rrëzimit të dhënë me vendimet e subjektit mbi disa kërkesa të të dyshuarve. Po ashtu, momenti i pranimit të kërkesës së të dyshuarve për ndryshim të mëtejshëm të masës së sigurimit personal nga “ndalim i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, duket të jetë pranuar nga subjekti vetëm pas përmbushjes së kushteve të nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, pra, pasi këto kërkesa janë rrëzuar një herë për mungesë provash.

Për sa më sipër, dukej se subjekti ka gjykuar në kundërshtim me nenin 260/4 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj këtyre shtetasve nga “ndalim i daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar për personin nën hetim...” në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, pasi gjykimi i kërkesës ka vijuar në kushtet kur më parë në gjykatë ishte depozituar kërkesa e organit të akuzës për dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe për këtë shkak i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të qartësojë vijimësinë e këtij procesi, në kontekstin e statusit të gjykimit të themelit të procedimit penal të regjistruar ndaj këtyre shtetasve, si dhe të depozitohet dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar deklaratën noteriale¹⁴¹ të shtetasës A.XH, me detyrë sekretare gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka mohuar të ketë paraqitur këtë denoncim, përdorimi i emrit të saj në këtë denoncim është bërë nga persona të panjohur

¹⁴¹Nr. ***, datë 13.1.2022.

prej saj dhe se për shkak të detyrës si sekretare gjyqësore (është shprehur deklaruesja) nuk është në gjendje të analizojë vendimmarrjet gjyqësore. Në vijim për personat nën hetim K.Z dhe Y.A, subjekti ka treguar në mënyrë kronologjike procedurën e ndjekur lidhur me caktimin prej saj të masës së sigurimit personal “arrest me burg”, rivendosjen po prej saj pas verifikimit të kushteve, ndryshimin e masës nga një gjykatë më e lartë në “ndalimin e daljes jashtë territorit shtetëror shqiptar”, zëvendësimin e masës në “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, arsyet e konsiderimit për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, vendimmarrje kjo e dhënë pas përsëritjes së kërkesës së rrëzuar më parë, për shkak të mosparaqitjes së provave shkresore për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve.

Subjekti ka analizuar bazën ligjore, konkretisht nenin 260, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale, duke parashtruar se dispozita i jep mundësinë gjyqtarit të seancës paraprake që të shqyrtojë kërkesën për zëvendësimin apo ndryshimin e masës së sigurimit vetëm nëse ajo ngrihet nga i pandehuri në seancë gjatë shqyrtimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq. Pra, në asnjë dispozitë ligjore nuk thuhet shprehimisht që nëse është bërë kërkesë për dërgim çështje në gjyq kompetente për shqyrtimin e masës së sigurimit është gjyqtari i seancës paraprake.

Po ashtu, subjekti ka qartësuar figurën e seancës paraprake sipas ndryshimeve legislative të vitit 2017, si dhe ka theksuar se ndryshimet legislative kanë filluar të zbatohen në shtator të vitit 2017, ndërsa ajo e kishte shqyrtuar këto kërkesa vetëm 4 muaj pas këtyre ndryshimeve, në një kohë që praktika gjyqësore ishte e rrahur me dy figura gjyqtarësh: atë të hetimeve paraprake dhe atë të themelit.

Subjekti ka parashtruar se në kuptimin administrativ kur paraqitet kërkesë për zëvendësim masë siguri ajo nuk regjistrohet dhe as nuk hidhet në short, por ciklohet nga kryetari i gjykatës dhe shkon tek gjyqtari kompetent, që është gjyqtari i hetimeve paraprake. Pra, fakti që çështja është cikluar nga kryetari i gjykatës për të ardhur për shqyrtim tek subjekti tregon praktikën që ishte vendosur në gjykatë në diskutimet me trupën gjyqësore.

Subjekti është shprehur edhe lidhur me rrëzimin e kërkesës për moskompetencë funksionale të prokurores për shkak të bindjes së saj, por edhe për mënyrën se si ajo interpretonte nenin 260/4 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me gjyqtarin e seancës paraprake në harmoni me dispozitat e tjera procedurale, të cilat sqaron se i ka analizuar me vendim të ndërmjetëm.

Subjekti ka parashtruar edhe arsyet se përse kompetent duhet të ishte gjyqtari i hetimeve paraprake, edhe pse çështja ka kaluar për gjykim.

Subjekti ka shpjeguar mbi afatin e ngushtë që kërkon gjykimi i zëvendësimit të masës së sigurimit. Më konkretisht, subjekti ka sqaruar se për personin nën hetim K.Z kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit është regjistruar në datën 16.1.2018 dhe është shqyrtuar në datën 20.1.2018, pra brenda 4 ditëve, ndërsa për personin nën hetim Y.A kërkesa është regjistruar në datën 22.1.2018, ndërsa seanca e parë është caktuar në datën 26.1.2018, pra pas 4 ditësh.

Ndërsa kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim është regjistruar në datën 12.1.2018 dhe është shortuar tek gjyqtarja M. C në datën 15.1.2018 dhe po atë ditë është planifikuar seanca paraprake për në datën 15.2.2018, pra brenda afatit 30-ditor dhe rezulton të jetë shqyrtuar po në këtë datë.

Subjekti ka depozituar disa raste praktike, ku sipas saj provohet bindja që kjo kërkesë mund të shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake nëse paraqitet gjatë seancës paraprake, sipas nenit 260/4 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, ajo ka qartësuar se vendimet e saj janë lënë ekzaktësisht të njëjta si vendimet e dhëna prej saj dhe se janë lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, duke pretenduar kështu se

në thelb zgjidhja ka qenë e drejtë dhe interpretimi i dispozitës procedurale nuk ka sjellë asnjë dëm.

Subjekti thekson faktin se me vullnetin e saj ka paraqitur kërkesë për dorëheqje, duke e trajtuar këtë moment si mosqëllim në vetvete që të mbante dosjen në mënyrë të padrejtë, por duke pretenduar se interpretonte dispozitën procedurale në harmoni me dispozitat e tjera lidhur me gjyqtarin e seancës paraprake, aq më tepër kur kjo figurë e re procedurale ishte pa praktikë të konsoliduar.

Subjekti shpjegon se hapat e ndjekur provojnë se vendimi i dhënë prej saj nuk i ka sjellë asnjë dëm hetimit, gjykimit, palëve apo drejtësisë.

Subjekti ka parashtruar edhe mbi vijimësinë e këtij procesi, duke sqaruar se për këtë çështje organi i akuzës ka kërkuar tërheqjen e të gjitha akuzave dhe shuarjen e masave të sigurimit për gjithë të pandehurit dhe në përfundim gjykata ka vendosur pafajësi për të gjithë.

Subjekti ka pretenduar se *dukshëm jemi para një rasti që nuk ka asnjë shkelje, nuk ka asnjë abuzim, nuk ka asnjë vendim të padrejtë për sa i përket themelit të çështjes, e vetmja gjë që ka është ligësia dhe shpifja e atyre që nuk dinë të ndalen as kur nëpër rreshtat e denoncimeve dhe nëpër dosjet e denoncuar dalin shkeljet e tyre dhe se ka bindjen që kjo çështje është denoncuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

Subjekti ka depozituar:

- vendimin e ndërmjetëm për moskompetencën;
- vendimet e zëvendësimit të masave të sigurimit nga gjyqtarët e themelit;
- vendimin e pafajësisë;
- vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatës së Apelit Shkodër dhe ankimin e prokurorit;
- disa vendime në praktikën e punës së subjektit kur palët kanë kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore.

Trupi gjykues konstaton se subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të denoncuesit, sipas së cilës deklaron se nuk ka e ka bërë ai denoncimin. Ky veprim i subjektit, në vlerësim të trupit gjykues, nuk përputhet me etikën e magjistratit, pasi nuk mund të kontaktojë persona të cilët kanë paraqitur denoncim pranë organeve të rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin e subjektit në seancë se këto persona janë kontaktuar nga ana e avokatit, mbetet në nivel deklarativ, pasi në asnjë nga deklaratat noteriale nuk citohet ky fakt.

Në lidhje me procedurën konstatohet se nga ana e subjektit janë kryer veprime në tejkalim të kompetencave të saj, të cilat janë konfirmuar dhe nga gjykata më e lartë.

Komisioni do të vlerësoj këto konstatime në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.

c. Në lidhje me çështjen penale në ngarkim të shtetasit I.K, pas administrimit¹⁴² të dosjes gjyqësore, rezultoi si vijon:

Përmbledhje e shkurtër e çështjes penale

i) Të pandehurit I dhe B.K janë arrestuar si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “pastrim të produkteve të veprës penale” të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 287, pika 1, germat “a”, “c”, “ç” dhe “d” dhe pikat 2 dhe 3 të Kodit Penal. Nën këtë akuzë për të dyshuarin I.K, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 10.11.2017, ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest me burg” edhe për të dyshuarin B.K. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë

¹⁴²Me shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

15.9.2017, ka caktuar masën e sigurimit personal a me burg”. Panorama e hetimit të çështjes i përket investimit të bërë në ndërtimin e një pallati nga shtetasi B.K, ku dyshohej se bëhej nga pastrimi i parave të vëllait të tij I.K i dënuar më parë në shtetin italian për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike”, etj. (vendim penal i njohur nga gjykatat shqiptare) dhe sigurisht përfitimit të shumë pasurive në këtë ndërtim, të cilat rezultojnë më pas të dhuruara nga shtetasi B.K shtetasit I.K. Për këto pasuri, me kërkesë të organit të akuzës, është vendosur sekuestro preventive, përfshirë edhe për një llogari bankare mbi kuotat e blera në fondin e Raiffeisen Prestigj në “Raiffeisen Bank”.

ii) Nga aktet e administruara rezultoi se shtetasi I.K, me kërkesën e datës 6.6.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka kërkuar *heqjen e masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive mbi pasuritë e tij, kuota të blera në Fondin Raiffeisen Prestigj*, e vendosur me vendimin nr. ***, datë 14.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në këtë kërkesë organi i akuzës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin (e ndërmjetëm) nr. s’ka, datë 19.6.2019 (me trup gjykues të përbërë nga subjekti i rivlerësimit dhe dy anëtarë të tjerë), mbi kërkesën e shtetasit I.K, me objekt “heqje e sekuestros preventive”, të vendosur me vendimin nr. ***, datë 14.9.2017, të po kësaj gjykate, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke hequr sekuestron preventive të llogarisë bankare në emër të këtij shtetasi mbi kuotat e blera në Fondin e Raiffeisen Prestigj në “Raiffeisen Bank”, sekuestruar me vendimin penal nr. ***, datë 14.9.2017. Në arsyetimin e vendimit të ndërmjetëm thuhet se është vënë sekuestro mbi të gjithë pasuritë e përfituara nga ndërtimi i pallatit, si dhe i një llogarie bankare mbi kuotat e blera në Raiffeisen Prestigj në “Raiffeisen Bank”. Vendimi arsyeton se të ardhurat në këtë llogari janë pasojë e transkriptimit të një pasurie të babait të shtetasve K, shumë e cila ka kaluar në këtë llogari. Nën këto argumente, si dhe nën arsyetimin se organi i akuzës në themelin e çështjes ku kanë qenë të përfshirë edhe dy shtetas të tjerë për të cilët ka kërkuar pushimin e çështjes, nuk ka pasur pretendime lidhur me origjinën e përfitimit të kësaj shume, është pranuar nga trupa gjykuese kërkesa për lirimin e kësaj llogarie bankare. Në vendim është arsyetuar se pavarësisht se kjo kërkesë nuk është pranuar më parë nga gjykata, me ndryshimin e kushteve mbi provueshmërinë e origjinës së shumës është rezultuar në pranimin e kërkesës. Në arsyetimin e vendimit citohet se *fakti i mospasjes së pretendimeve nga organi i akuzës mbi këtë banesë nga kanë gjeneruar të ardhurat është pasqyruar edhe në procesverbalin e seancës, datë 8.6.2018, f. 8, ku prokurorja citon: “Nuk kemi pretendime në lidhje me këtë banesë”*. Sikurse duket nga dokumentacioni i administruar, vendimi i ndërmjetëm ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar. Proceduralisht nuk duket të ketë problematika, për sa kohë është rezultuar me vendimarrje (të llojit i ndërmjetëm), ndërsa mënyra e zgjidhjes së pranimit të kërkesës duket se i takon themelit të çështjes dhe vleftësimit të provave apo kushteve të reja të krijuara nga vënia e sekuestros deri në heqjen e saj për një pasuri të caktuar.

iii) Po nga aktet në dosje është vërejtur se, më tej, të pandehurit I dhe B.K kanë paraqitur kërkesë në datën 3.7.2019 kundër Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit dhe lirimin e tyre të menjëhershëm.

iv) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (e përbërë nga subjekti i rivlerësimit dhe dy anëtarë të tjerë) me vendimin nr. s’ka, datë 3.7.2019, mbi kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe shtetasve I.K dhe B.K, ka vendosur shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg”, me arsyetimin se janë plotësuar të tria kushtet e parashikuara në nenin 263/2 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin citohet shprehimisht: “2. *Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë: a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale; b) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim; c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.*” (pasi në këtë rast dënimi është parashikuar deri në 15 vjet burgim;

nga momenti i depozitimit të akteve kanë kaluar 12 muaj; nga ana e gjykatës nuk është dhënë ende vendimi i themelit). Gjykata në këtë rast ka vendosur sipas nenit 266 të Kodit të Procedurës Penale, duke konstatuar shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg” për të dy të pandehurit dhe caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit personal “ndalim i daljes jashtë shtetit” dhe “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga nenet 233 dhe 234 të Kodit të Procedurës Penale.

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitujë: (i) vendimin penal nr. ***, datë 14.9.2017, me të cilin është vendosur (mbi kërkesën e organit të akuzës) sekuestro preventive e pasurive dhe llogarisë bankare; (ii) procesverbalin e seancës, datë 8.6.2018, f. 8 – cituar në arsyetimin e vendimit të ndërmjetëm – me të cilin është pranuar kërkesa për heqjen e sekuestros për llogarinë bankare; si dhe (iii) çdo dokumentacion të vlerësuar në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) vendimin penal nr. ***, datë 14.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me të cilën është vendosur sekuestro edhe mbi këtë pasuri; (ii) procesverbalin e seancës, datë 8.6.2018, ku deklaroi shprehimisht se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë pasuri; si dhe (iii) vendimin nr. *** akti, datë 19.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Gjithashtu, përveç dokumentacionit të depozituar, ka parashtruar shkurtimisht edhe mbi rastin. Ndër të tjera, ka pretenduar se nuk qëndron denoncimi i denoncuesit, pasi jemi në një rast kur prokurori vetë pranon që paratë e sekuestruara në bankë vijnë nga shitja e një banese të fituar në vitin 1983 nga babai i të pandehurit, pronësinë e së cilës ky i fundit e ka fituar me anë të trashëgimisë. Në këtë rast prokurorja, edhe pse pranon këtë fakt, në mënyrë të kundërligjshme mban të sekuestruar një pasuri për të cilën pranon që nuk ka asnjë dyshim dhe nuk lidhet me veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri, madje këtë fakt e pranon vetë prokurorja në gjykim, ku deklaroi shprehimisht: *“Nuk kemi pretendime në lidhje me këtë banesë”*.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar: *“Si rrjedhim kam vendosur në përputhje me ligjin procedural penal, duke respektuar parimet dhe standardin e procesit të rregullt ligjor, të procesit të të provuarit, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të palëve. Kërkoj që ky denoncim të mos merret në konsideratë, pasi është një denoncim shpifës dhe keqdashës, me të vetmin qëllim ‘përlyerjen e figurës sime’”*.

Trupi gjykues nuk vëren problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.

8. Denoncim¹⁴³ i shtetasit Q.L

a. Denoncuesi, në cilësinë e babait të viktimës [F.Q.SH (L)], fillimisht gjatë hetimit administrativ ka denoncuar shkeljet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në çështjen S, me objekt “sigurim prove i dëshmisë së një shtetasi”, e cila është trajtuar më sipër në këtë vendimmarrje. Ndërsa, në të dyja denoncimet e tjera të paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit¹⁴⁴ ky shtetas duket se ka bërë një rezymë të të gjithë procesit hetimor të kryer nga Komisioni ndaj subjektit, duke pasqyruar edhe një herë thuajse të gjitha shkeljet e pretenduara nga të gjithë denoncuesit, të cilat janë trajtuar dhe pasqyruar më sipër në këtë vendimmarrje (si çështja K, G, G, H, R, L, Y, etj.), por duke shtuar edhe çështjet L, Ç, K, të cilat, gjithashtu, janë adresuar edhe nga të tjerë denoncues në denoncimet e depozituara pas seancës dëgjimore. Komisioni ka administruar dhe trajtuar në këtë vendimmarrje çështjet L (duke qenë çështje e denoncuar edhe nga shtetasi K) dhe K (denoncuar nga shtetasja A.XH), etj. Ndërsa në analizë të pretendimeve të këtij denoncuesi për shkelje të kryera nga subjekti në çështjen penale në ngarkim të shtetasve A.Ç dhe F.Ç se ajo nuk ka aftësi për të gjykuar dhe për të zhvilluar procedurat gjyqësore për

¹⁴³Nr. *** prot., datë 17.11.2021, dhe me e-mail datë 28.11.2021.

¹⁴⁴Pas seancës dëgjimore.

seancën paraprake dhe del se i ka shkelur këto procedura në çështjen e Prokurorisë së Rrethit Elbasan kundër A (ose A) Ç (ose Ç), F.Ç të akuzuar për vrasje, Komisioni ka kërkuar kopje të dosjes gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Në analizë të dokumentacionit të administruar¹⁴⁵ konstatohet:

- Fillimisht duhet thënë se kërkesa e organit të akuzës për gjykim nuk i referohet shtetasve Ç siç pretendon denoncuesi, por i referohet dy shtetasve të tjerë, të akuzuar për vrasje. Më konkretisht, nga leximi i vendimit të depozituar nga gjykata vërehet se kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. *** të vitit 2012, adresohet në ngarkim të të pandehurve E.B dhe E.C, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga nenet 79/dh dhe 25 të Kodit Penal ndaj viktimave B.A dhe V.P (B).

Në vijim, po nga leximi i vendimit gjyqësor, rezultoi se bëhet fjalë për vrasjen e shtetasit G.B, i ndodhur nën masë “arrest në shtëpi”, po nën akuzën e vrasjes. Sipas vendimit rezultoi se ndërsa shtetasi G.B qëndronte nën këtë masë arresti i ruajtur nga shërbimi policor, në datën 15.8.2012 është gjendur i varur në banesë së bashku me të atin e tij. Për këtë ngjarje nga organi i akuzës janë pyetur disa shtetas, përfshirë këtu edhe dy miqtë e tij të afërt, shtetasit B dhe C të akuzuar për këtë vrasje, pasi nga dëshmitë e nënës së viktimës këta shtetas mund të kenë qenë bashkëpunëtorët në hapjen e derës së shtëpisë dhe arritjen e vrasjes së shtetasit G.B dhe babait të tij. Ndër të tjera, sipas vendimit gjyqësor, thuhet se nga dëshmitë e dhëna po nga nëna e viktimës, pista kryesore e vrasjes përfshin shtetasit Ç për shkak të hasmërisë që ka pasur midis familjeve Ç dhe B, pasi ky i fundit mendohet të ketë qenë vrasësi i S.Ç. Vendimi gjyqësor pasqyron në detaje ngjarjen e ndodhur, kërkimin e organit të akuzës për gjykimin e shtetasve B dhe C nën akuzën “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe jo Ç, dhe nisur edhe nga të dhënat e parashtruara në dëshmitë e bashkëpunëtorit të drejtësisë, shtetasit B, vë theksin në kthimin e çështjes penale përsëri organit të akuzës për të mos e kushtëzuar këtë çështje në këta të akuzuar, por duke lënë një gamë të gjerë detyrash për t’u kryer brenda një afati katërmujor, duke evidentuar ndër të tjera si detyra të rëndësishme për t’u kryer për zbardhjen e dëshmisë së bashkëpunëtorit të drejtësisë, se porositësit kanë qenë shtetasit Ç dhe më tej edhe marrjen e këtyre shtetasve në pyetje, po ashtu, marrjen në pyetje të punonjësve të policisë të cilët kanë qenë në vendngjarje në ditën e vrasjes të akuzuar për shpërdorim detyre, me qëllim zbulimin me vërtetësi të ngjarjes së ndodhur në datën 15.8.2012 dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të vrasjes së viktimës, qofshin në rolin e ekzekutorit të drejtëpërdrejtë, të bashkëpunëtorit apo të porositësit. Subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se vetëm pas një hetimi të plotë dhe nëse provohet se të pandehurit B dhe C kanë kryer vrasjen e shtetasit B me porosi të vëllezërve Ç, organi procedues duhet të kërkojë dërgimin e çështjes për gjykim për të gjithë ekzekutorët, bashkëpunëtorët dhe porositësit në një çështje të vetme dhe nëse kjo nuk provohet duhet të zbulohet motivi i vërtetë i vrasjes. Vendimi rezultoi të ketë marrë formë të prerë pa u ankimuar.

Trupi gjykues nuk vëren problematika të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional.

b. Denoncuesi në denoncimin e dytë ka shtuar edhe çështjen penale nr. *** akti të vitit 2020, me kërkues E.D, për të cilën pretendon se është marrë pa short nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me këtë denoncim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës mbi shortimin e kësaj çështjeje, si dhe çdo dokumentacion të vlerësuar në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

¹⁴⁵Vendim gjyqësor nr. ***, datë 11.12.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2021, në të cilën thuhet se ky vendim ka lidhje me të akuzuarit për vrasje, shtetasin Ç.

Subjekti ka vënë në dispozicion disa akte të vendimit nr. ***, datë 19.2.2021, me objekt “njohje e ditëve të burgut”, nga i cili rezulton se i dënuari E.D ka paraqitur kërkesë në datën 18.6.2020, e cila i është shortuar subjektit sipas shortit elektronik (shihni RIV). Subjekti ka parashtruar se: *“Fakti që çështja është shortuar në datën 19.6.2020 do të thotë se unë isha gjyqtare e thjeshtë e jo titullare, si rrjedhim, as nuk e menaxhoja shortin (titullare jam bërë në datën 1.10.2020). Ky shtetas kërkonte që periudha e vuajtjes së dënimit në Itali t’i njihej si periudhë dënimi për efekt të ekstradimit të tij në Shqipëri, për llogari të dënimit penal të marrë në Shqipëri e për të cilin ishte në pritje të ekstradimit. Në funksion të zbulimit të së vërtetës, unë si gjyqtare, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë kërkova informacion nga autoritetet e drejtësisë italiane dhe më konkretisht lidhur edhe me faktin se çfarë dënimi kishte vuajtur ky shtetas në Itali, sa ishte masa e dënimit, për cilën vepër penale, si dhe sa kohë kishte qëndruar në pritje të ekstradimit në vendin tonë. Në çështjet me objekt ‘njohje e ditëve të burgut’ gjykata në çdo rast i dërgon një shkresë Ministrisë së Drejtësisë dhe kjo e fundit, me anë të letërporosisë, i kërkon informacion shtetit të huaj lidhur me ditët e burgut që ai ka vuajtur në atë shtet dhe marrja e këtij informacioni kërkon disa muaj”.*

Subjekti ka sqaruar edhe lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor, shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore për arsye të qenësishme, pasi informacioni pritej nga jashtë vendit, sikurse sanksionohet edhe në konventat e ndryshme dy/shumëpalëshe. Gjithashtu, ka identifikuar edhe korrespondencën me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe ka paraqitur procesverbalet e seancave gjyqësore. Subjekti, ndër të tjerë, ka parashtruar: *“Pasi erdhi informacioni nga Ministria e Drejtësisë, siç mund të shihet në dosje, rezultoi se ai kishte vuajtur për llogari të vendimit shqiptar vetëm 9 ditë burgim, një periudhë kjo tërësisht disproporcionale me atë çka kishte kërkuar që t’i njihej dhe, më konkretisht, ai kërkonte t’i njihej periudha prej datës 21.5.2006 deri më 18.12.2013, pra 7 vjet e 7 muaj, duke u llogaritur kjo periudhë me 1,5 ditë burgim, pra rreth 11 vjet burgim në total. Në kushtet kur dokumentacioni i mbërritur nga Italia tregonte se ai kishte vuajtur vetëm 9 ditë, i dënuari nuk dëshironte të vazhdonte më gjykimin, pasi nuk ishte kjo periudha që ai pretendonte dhe mendonte se dokumentacioni i ardhur nga Italia nuk ishte i saktë. Për këtë arsye u tërhoq nga gjykimi deri në sqarimin e rrethanave të dokumentacionit në Itali nëpërmjet avokatit të tij në atë shtet. Mesa duket, pas sqarimit të rrethanave, ai e ka ringritur përsëri këtë kërkim në gjykatë në datën 16.4.2021 dhe sipas shortit elektronik kjo çështje i ka rënë për gjykim gjyqtarit T.T, kohë kur shorti menaxhohej prej meje, për këtë ju paraqes RIV”.*

Subjekti ka depozituar:

- kërkesën e kërkuarit;
- shkresat e Ministrisë së Drejtësisë;
- procesverbalet e seancave;
- vendimin gjyqësor;
- RIV-in e çështjes së saj dhe të gjyqtarit T. T.

Trupi gjykues konstaton se nuk konstatohen problematika të cilat mund të ndikojnë në kriteret matës të vlerësimit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit.

9. Denoncim¹⁴⁶ i shtetasit D.Ç

9.1 Denoncuesi në denoncimin e paraqitur pretendon se subjekti i rivlerësimit ka përfituar para nga çështja që ka pasur lidhur me masën për sekuestro të firmës “****” dhe se korrupsioni është kryer në bashkëpunim me avokatin e firmës “****”, A.A, i cili mbante kontakte me bashkëshortin e saj, me iniciale L. Q. Ai sqaron se ka mundur të fotografojë një prej takimeve në qytetin e Elbasanit. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë gjithmonë si avokat shtetasin A.A. Ai ka depozituar një foto, duke pretenduar se lidhja e subjektit të

¹⁴⁶Nr. *** prot., datë 15.12.2021.

rivlerësimit me avokatin fakton lidhjen midis tyre dhe se ajo bie ndesh me deklaratimet e saj se nuk mban lidhje me avokatin.

Komisioni i ka trajtuar më sipër problematikat e denoncuar ndaj subjektit të rivlerësimit në lidhje me gjykimet e saj në çështjen e shoqërisë “****” ndaj administratorit të saj dhe drejtorit të skrapit, si dhe denoncimet lidhur me pretendimin për bashkëpunim të subjektit me disa avokatë, ku ndër të tjerë përmendet edhe avokati A.A.

Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit: (i) të japë shpjegime për sa pretendohet; (ii) të qartësojë saktësisht kohën në të cilën është realizuar takimi midis dy personave të shfaqur në foto dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me këtë foto; si dhe (iii) të depozitojë çdo dokumentacion në mbështetje të shpjegimeve.

Subjekti, ndër të tjera, ka parashtruar se nga fotoja nuk rezulton e provuar data e kryerjes së fotografisë, megjithatë bashkëjetuesit, shprehet ajo, i kujtohet shumë mirë si ditë.

Subjekti ka sqaruar se *kjo foto ka lidhje pikërisht me datën e bërjes publike të videove në media ku bashkëjetuesi i saj kishte shkuar në ambientet e gjykatës për ta mbështetur për shkak të gjendjes së rënduar psikologjike që po kalonte*. Ajo ka sqaruar se si shumë persona të cilët atë ditë e kanë takuar dhe janë njohur me bashkëjetuesin e saj, ka qenë edhe av. A.A. Subjekti ka qartësuar se ka qenë një takim përshëndetës para gjykatës, tërësisht rastësor dhe pa asnjë vlerë për të hedhur hije dyshimi ndaj saj.

Sipas subjektit, ky takim rastësor mund të përbente problem nëse av. A.A do të ishte kontakt i papërshtatshëm, sipas kuptimit që i jep ligji “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kontaktit të papërshtatshëm, gjë që nuk qëndron në rastin konkret.

Sa më sipër, subjekti ka pretenduar se kjo foto nuk mund të ketë asnjë lloj ndikimi në procesin e saj të rivlerësimit, referuar gjithë rrethanave që karakterizojnë rastin konkret, e aq më tepër referuar praktikës së Komisionit me vendime të formës së prerë.

Subjekti ka depozituar:

- fotografi të ambienteve të jashtme të gjykatës, ku provohet se fotoja e bashkëjetuesit është bërë para gjykatës;
- deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.1.2022, lëshuar nga av. D.Ç;
- vendimi i firmës “****”, ku del se avokat është TH.S dhe jo A.A.

Trupi gjykues konstaton se subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të denoncuesit, sipas së cilës deklaron se nuk e ka bërë ai denoncimin. Ky veprim i subjektit, në vlerësim të trupit gjykues, nuk përputhet me etikën e magjistratit, pasi ajo nuk mund të kontaktojë persona të cilët kanë paraqitur denoncim pranë organeve të rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin e subjektit në seancë se këta persona janë kontaktuar nga avokati, mbetet në nivel deklarativ, pasi në asnjë nga deklaratat noteriale nuk citohet ky fakt.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues

Sa i përket cenimit të besimit të publikut, trupi gjykues, duke iu referuar edhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁴⁷, çmon të theksojë se ky vlerësim është pasojë e disa hapave të ndërmarrë në analizë, të cilët kanë passjellë këtë konstatim.

Cenimi i besimit të publikut, parashikuar si një ndër situatat ligjore që passjellin masën disiplinore të shkarkimit, rezulton si një zbrëthim në ligj i nevojës për të cilën është krijuar sistemi i rivlerësimit kalimtar në Republikën e Shqipërisë, parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës dhe nenin 1 të ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim për subjektin e rivlerësimit, shtjelluar gjerësisht më sipër, është pasojë e vlerësimit se si veprimet dhe mosveprimet e demonstruara

¹⁴⁷Vendim nr. ***, nr.***, nr*** dhe nr. ****.

prej subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, si dhe gjatë procesit të rivlerësimit, shihen nga një vëzhgues i pavarur dhe vlerësohen prej qytetarëve në drejtim të drejtësisë në tërësi. Analiza për mënyrën se si magjistratët duhet të normojnë sjelljen profesionale dhe personale në funksion të ruajtjes së besimit të publikut, për shkak të rëndësisë themelore që ajo ka për ekzistencën dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Trupi gjykues konstatoi gjendjen e cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, mbi bazën e një analize të detajuar më sipër, që mori në konsideratë: (i) paraqitjen nga subjekti në mënyrë të pasaktë të marrëdhënies së bashkëjetuesit të saj me z. L në lidhje me huan dhe transaksionet ekonomike që lidhen me shitblerjen e automjetit tip “kamion”, duke deklaruar të dhëna të pasakta, si dhe duke depozituar dokumentacion fiktiv në lidhje me blerjen në vlerën 950.000 lekë të kamionit, shitjes së tij në vlerën 32.000 euro dhe dhënies së huas në vlerën 28.000 z. L; (ii) sjelljen e saj në procesin e rivlerësimit për sa i përket marrëdhënies së bashkëjetuesit të saj me z. L; (iii) ndërthurjen e interesave personale të saj dhe të bashkëjetuesit me një person të dënuar për vepra që përfshihen në krimin e organizuar, parë nga këndvështrimi i publikut; (iv) kryerjen e videove në ambientet e punës, shoqëruar me lëvizje dhe sjellje provokuese në një sfond me muzikë të natyrës jo të hijshme dhe të papërshtatshme për imazhin e një magjistrati; si dhe (v) depozitimimin e deklaratave noteriale të denoncuesve, të cilët deklarojnë se nuk i kanë bërë ata denoncimet.

Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër për kriteret e rivlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Komisionit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

- a) subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të rremë për kontrollin pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 61/3 të ligjit nr. 84/2016;
- b) subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016;
- c) nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Enkeleda Kapedani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.5.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore (kundër)

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka